

# DITURIA ISLAME

REVISTË MUJORE FETARE, SHKENCORE E KULTURORE • Nr. 410 • JANAR 2025



QË TA FITOSH SIMPATINË E NJERËZVE  
DHE KËNAQËSINË E ZOTIT

TRASHËGIMIA E DOMOSDOSHME

MASKILIZMI APO MASKULINITETI

Muhammedi, a.s., në fillim të muajit  
Rexheb e ka bërë këtë lutje:

“O Allahu im! Na i bëj të bekuar  
Rexhebin dhe Shabanin dhe  
na bashko me Ramazanin!”

(Ahmedi, I:259)




## EDITORIAL

- 4 Gjuha e numrave dhe mesazhet e tyre

## FETARE

- 5 Që ta fitosh simpatinë e njerëzve dhe kënaqësinë e Zotit  
Dr. Sedat Islami
- 8 Të drejtat e përgjithshme për "ehlu dhimme" – jomuslimanët (2)  
Lavdrim Hamja
- 13 Kurani në Islam  
Akademik dr. Enes Kariq
- 17 Kujdesi dhe shfrytëzimi i mirë i kohës  
Isa Tërshani
- 20 Ikonializimi dhe nevoja për një lëvizje ikonoklaste  
Mr. Artan Musliu
- 23 Trashëgimia e domosdoshme në të drejtën trashëgimore të Kosovës  
Argjent Xheladini
- 27 Trajtesa e hebrenjve në Kartën e Medinës  
Nehat Shehu
- 31 Habib ibën Zejd ibën Asim el Ensariju  
Halil Mahmud es Samadij



## FAMILJE & EDUKIM

- 34 Maskilizmi toksik dhe maskuliniteti (burrëria) i shëndetshëm në Islam  
Nada Dosti

## KULTURË

- 37 Feja islame nxit mësimin, vëzhgimin dhe shkencën  
Mr. Njomza Sadriu
- 39 Libër me përmbajtje të pasur edukative dhe morale  
Bilall Maliqi

## PERSONALITETE

- 41 Sadri ef. Prestreshi (1917-2002)  
Mr. Arbim Ahmeti

## HISTORI & CIVILIZIM

- 44 Ezani i parë i namazit në Beograd  
Prof. dr. Jusuf Osmani
- 48 Hamami islam i shekullit XII, i cili u zbulua në lokalitetin e Tapas-it në Sevilje të Spanjës  
Sam Jones
- 50 Koncepti i përgjithshëm fetar në shtetin osman dhe raporti fetar në trevat shqiptare 1800-1912  
PhD. Agon Krasniqi

## AKTIVITETE

- 54 Myftiu Tërnavë priti në takim kryeministrin e Kosovës, z. Albin Kurti



Xhamia e Hadumit në Gjakovë

### DITURIA ISLAME

Revistë mujore fetare, shkencore e kulturore  
Nr. 410 • viti 38 • Janar 2025  
• Rexheb / Shaban 1446  
• Çmimi 1 €

### Boton

Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, Prishtinë

### Redaksia

Kryeredaktor: Mr. Driton Arifi  
Anëtarë:  
Dr. Ejup Haziri, Merita Boroci,  
Mr. Muharrem Tërnavë,  
Mr. Vedat Shabani.  
Sekretar & lektor: Bajram Zeqiri  
Redaktor artistik & teknik:  
Bashkim Mehani

### Adresa

"Dituria Islame",  
rr. "Bajram Kelmendi", nr. 182,  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel: +384 38 224 024  
E-mail: redaksia@dituriaislame.net  
www.dituriaislame.net  
Shtypi:  
"Printing Press", Prishtinë.



# Gjuha e numrave dhe mesazhet e tyre

*“Sikur të dëshironte Zoti yt, do t’i bënte njerëzit të një feje (por nuk dëshiroi, Ai e di pse). Ata vazhdimisht do të kenë divergjenca (mes vete),”*

(Hud, 118)

Dalja në shesh e statistikave dhe publikimi i tyre, heqën dilemat dhe larguan ato ethet që i kishin kapluar shtresa të gjera të shoqërisë, e më së shumti përgjegjësit e institucioneve relevante në vend. Njerëzit, natyrshëm mbeten të etur të kuptojnë, se cilat janë ndryshimet e transformimet shoqërore që kanë ndodhur ndër vite në aspektin demografik, arsimor, ekonomik por edhe fetar të tyre. Për më tepër, regjistrimet statistikore në formë ciklike dhe të rregulltë tregojnë për mendësinë e shëndoshë institucionale dhe për aspiratën e lartë zhvillimore të një shoqërie. Është kështu, ngase shoqëritë e avancuara e kuptojnë mirëfilli që “mendimi statistikor një ditë do të jetë po aq i nevojshëm për një qytetari efikase sa edhe aftësia për të lexuar dhe shkruar”, siç do të na porosiste Th. Wells.

Tkurrrja e numrit të popullsisë së vendit në 1.6 milion, dhe ulja e numrit mesatar të anëtarëve në një ekonomi familjare në 4.5 banorë në vitin 2024, krahasuar me 5.9 banorë më 2011 (zvogëluar për 1.4 banorë) janë të dhëna që rrëfejnë se ne jemi futur në faza të ndieshme të tranzicionit demografik, ku pos emigracionit të pandalshëm, ne tashmë kemi edhe trend shqetësues të natalitetit të ulët.

Të ndiesh përgjegjësi për këtë gjë, në nivel individual, shoqëror e më së shumti në atë institucional është japin shpresë që statistikën në të ardhmen do të jenë ndoshta më sihariqese. Pra, jo vetëm problemi i tkurrjes së shoqërisë, por edhe të tjera më të vogla se këto, do të duhej të ishin shqetësuese për bartësitë e përgjegjësive publike. Në këtë rrafsh, do të na fliste shumë edhe fjala e Umer bin Hatrabit r.a. pasi ai erdhi në krye të shtetit islam kur tha: “Sikur një kafshë të merrte në thua atje diku në Irak, do të kisha frikë se Allahu do të merrte në pyetje e do të më thoshte: pse kësaj kafshe nuk ia ke rregulluar-shtruar mirë rrugën o Omer!?” (Ibn Ebi Shejbe, nr.34486). Pa asnjë dilemë; mungesa e mirëqenies, ndjesia e mosbarabartësisë para ligjit, korrupsioni, pasiguria, janë disa prej fenomene më me ndikim që zbehin vullnetin për të të jetuar në atdhe, dhe ulin përpjekjet e qytetarëve për të kontribuar brenda shtetit të tyre. Të njejtat arsye, madje, kanë efekt të padiskutueshëm edhe në uljen e natalitetit, i cili edhe ashtu ka hyrë në një trend brengosës.

Ndërsa në aspektin fetar, secili njeri që ka lexuar me gjakftohësi e larg euforisë, deklarin e qytetarëve për fenë e tyre, mund të vërejë shkallën e pjekurisë së shoqërisë sonë. Të njetat kanë rrëfyer edhe për vigjilencën e mprehtë të këtij populli që në asnjë situatë të mos i nënshtrohet cytjeve e thirrjeve tendencioze për braktisje të Islamit apo të bëjë ndonjë ndyshim tekanoz të tij. Kjo pjekuri na bënë të lumtur, por dhe na kërkton me ngulm që ta rrisim edhe më tej përgjegjësinë dhe maturinë tonë në predikimet dhe interpretimet tona fetare. Ky kohezion religjioz që iu ka mbijetuar fortunave më të egra të epokave të pushtimit rigjid nga armiku ynë, janë treguesit më të kristaltë për gadishmërinë e këtij populli që ta ruaj paqen e brendshme e të mos e sakrifikojë atë me asnjë çmim.

Mbetet madhështor fakti se në asnjë proces të vështirë kombëtar, e në asnjë projekt progresist nacional nuk ka munguar ky diversitet religjioz. ‘Pajtimi i Gjaqeve’, Lufta Çlirimtare, Akademia e Shkencave, kuvendet e qeveritë, organizatat e institucionet e ndryshme, që të gjitha në gjirin e tyre kanë mishëruar ngrohtësisht këtë diversitet fetar dhe si i tillë ka funksionuar gjithnjë në të mirë të vendit. Në cilindo version tjetër, ëndrra jonë për pavarësi e shtet do të mbetej thjesht një ëndërr, dhe kurrnjëherë nuk do të jetësohej e as nuk do të bëhej realitet.

Po si ta lexojmë ndryshe këtë fenomen, kur Zoti ynë na tha: “Sikur të dëshironte Zoti yt, do t’i bënte njerëzit të një feje (por nuk dëshiroi, Ai e di pse). Ata vazhdimisht do të kenë divergjenca (mes vete),” Hud, 118. Andaj, nisur edhe nga parimi ynë fetar islam, këtë frymë kombëtare përbashkuese, duhet ta bartim si trashëgimi tek brezat e ardhshëm e ta flakim pa i bërë kurrë strofull cilëndo ide a thirrje që na e trazon këtë harmoni. Duhet ta kuptojmë një herë e mirë se “toleranca është ajo që na bën të jetojmë të gjithë së bashku, pa pasur nevojë të pajtohemi në çdo gjë.” J. Locke.

Mr. Driton Arifi

# Që ta fitosh simpatinë e njerëzve dhe kënaqësinë e Zotit

Dr. Sedat Islami

## HYRJE

Feja është program dhe mënyrë jetese, e cila rregullon raportet e besimtarit në të gjitha nivelet, duke filluar nga raportet me Krijuesin, për të vazhduar tutje me vetveten, familjen, rrethin, shoqërinë dhe njerëzimin mbarë. Për këtë arsye besimtari duhet të dallojë në të gjitha fushat. Që ta fitojë epitetin e besimtarit të mirë, duhet të jetë i mirë me Zotin dhe me njerëzit. Vetëm kështu mund të themi se ka fetari të kompletuar. Ndryshe, dështimi në njëren nga këto dy fusha, fetarinë do të bënte të dukej e shëmtuar dhe rrjedhimisht

irrituese dhe të refuzuar. E dështimi ndodhë për shumë shkaqe, ndër të cilat, si shkak kryesor është kur mendojmë se për ta kënaqur Zotin patjetër duhet të prishemi me njerëzit. Kjo është qasje plotësisht e gabuar të cilën feja nuk e mbështet parimisht.<sup>1</sup> Besimtari duhet ta synojë kënaqësinë e Allahut të Madhëruar dhe të jetojë me fenë e Tij, por në të njëjtën kohë duhet të ndërtojë raporte të mira me të tjerët. Madje, nga këto raporte edhe bëhet vlerësimi i lidhjes së tij me Zotin. A nuk ka thënë Profeti Muhamed a.s.: “*Musliman është ai që nuk të tjerët janë të sigurt nga gjuha dhe dora e tij.*”<sup>2</sup>

Këshilla të cilën do t’ua prezantojmë ofron një përmbledhje të shkurtër por kuptimplote dhe udhëzuese për ndërtimin e raporteve të mira me Zotin dhe njerëzit. Në fakt, është këshillë që Allahu i Madhëruar ia ka dhënë profetit Davud, *paqja qoftë mbi të!*. Allahu i Madhëruar i shpalli Davudit, *paqja qoftë mbi të*: “O Davud, a nuk do të t’i mësoj dy punë me të cilat mund të fitosh simpatinë e njerëzve dhe kënaqësinë Time: ndërmjet Meje dhe teje le të jetë mbulesë devotshmëria, ndërsa në raport me njerëzit sillu sipas moralit të tyre.”<sup>3</sup>

Rëndësia e kësaj këshille nuk qëndron thjesht në përkushtimin e saj për të ndrequr raportet e besimtarit në këto dy nivele, por edhe për mënyrën e avancuar të tyre. Pra, nuk bëhet fjalë për raporte formale, por për raporte të thella. *Ver’i*, si kryefjalë e raporteve me Zotin, nënkupton më shumë se thjesht devotshmërinë. Po kështu edhe sjellja me njerëzit *sipas moralit të tyre* nënkupton më shumë se thjesht një raport të mirë. Përtej kësaj ka synime fisnike, të cilat do t’i shpallim me lejen e Zotit Fuqiplotë.



Të fillojmë me shpjegimin e kësaj porosie të bukur dhe të rëndësishme.

## VERE'I SI NUANCË E THEKSUAR E RAPORTEVE TË ROBIT ME ZOTIN

Në terminologjinë fetare *vere'i* nuk nënkupton thjesht largimin nga haramet, por edhe largimin nga shumë gjëra të lejuara nga frika e rënies në të ndaluarat. Ose largimi nga gjërat që parimisht janë të ndaluara dhe të tjerat që janë të dyshimta. Një përkufizim bukur përmbledhës është edhe ky: “Vere'i nënkupton kryerjen e detyrimeve, braktisjen e të ndalurave dhe largimin nga të dyshuarat dhe këtë në shenjë frike e adhurimi ndaj Allahut të Madhëruar...”<sup>4</sup>

Profeti Muhamed a.s., ka thënë: “Lëre të dyshimtën dhe qasu asaj që nuk dyshon në të...”<sup>5</sup> Kuptimi i kësaj, siç shpjegon Ibën Haxheri, është që: “Nëse dyshon në diç, lëre. Lërja e të dyshimtës është bazë e madhe në vere.” Hattabiu ka thënë: “Vere’ është që ta braktisësh çdo gjë në të cilën dyshon.”

Braktisjen e gjërave të dyshimta dhe rëndësinë për fenë dhe nderin Profeti Muhamed a.s., na e ka mësuar edhe në një hadith tjetër, në të cilin qëndron: “Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë e ndërmyjet tyre ka gjëra të dyshimta që shumica e njerëzve nuk dinë t’i dallojnë. Kështu, ai që i ruhet të dyshimtave, ai e ka ruajtur fenë dhe nderin e vet...”<sup>6</sup>

Ky hadith, siç ka thënë Hattabiu, është “parim bazë në çështjen e *vere'it*.” Në të na është shpjeguar rëndësia e ikjes nga gjërat e dyshimta për fenë, duke e ruajtur atë nga ekspozimi ndaj të ndaluarave, ndërsa moralin e nderin, duke i ruajtur nga përbaltja, njollosja, reputacioni i keq.

Pra, bëhet fjalë për koncept të avancuar të devotshmërisë, i cili vetëdijen e besimtarit e ngrit në nivele të larta, të atilla që, jo vetëm që braktisë apriori haramet dhe i ikën dyshimeve, por edhe kur të bëjë vepra të mira, i bën ndërsa ka frikë mos nuk i pranohen. Pra, nuk janë të vetëmashtruar. Allahu i Madhëruar duke na folur për këtë kategori besimtarësh thotë: “Me të vërtetë, ata që dridhen nga frika e Zotit të tyre, që besojnë në shpalljet e Zotit të tyre, që nuk i shoqërojnë asgjë (në adhurim) Zotit të tyre, dhe që, kur japin atë që japin, zemrat e tyre i kanë plot frikë, ngaqë do të kthehen te Zoti i tyre, ata nxitojnë të bëjnë vepra të mira dhe për këto punë janë të parët.” (Mu’minunë, 57-61).

Ndërsa e përmendim këtë moral të lartë, do të doja të mos e mendojmë imagjinari, të



“Hallalli është i qartë dhe harami është i qartë, e ndërmyjet tyre ka gjëra të dyshimta që shumica e njerëzve nuk dinë t’i dallojnë. Kështu, ai që i ruhet të dyshimtave, ai e ka ruajtur fenë dhe nderin e vet...”

(Hadith)

pamundur; jo, ai jetësohet dhe dëshmitë për këtë janë të panumërta. Ne po sjellim një dëshmi profetike. Ebu Hurejre, *Allahu qoftë i kënaqur me të!*, përcjell nga Profeti Muhamed a.s., se ai ka thënë: “Një njeri bleu nga një tjetër një parcelë toke në të cilën gjeti një qyp me ar. Shkoi tek ish-pronari dhe i tha: “Merre arin tënd prej meje, unë e kam blerë tokën, jo arin!” Shitësi ia ktheu: “Unë ta kam shitur tokën me çdo gjë që posedon.” Shkuan tek një njeriu që t’ua zgjidhte këtë mesele. “A keni fëmijë?” - i pyeti. Njëri tha: “Unë e kam një djalë”, ndërsa tjetri tha: “Unë e kam një vajzë.” Atëherë martojini ata dhe shpenzoni për ta nga kjo pasuri dhe (pjesën tjetër) jepeni lëmoshë!”<sup>7</sup>

Për ta përmbledhur tërë konceptin e *vereit* me një fjalë, do t’i referohesha dijetarit të madh, Sufjan Theuriut, i cili ka thënë: “Nuk kam parë më të lehtë (thjesht) se vere: *ajo që të bezdisë shpirtërisht lëre!*”<sup>8</sup>

## MIRËSJELLJA SI KRITER I RAPORTEVE ME TË GJITHË NJERËZIT

Besimtari mysliman nuk duhet të izolohet nga të tjerët, pavarësisht gjendjes së degraduar në të cilën mund të jetë. Izolimi është hapi i fundit që merret në rastet kur mbyllet çdo rrugë dhe kur fjala më nuk ka kuptim. Prandaj Profeti Muhamed a.s., ka thënë: “Besimtari që



shoqërohet me njerëzit dhe duron të këqijat e tyre është më i mirë se ai që nuk shoqërohet me njerëzit dhe nuk i duron të këqijat e tyre.”<sup>9</sup>

Marrë parasysh këtë, porosinë për t'i trajtuar njerëzit sipas moralit të tyre duhet lexuar në kontekst pozitiv. Nuk synohet në asnjë rast që të zbresësh në nivel të njerëzve me moral të ulët dhe të këqijat t'ua kthesh me të këqija. Parimisht e kundërta është bazë në fe. Trajtimi me moral dhe sjellje të mira. Kjo thënie, siç mund të kuptohet, përveç të tjerash edhe nga libri i Ibën Ebi Dunjasë *Mudaratul en-nas*<sup>10</sup> ka të bëjë me bërjen e qejfit të tjerëve, kënaqjen e tyre, miklimin dhe joshjen si moral i pëlqyer, jo si shtirje e hipokrizi. Madje, si nocion, e ka kuptimin e *butësisë*, shoqërimin të mirë, përballimit të sjelljeve të liga të të tjerëve, me qëllimin që të mos ikin dhe mos të largohen prej teje.<sup>11</sup>

Shoqërimi me njerëzit sipas moralit të tyre, nëse parimisht nuk paraqet ndonjë mëkat dhe nëse këtë e dikton nevoja, e veçmas për t'i mësuar dhe udhëzuar, është moral profetik.<sup>12</sup> Pra, ajo që synohet me këtë moral është që ne të mos largohemi nga disa njerëz që kanë sjellje e moral të keq, të qëndrojmë me ta e t'ua durojmë prapësitë e punët e mbrapshta të tyre, me qëllimin e udhëzimit të tyre në fe, në rrugën e drejtë.

Ky moral dhe kjo sjellje gjithsesi se do të japin efekt. *El Mudarah* ose miklimi nënkupton sjelljen e butë me njerëzit, mëshirën ndaj tyre, fjalët e buta dhe ikjen nga shprehjet apo fjalori i vrazhdë me ta. Ibën Kajimi e ka

“Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.”

(Fussilet, 34).

përkufizuar si *largim i të keqes me të mirë*. E kthimi i të keqes me të mirë ka ndikim të madh në përfitim të zemrave. Allahu i Madhëruar thotë: “Nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të të bëhet menjëherë mik i ngushtë.” (Fussilet, 34).

## PËRFUNDIM

Duke ndërtuar raport të sinqertë me Zotin dhe mirëdashës me njerëzit ne fitojmë dashurinë hyjnore, që është synimi më i lartë i një besimtari, dhe simpatinë e njerëzve, që na bën të jetojmë të qetë e të respektuar në mesin e tyre. Me fjalë të tjera, sigurojmë qetësinë dhe shpëtimin në këtë dhe botën tjetër.

1 Shih: Ibën Rexheb el Hanbelij, *Xhamiu el-ulum ve el-hikem*, red. shkenc. dr. Muhamed el Ahmedi Ebu Nur, (Kajro: Dar es-Selam, ed. 2, 2004), 2/538.

2 Buhariu, nr. 10; Muslimi, nr. 40.

3 Ahmed bin Hanbel, *Ezzuhdu*, (Bejrut: Dar el-kutub el-ilmije, 1999), nr. 406, f. 66; Ibën Ebi Dunja, *Mudaratul en-nas*, red. shkenc. Muhamed Hajr Ramadan Jusuf, (Bejrut: Dar Ibën Hazm, 1998), f. 49.

4 Për këto kuptime dhe shpjegimet vijuese jemi mbështetur kryesisht në *Enciklopedia e moralit dhe sjelljeve*, respektivisht në versionin elektronik të saj: <https://dorar.net/alakhlaq/2885/>

5 Tirmidhiu, 2518. Hadithi, sipas Albanit, është i saktë.

6 Buhariu, nr. 52; Muslimi, 1599.

7 Buhariu, nr. 3472; Muslimi, 1721.

8 *Err Rrisaletu el Kushejrijetu*, 1/235.

9 Tirmidhiu, nr. 2507. Albani e ka saktësuar.

10 Ibën Ebi Dunja, *Mudaratul en Nas*, vep. cit., f. 49.

11 Shih versionin elektronik të *Enciklopedisë së moralit dhe sjelljeve*, <https://dorar.net/alakhlaq/2508/>

12 Shih: Nexhmudin Gazzî, *Husnu ettenbih lima verede fi etteshibih*, red. shkenc. Komision nën mentorimin e Nuru-din Talib, (Siri: Dar en-Nevadir, 2011), 5/63.

# Të drejtat e përgjithshme për “ehlu dhimme” – jomyslimanët (2)

**Mbrojtja e jetës** – jeta e jomyslimanit është si jeta e myslimanit.

**E drejta penale** – është e njëjtë për myslimanin dhe jomyslimanin. Për atë krim që myslimani ndëshkohet, gjithashtu në të njëjtën mënyrë edhe jomyslimani do të ndëshkohet.

**Kodi civil** – myslimani dhe jomyslimani, përpara këtij kodi janë të barabartë.

Jomyslimani ka të drejtë të mbajë, të rrisë, të shesë dhe të hajë prej mishit të derrit. U jepet e drejta të prodhojnë, të pinë dhe të shesin alkool. Në qoftë se një mysliman i dëmton një jomyslimani alkoolin, ose derrin, ai duhet të paguajë dëmin e shkaktuar.<sup>1</sup>

**Mbrojtja e nderit dhe e personalitetit** – nuk lejohet t'i bëhet keq, as me dorë dhe as me gojë jomyslimanit. As të shahet, të fyhet, të goditet dhe as të përgojohet. “Përgojimi i jomyslimanit është i ndaluar, haram, sikur përgojimi i myslimanit.”<sup>2</sup>

**Garancia e mbrojtjes** – marrëveshja e mbrojtjes<sup>3</sup> i detyron myslimanët ta zbatojnë përgjithmonë atë. Nuk i lejohet asnjë myslimani që ta thyjë atë, pasi ta ketë nënshkruar. Ndërsa njerëzit e “mbrojtur”, ehlu dhimme, janë të lirë në zbatimin e saj, mund ta prishin kur dhe si të duan.

**Garancia e mbrojtjes - marrëveshja e mbrojtjes i detyron myslimanët ta zbatojnë përgjithmonë atë.**

Personi i mbrojtur (dhimmiju), çfarëdo krimi që kryen nuk e prish marrëveshjen, madje as edhe mospagimi i xhizjes, apo vrasja e një myslimani, nuk e thyen këtë marrëveshje (mbrojtje). Për të gjitha këto veprime, jomyslimani dënohet ose ndëshkohet sipas ligjit të krimeve të bëra. Veprimet e tij nuk konsiderohen si arrogancë ndaj shtetit dhe as nuk e përjashtojnë nga marrëveshja e mbrojtjes.

Vetëm dy gjëra ia ndalojnë të drejtën e përfitimit dhe e përjashtojnë nga marrëveshja:

**E para** – në qoftë se largohet nga territoret islame dhe emigron drejt shteteve të tjera,

**E dyta** – në qoftë se del haptazi ndaj shtetit islam dhe shkakton trazira nëpër territoret e këtij shteti.<sup>4</sup>

**Çështjet civile** – jomyslimani i trajton duke i gjykuar sipas ligjit të tij civil. Umer ibën Abdulazizi i shkroi letër Hasan Basriut për ta pyetur: “Si ka qenë çështja e kalifëve rashidinë, të cilët kanë lejuar jomyslimanët të martohen në mënyra të ndaluara, të zotërojnë, të hanë dhe të pinë alkoolin dhe mishin e derrit?” Hasan Basriu i ktheu përgjigje duke i thënë: “Xhizja merret në shkëmbim që të lihen dhe të mos ndërhyhet në punët dhe në besimin e tyre. Ti je “*muttebi la mubtedi*”, pasues dhe jo shpikës. Selam.”<sup>5</sup> Në qoftë se dy palë prej jomyslimanëve të përfshirë në ndonjë konflikt



mes tyre, dëshirojnë të gjykohen sipas sheriatit islam, atëherë me dëshirën e tyre zbatohet gjykimi i sheriatit. Por, në qoftë se njëra palë e përfshirë në konflikt është myslimane dhe çështjen në konflikt e përfshin kodi civil, atëherë mes palëve gjykohet vetëm me sheriatin islam.

**Simbolet fetare** – jomyslimanët janë të lirë dhe gëzojnë të drejtën të shfaqin simbolet e tyre fetare brenda dhe jashtë vendeve të adhurimit që kanë. Ata janë të lirë t'i restaurojnë dhe t'i rregullojnë këto vende adhurimi. Shteti islam nuk ka të drejtë të ndërhyjë në këto çështje.

**Lehtësimi dhe toleranca në marrjen e xhizjes dhe të taksave** – është e ndaluar të sillësh ashpër dhe me arrogancë ndaj jomyslimanëve në marrjen e xhizjes dhe të taksave. Madje nxitet për butësi, mëshirë dhe lehtësi ndaj tyre për çdo gjë. Kushdo prej tyre që është i varfër, ose nevojtarë, jo vetëm lirohet nga pagesa e xhizjes, por edhe i jepet ndihmë sociale prej buxhetit të myslimanëve. Në qoftë se jomyslimani vdes dhe ai ka pa paguar xhizjen, atij nuk i merret asgjë prej trashëgimisë së tij dhe as prej trashëgimtarëve të tij, për të likuiduar xhizjen e papaguar.

Ebu Jusuf el Kadi<sup>6</sup> ka thënë: “Në qoftë se një jomysliman ka hyrë në të drejtën e pagimit të xhizjes dhe vdes pa paguar, ose ka paguar një pjesë dhe ka mbetur pa shlyer pjesën tjetër, nuk lejohet të merret prej trashëgimtarëve dhe as prej trashëgimisë së tij.”<sup>7</sup>

Ibën Abidini përmend në “Hashije” se të gjithë fukahatë, dijetarët ekspertë myslimanë, të të gjitha shkollave të interpretimit, ixhtihadit, kanë bërë të qartë dhe e kanë përsëritur se myslimanët kanë për detyrë të mbrojnë dhe të sigurojnë jomyslimanët ndaj çdo rreziku, apo sulmi armiqësor. Kur myslimanët u kanë siguruar mbrojtjen, atëherë janë të detyruar që t’ua garantojnë të tillë mbrojtje, sepse duke u gjendur në territorin islam, ata do të quhen gjithashtu nënshtetas islam. Madje, disa dijetarë janë të mendimit se, padrejtësia dhe zullumi ndaj jomyslimanëve është më i rëndë dhe më i dënueshëm sesa ndaj myslimanëve.

## SAMËRKANDI

Samërkandi,<sup>8</sup> i cili në Islam u njoh si djepi i qytetërimit islam, u çlirua për herë të parë nga

“Ushtria myslimane që ka hyrë në Samërkand, nën komandën e Kutejbes, të përgatitet për t’u larguar menjëherë. Gjithashtu, të largohen edhe myslimanët e tjerë që kanë hyrë pas çlirimit.”

(Xhumej ibën Hadir Naxhi)

emeviti Seid ibën Uthmani, pastaj herën e dytë e çliroi me forcë Kutejbe ibën Muslim Bahili në periudhën e kalifit Velid ibën Abdulmelik.

Banorët e Samërkandit u detyruan ta pranonin këtë situatë. Gjatë sundimit të kalifit Umer ibën Abdulaziz, në vitin 99h këta banorë dërguan një delegacion për t’u ankuar ndaj veprimeve të Kutejbe ibën Muslim Bahili, kjo, pasi kalifi Umer ibën Abdulaziz u njihte për drejtësinë e madhe të tij në të gjithë territorin islam. Gjatë bisedës me kalifin, delegacioni i tha këtij të fundit: “Kutejbe na ka mashtruar padrejtësisht, na ka zaptuar tokat tona, prandaj kemi ardhur te ty që të na kthesh të drejtat tona.”

Kalifi mori laps e letër dhe filloi t’i shkruante Selman ibën Ebi Serhit, mëkëmbësit të tij në Samërkand, duke i thënë: “Banorët e Samërkandit janë ankuar për padrejtësitë që ka bërë Kutejbe. Sapo letra ime të mbërrij, cakto një gjykatës dhe të gjykojë me drejtësi në këtë zullum që u është bërë këtyre njerëzve.”

Delegacioni u kthye, ku me vete morën dhe letrën e kalifit për mëkëmbësin e tij. Çështja iu ngarkua gjykatësit të Samërkandit, Xhumej ibën Hadir Naxhi. I dëgjoi me vëmendje, thirri dëshmitarët nga të dyja palët, të cilët dëshmuan me drejtësi se, Kutejbe nuk i kishte qëndruar marrëveshjes, por i kishte sulmuar befasisht.



Pasi gjykatësi e zbardhi çështjen, dha gjykimin e tij të qartë, i cili fliste në emër të drejtësisë islame dhe tolerancës së tij. Në fund gjykatësi vendosi: “Ushtria myslimane që ka hyrë në Samërkand, nën komandën e Kutejbes, të përgatitet për t’u larguar menjëherë. Gjithashtu, të largohen edhe myslimanët e tjerë që kanë hyrë pas çlirimit.”

Ky vendim ishte një lëkundje e madhe në të gjithë Samërkandin, sepse nuk e kishte imagjinuar askush se mësimet e Islamit do të arrinin deri në këtë pikë, sa që t’i japë të drejtën një gjykatësi të urdhërojë ushtrinë për t’u larguar nga vendi në të cilin ishin vendosur.

Mëkëmbësi i Samërkandit lajmëroi kalifin dhe i kërkoi të këshillohej për vendimin e gjykatësit. Përgjigja ishte: “Zbatoni menjëherë vendimin e gjykatësit. Ushtria dhe myslimanët e tjerë të lëshojnë menjëherë qytetin.”

Ushtria dhe myslimanët filluan përgatitjen për t’u larguar. Myslmanët nxorën plaçkat për t’i shitur dhe u përshëndeten me banorët e Samërkandit. Papritur, një delegacion i banorëve të Samërkandit, të mahnitur nga ky veprim dhe pas konsultimit me njëri-tjetrin, u drejtohen myslimanëve duke u thënë: “Pasi dëgjuam vendimin e gjykatësit, të cilin ne nuk e kemi imagjinuar se mësimet e Islamit arrijnë deri në këtë pikë. Nuk kemi menduar se një gjykatës mund të urdhërojë ushtrinë për t’u larguar nga qyteti, madje menduam se gjykatësi do të neglizhonte çështjen duke mos i kushtuar rëndësi dhe vëmendje. Nuk e kemi menduar se kalifi do të urdhërojë për zbatimin e vendimit të gjykatësit dhe, askush nuk do ta kundërshtonte, por do t’i binden dhe do ta zbatonin të gjithë këtë urdhër.”

Përpara gjithë kësaj sjellje të mirë nga vëllezërit e tyre myslimanë, gjatë qëndrimit të tyre në Samërkand, banorëve

nuk u mbeti gjë tjetër vetëm se, të tërheqin kërkesën e tyre për largimin e myslimanëve dhe ushtrisë së tyre, dhe t’u kërkojnë të qëndrojnë ashtu siç kanë qenë më përpara, sepse pas kësaj dite nuk kanë më frikë se do t’i dëmtojë kush. Pas kësaj dëshire të sinqertë të banorëve të Samërkandit, u urdhërua ushtria dhe myslimanët të qëndrojnë dhe të mos largohen. Ishte kënaqësi e përbashkët për të dyja palët.

Kjo ngjarje ishte shkak për islamizimin e pjesës më të madhe të banorëve të Samërkandit. Ata u bindën ndaj flamurit të Islamit dhe me sinqeritetin e tyre ndaj mësimëve të fesë, filluan punën për përhapjen e Islamit. U kapën fort për fenë e Allahut sa që, Samërkandi u bë qendër e dijes dhe e dijetarëve.<sup>9</sup>

### PAS ÇLIRIMIT TË KOSTANDINOPOJËS

Hapi i parë që Sulltan Mehmeti II<sup>10</sup> mori pas rënies së Kostandinopojës dhe kthimit të rregullit dhe qetësisë, ishte sigurimi i mbrojtjes së të krishterëve. Ai e paraqiti veten mbrojtës të kishës greke dhe ndaloi rreptësisht çdo lloj dhune, ose padrejtësie ndaj të krishterëve. Zyrtarisht i dha patriarkut të ri siguri për të gjithë priftërinjtë dhe të krishterët, madje i lejoi që priftërinjtë të gëzonin të drejtat dhe ofiqet që kishin pasur më përpara. Genadios<sup>11</sup> ishte patriarku i parë që pas rënies së Kostandinopojës, mori nga dora e vetë sulltanit skeptrin e peshkopatës, i cili ishte simboli i këtij posti dhe së bashku me të edhe 1000 dukatë ari.<sup>12</sup>

Myslmanët çlirues, në shumë pjesë të Perandorisë Bizantine u pritën mirë nga grekët. Ata i konsideruan si çlirues prej sundimit tiran të padrejtë, sundimit francez dhe austriak. I kishin nënshtruar aq shumë njerëzit, sa që i kishin kthyer në skllëvër, të cilët i trashëgonin.<sup>13</sup> Shumë historianë e





kanë përshkruar gjendjen e Perandorisë Bizantine përpara çlirimit të saj.

Asnjë qeveritar nuk ka frikë ligjin që i ngjan kalit pa frena. Konstandini dhe paraardhësit e tij i lejuan njerëzit e mëdhenj të shtetit të tyre të tiranizojnë popullin. Në gjykatat e tyre nuk kishte drejtësi dhe në zemrat e tyre nuk kishte trimëri. Gjykatësit mblodhën pasuri të mëdha nga lotët dhe gjaku i të pafajshmëve.<sup>14</sup> Ndërsa çliruesit myslimanë, pas gjithë kësaj pamje të zymtë arritën me mirësinë dhe udhëheqjen këmbëngulëse e të përpiktë, të përhapnin rregullin e qetësinë në të gjitha anët e perandorisë. Pamë një rregull të mrekullueshëm në çështjet gjyqësore dhe qytetare.<sup>15</sup>

Shumë njerëz e pranuan dhe e përqaftuan Islamin, përse? Feja islame, në atë kohë, ishte streha e vetme natyrale për pjesëtarët e kishës lindore.<sup>16</sup>

Gjatë një beteje mes osmanlinjve dhe rumunëve, Gjergj Brankoviçi<sup>17</sup> e pyeti Jan Huniadin:<sup>18</sup> “Në qoftë se fiton, çfarë do të kishte bërë?” I përgjigjet: “Do të themeloi besimin katolik romak.” Pastaj pyet sulltanin otoman: “Në qoftë se fiton, çfarë do të bësh me fenë tonë?” I përgjigjet: “Pranë çdo xhamie do të ndërtoj një kishë dhe do t’i jap lirinë çdo njeriu të zgjedhë për t’u falur ku të dëshirojë.”<sup>19</sup>

Pastori Miçu, në librin e tij *“Udhëtim fetar në Lindje”* thotë: “Është për të ardhur keq, që popujt e krishterë nuk huazuan asgjë nga toleranca e myslimanëve, e cila është shenja e bamirësisë mes popujve, respektimi i besi-

meve të të tjerëve dhe mos detyrimi me forcë i besimit.”<sup>20</sup>

Prifti i qytetit Lori, Rimon Dagil thoshte: “Sjelljet e kryqëzatave në kohën që hynë në Kuds, ishin të kundërta me sjelljet e kalifit bujar, Umer ibnul Hatab ndaj të krishterëve, në kohën kur ai hyri në Kuds, përpara disa shekujve. Populli ynë, me të marrë Kudsin bëri gjëra të çuditshme me arabët. Disave ua prenë kokat dhe kjo ishte më e pakta, të tjerëve i shponin barkun, madje disa detyroheshin të hidheshin nga muret e qytetit për t’i shpëtuar torturave. Pasi torturoheshin shumë, digjeshin. Në rrugët dhe sheshet e Kudsit nuk mund të shihje tjetër, vetëm grumbujt e kokave të arabëve, duarve dhe këmbëve të tyre. Njeriu nuk mund të kalonte, vetëm përmes kufomave të të vranëve, por të gjitha këto ishin një pjesë e asaj që bënë kundër këtyre njerëzve.”

Po ky prift tregon historinë e kasaphanës së dhjetë mijë myslimanëve në xhaminë e Umer ibnul Hatabit, ku thotë: “Populli ynë e teproi së tepërmi në derdhjen e gjakut.”<sup>21</sup> “Mund të themi se toleranca fetare ishte absolute në rolin e lulëzimit të qytetërimit arab.”<sup>22</sup>

“Të krishterët, sapo e kthyen Granadën, e cila ishte nyja e fundit e Islamit në Evropë, nuk menduan të ecnin në rrugën e tolerancës së arabëve, të cilën e kishin parë me sytë e tyre për disa shekuj me radhë. Por ata ndoqën rrugën e persekutimit dhe të dhunës së madhe ndaj arabëve, edhe pse kishin nënshkruar marrëveshjet me ta.”<sup>23</sup>

**Historia e përhapjes së Islamit me urtësi dhe mirësi është e gjatë. Me bindje, me mendje dhe me tolerancë, Islami arriti deri në Siberi, Indi, ishujt Maldive, Tibet, brigjet e Kinës, Filipine, Indonezi etj..**

Historia e përhapjes së Islamit me urtësi dhe mirësi është e gjatë. Me bindje, me mendje dhe me tolerancë, Islami arriti deri në Siberi, Indi, ishujt Maldive, Tibet, brigjet e Kinës, Filipine, Indonezi etj.. Gjithashtu, me tolerancë dhe me thirrje të mirë, Islami arriti deri në mesin e Afrikës.

Akuzat se Islami është përhapur me forcë, dhunë dhe vrasje, etj., sidomos gjatë sundimit osman dhe se osmanët i detyruan shqiptarët të pranojnë Islam, përkundër dëshirës së tyre, jo vetëm nuk ka fakte dhe vërtetësi, por kjo gjë kundërshtohet dhe hidhet poshtë nga autorë jomyslimanë, të cilët kanë shkruar rreth konvertimit në Islam të popullsisë shqiptare.

Profesor Ali Musa Basha, në librin e tij *“Islami në Shqipëri gjatë shekujve”*, sjell fakte dhe dëshmi rreth islamizimit të shqiptarëve, duke thënë: “I gjithë ky konvertim masiv në fenë islame, veç të tjerave, shpjegohet edhe se Perandoria Osmane në shekullin XVII kishte arritur kulmin e saj. Ajo u kishte dhënë të gjithë popujve që e përbënin atë, një qytetërim të përbashkët. Të gjithë ata që në Perëndim nuk e duronin intolerancën katolike, e cila u ishte bërë e padurueshme, si: çifutët, maurët e Spanjës, gjithë punëtorët e kualifikuar, zanatçinjtë, endësit, specialistët e ndërtimeve detare, fonditorët e artillerisë etj., të tërhequr nga fitimi, në pjesën më të madhe u konvertuan vullnetarisht në fenë islame. Aderuan në këtë fe, të bindur në superioritetin e fesë islame mbi fetë e tjera.”<sup>24</sup>

Si përfundim, humanizmi dhe toleranca janë dy karakteristika gjenetike të shoqërisë islame dhe të flasësh për humanizmin dhe tolerancën e myslimanëve përgjatë historisë, unë mendoj se kjo gjë i ngjan sikur të flasësh për diellin në një vend, që tërë ditët e vitit i ka me diell. Dhe se këta njerëz, të cilët jetojnë në një vend të tillë me diell, nuk e kuptojnë dhe nuk e imagjinojnë jetën e tyre pa këtë dritën e diellit. Kështu është edhe myslimani, ai nuk e imagjionon dhe nuk e kupton shoqërinë islame pa humanizëm dhe tolerancë.

E vërteta është se ne myslimanët duhet që historinë tonë të ndritur ta promovojmë dhe ta përhapim sa më shumë, e të mos qëndrojmë në rolin e mbrojtësit sa herë që etiketohemi me diçka të paqenë, por të ndjehemi krenarë me të dhe të marrim rolin e mësuesit të njerëzimit, promovuesit të vlerave dhe prijësit të virtyteve.

Zoti i Madhëruar na dhëntë sukses dhe mbarësi në rrugën tonë të shërbimit ndaj Islamit, myslimanëve dhe mbarë njerëzimit!

1 Në lidhje me këtë pikë, në librin *Ed Dur el Muhtar*, vëllimi III, faqe 273 shkruhet: “Në qoftë se myslimani i dëmton jomyslimanët alkooolin ose derrin, myslimani është i detyruar të paguajë dëmin e shkaktuar.”

2 *Ed Dur el Muhtar*, 3/273-274.

3 Akdu dhimme.

4 El Bedaiu, 7/113, Fet’ul Kadir, 4/381-382.

5 *“Të drejtat e jomyslimanëve në shtetin islam”*, Ebu E’ala el Mevdudi, fq. 18.

6 Ai është imami muxhtehid, kolosi, muhadithi, gjykatësi i gjykatësve, Ebu Jusuf, Jakub ibën Ibrahim Habib ibën Hubejsh ibën Sead ibën Buxhejr ibën Muavije el Ensarij el Kufij (113-182).

7 *El Haraxh*, fq.70.

8 Samarkand (Uzbek: Samarqand, Самарқанд, Tajik: Самарқанд, Persian: سمرقند, Russian: Самарканд) is the second-largest city in Uzbekistan and the capital of Samarqand Province. The city is most noted for its central position on the Silk Road between China and the West, and for being an Islamic centre for scholarly study. The Bibi-Khanyam Mosque remains one of the city’s most famous landmarks. The Registan was the ancient centre of the city. In 2001, UNESCO inscribed the 2,750-year-old city on the World Heritage List as Samarkand - Crossroads of Cultures. Shiko: <http://en.wikipedia.org/wiki/Samarkand>

9 Tabariu, 6/567.

10 Mehmet II (Ottoman Turkish: محمد الثاني Mehmed-i sāni, Turkish: II. Mehmet), (also known as el-Fātiḥ (الفتح), “the Conqueror”, in Ottoman Turkish, or, in modern Turkish, Fatih Sultan Mehmet; known as Mahomet II[1][2] in early modern Europe) (March 30, 1432, Edirne – May 3, 1481, Hünkârçayırı, near Gebze) was Sultan of the Ottoman Empire (Rûm until the conquest) for a short time from 1444 to September 1446, and later from February 1451 to 1481. At the age of 21, he conquered Constantinople, bringing an end to the Byzantine Empire. Mehmet continued his conquests in Asia, with the Anatolian reunification, and in Europe, as far as Belgrade. ([http://en.wikipedia.org/wiki/Sultan\\_Mehmet\\_II](http://en.wikipedia.org/wiki/Sultan_Mehmet_II)).

11 Gennadius II (in Greek Γεννάδιος Β΄) (lay name Georgios Kourtesios Scholarios, in Greek Γεώργιος Κουρτέσιος Σχολάριος) (c. 1400 – c. 1473), Ecumenical Patriarch of Constantinople from 1454 to 1464, philosopher and theologian, was one of the last representatives of Byzantine learning, and a strong advocate of Aristotelian philosophy in the Eastern Church. Shiko: [http://en.wikipedia.org/wiki/Gennadius\\_II](http://en.wikipedia.org/wiki/Gennadius_II)

12 *Dawetu ilel Islam*, faqe 170-171.

13 *Dawetu ilel Islam*, faqe 172, prej: *The travels of Martin Baumgarten*, p.373.

14 *Dawetu ilel Islam*, faqe 173.

15 *Dawetu ilel Islam*, faqe 174.

16 *Dawetu ilel Islam*, faqe 187.

17 Đurađ Branković (Serbian Cyrillic: Ђурађ Бранковић; Hungarian: Brankovics György; 1377 – 24 December 1456), also known under the patronymic (Đurađ) Vuković and frequently called George Branković in English-language sources, was a Serbian despot from 1427 to 1456 and a baron of the Kingdom of Hungary. He was the first of the House of Branković to hold the Serbian monarchy. (Shih: [http://en.wikipedia.org/wiki/%C4%90ura%C4%91\\_Brankovi%C4%87](http://en.wikipedia.org/wiki/%C4%90ura%C4%91_Brankovi%C4%87)).

18 John Hunyadi (Hungarian: Hunyadi János, Romanian: Iancu de Hunedoara, Slovak: Ján Huňady, Serbian: Сибињанин Јанко / Sibirjanin Janko; c. 1387[1] – 11 August 1456), nicknamed the Éhite Knight[2] was a Hungarian general (1444–1446) and governor (1446–1453) of the Kingdom of Hungary.[3], a leading commander against the Turks in the 15th century.[3] He was also a Voivode of Transylvania (1441-1446) and the father of Matthias Corvinus, King of Hungary. (Shih: [http://en.wikipedia.org/wiki/Jan\\_Hunyadi](http://en.wikipedia.org/wiki/Jan_Hunyadi))

19 *Dawetu ilel Islam*, faqe 223, prej: *Enripue Dupuy De Lome*: Eschavosy. Turgufa P.17-18, “Madrid 1887”.

20 *Hadaratul arab*, Gustave Le Bon, faqe 162.

21 *Po aty*, faqe 401.

22 *Po aty*, faqe 681.

23 *Po aty*, faqe 694.

24 *“Islami në Shqipëri gjatë shekujve”*, Ali Musa Basha, f. 91-92, Tiranë, 2000. (Vepër e cituar, Jani Kicikis. Encyclopeida Universalis. Copus 8, Francë S.A. 1988)

# Kurani në Islam<sup>1</sup>

## KURANI – FJALA E ZOTIT MBI ZOTIN, FJALA E ZOTIT MBI ABSOLUTIN

**K**urani nuk është një lexim i strukturuar sipas logjikës (së njeriut) për të ndjekur një histori nga fillimi deri në fund. Përkundrazi, nga faqet e Kuranit lexuesve u jepet një mori shtresash, nivelesh apo planesh të tekstit hyjnor. Vetë leximi i Kuranit është në të njëjtën kohë një akt interpretimi i Kuranit, ose “sistematizimi” i Kuranit nga njeriu/lexuesi. Interpretimet e deritanishme të Kuranit kanë zbuluar dhe njohur shumë fusha në Kurani: teofanike, eskatologjike, kozmologjike, etike, antropologjike...<sup>2</sup>

Por në Islamin si fe, kulturë dhe qytetërim, vendi i mesazhit kuranor, si dhe rëndësia dhe kuptimi kuranor me simbolikën e tyre të shenjtë, janë shumë më lart sesa përmbajtja tematike, forma e jashtme dhe pamja librore e Kuranit. Në mesazhin e Kuranit, myslimanët besojnë si në Fjalën e drejtpërdrejtë dhe të përjetshme të Zotit (*Verbum Dei*), po ashtu edhe në thirrjen absolute që Muhamedi i përcolli njerëzimit,<sup>3</sup> të cilën atij ia komunikoi drejtpërdrejt meleku Xhibril.

*Zoti - Kurani - Muhamedi (Njeriu)* është një zinxhir apo sekuencë transmetimi, që njeh njerëzit myslimanë si një drejtim vertikal dhe si një rrugë zbritjeje të Fjalës së Zotit apo Mesazhit Absolut Përjetësia në kohë, në histori.

**Zoti (Allahu),  
Qenia e Tij e  
Paarritshme  
dhe  
Madhështore,  
me misterin e  
Tij mbetet i  
fshehur dhe i  
mbuluar në  
thellësitë e  
qiellit të kaltër,  
por në të  
njëjtën kohë  
zbulohet në  
univers,  
natyrë, botë  
dhe histori.**

Sipas botëkuptimit islam, Zoti kurrë nuk e shfaq veten si person, si karakter, si formë, si imazh. Zoti e zbulon Vetën duke ia dërguar Fjalën e Tij njerëzimit ose nëpërmjet krijimit të Tij të panumërt të botëve të universit të pafund.

Zoti (*Allahu*), Qenia e Tij e Paarritshme dhe Madhështore, me misterin e Tij mbetet i fshehur dhe i mbuluar në thellësitë e qiellit të kaltër, por në të njëjtën kohë zbulohet në univers, natyrë, botë dhe histori, për më tepër, është i pranishëm – siç thotë Kurani – në zemrën e njeriut, në damarin e qafës së tij. Një nga mesazhet më të forta të Kuranit është se Zoti është edhe një realitet transcendent (*el Baṭin*) dhe një realitet imanent (*edh Dhahir*),<sup>4</sup> dhe se Ai vazhdimisht shpallet, vazhdimisht i shfaqet të gjitha botëve.

Vetë Kurani pohon fuqishëm dy forma të Shpalljes ose Revelatës (*vahj*) ose dy forma të manifestimit të realitetit të përjetshëm hyjnor.

Aspekti i parë i Shpalljes së Zotit ndodh duke dërguar Fjalën e Zotit krijesave të Tij. Zoti ua zbulon-shpall Fjalën e Tij të dërguarve të Tij, p.sh. Ibrahimit, Musait, Davudit, Isait, Muhamedit. Zoti e zbulon gjithmonë Fjalën e Tij në gjuhën e njerëzve nga i cili vjen i dërguari i Zotit në fjalë.

Të jesh mysliman do të thotë të besosh në vazhdimësinë monoteiste të Shpalljes së Zotit, të besosh në të gjithë librat e Zotit dhe në të gjithë të dërguarit dhe lajmëtarët e Zotit. Në këtë aspekt, Islami është një valë e madhe dhe



e fuqishme shpirtërore, që në vazhdimësi ua rikujton njerëzimit ekzistencën e Zotit dhe rëndësinë e besimit në Zot.<sup>5</sup> Është vazhdimi i mesazhit monoteist ku Islami është i hapur ndaj Judaizmit dhe Krishterimit, ku e konsideron veten pasardhës, por edhe ripërtëritës të freskët të monoteizmit historik apo pikëpamjes së pa kompromis se, universi i pafund, njësitë e panumërta, të gjitha botët e Tokës dhe Qiellit kanë vetëm një Krijues.<sup>6</sup>

Në të vërtetë, në shumë faqe dhe në variacione të ndryshme, Kurani i kujton fuqimisht gjithë njerëzimit të kujtojë, gjithmonë e pa pushim, se Zoti është një Një dhe i Vetëm Krijues. Nuk ka Zot përveç Tij! Në Shpalljen e Zotit në formën e Fjalës së Zotit (pra: në librat *Tevrat*, *Zebur*, *Inxhil* dhe *Kuran*) zëri i të Vetmit Zot është mbi të gjithë zërat e tjerë.

*Një Zot*, ky është mesazhi themelor, pika e parë rreth së cilës përqendrohen të gjitha temat dhe rrëfimet e tjera të librave fetarë të rrethit monoteist semit, e veçanërisht të Kuranit. Islami e konsideron veten trashëgimtar të lavdishëm të atij mesazhi madhështor.

Lloji i dytë, ose forma tjetër e Shpalljes të Qenies së Madhërishtme Hyjnore, sipas Kuranit, duhet të zhvillohet dhe vëzhgohet në *Kozmosin*, *universin*, *natyrën*, *shpirtin*... Në Kuran, fjalët *ajatu-llah* (shenjat hyjnore) në të njëjtën kohë i referohen: *a)* artikujt dhe versetet kuranore, dhe *b)* dukuritë në natyrë dhe në univers.

Këto dy aspekte të Shenjave Hyjnore, mistikët islamë i kanë shprehur me thënien: *Kurani është Natyra që flet, Natyra është Kurani që hesht!*<sup>7</sup>

Këto janë arsyet kryesore pse myslimanët e respektojnë shumë Fjalën kuranore në origjinalin e saj arab, pse e përkthejnë mesazhin e saj në gjuhë të shumta, pse e ngrenë dhe e transmetojnë këtë Zë kuranor në kohë dhe hapësirë, pse besojnë në Kuran si Fjala e gjallë dhe e përjetshme e Zotit, shfaqja e zërit të përjetshëm të Absolutit.

*Kurani nuk është Zot, Kurani është Fjala e Zotit!* Kjo kredo islame i mëson myslimanët se për ta Kurani është teofania më e fuqishme, *të folurit* e patejkalueshëm dhe të pakrahasueshëm të Zotit, tregimi i përjetshëm i Fjalës së Zotit.<sup>8</sup> Ka edhe arsye për pozicionin qendror të Kuranit në ritualet islame, kodet morale, mësimet teologjike, shprehjet artistike etj..

### ISLAMI – NËNSHTRIM NDAJ ZOTIT, MESAZHI THEMELOR I KURANIT

Nëse Kurani është Fjala e Zotit, atëherë çfarë është *Islami* dhe ku është vendi i njeriut? Dhe pse *Islami* ka të bëjë me njeriun?

Edhe pse Kurani dëshmon dhe kujton se përveç njeriut gjithmonë ka pasur (dhe ka) shumë marrës ose pranues të tjerë të Fjalës së Zotit ose të Frymëzimit Hyjnor (p.sh. Toka, Qielli, kafshët, botët shpirtërore, etj.), megjithatë, sipas Kuranit, njeriu është pranuesi më i rëndësishëm i Shpalljes së Zotit. Në këtë pikë duhet përmendur *Islami* (kjo fjalë arabe nënkupton *nënshttrimin* e të gjitha krijesave ose *nënshttrimin* e njeriut ndaj Krijesit të tij, Zotit Një dhe të Vetëm).

Kurani nuk mund të kuptohet siç duhet dhe as fjala e Kuranit nuk mund të realizohet siç duhet pa e ditur atmosferën dhe aromën e *Islamit* në faqet e tij. Shkurtimisht, sipas Kuranit, *Islam* është përgjigja e të gjitha krijesave, dhe përgjigja *eo ipso* dhe e njeriut ndaj Thirrjes Hyjnore, e cila ndryshon nga faqet e Fjalëve të Zotit, librave të Zotit (*Tevratit*, *Zeburit*, *Ingjilit* dhe *Kuranit*), ose nga anët dhe hapësirat e Universit.

Kurani në variacione të panumërta thotë se Zoti i Gjithëmëshirshëm dhe i Mëshirshëm dëshiron që krijesat e Tij t'i nënshtrohen Atij. Në të vërtetë, Kurani deklaroi se Qielli dhe Toka i janë nënshtroar Zotit, e madhërojnë Zotin (57:1) dhe janë vazhdimisht në sexhde para Tij (16:49). E njëjta gjë kërkohet edhe nga njeriu, nënshttrimi ndaj Zotit.

Këtu janë arsyet kryesore pse *islam* në arabisht (dhe në të fjalimin kuranor) do të thotë *nënshttrim ndaj Zotit*.

Për çfarëdo që thotë Kurani: qiejt e stolisur me yjësi, lëvizja e Diellit dhe e Hënës, lëvizja e reve, fryrja e erërave, mbirja e grurit, rritja e luleve të bukura, mbledhja e mjaltit nga bletët, bukuria e njeriut, shiu që bie, lumenjtë që rrjedhin, larmia e gjuhëve dhe ngjyrave njerëzore..., është gjithmonë një fjalim për *islam* ose rrëfimi i *islamit*.



Kështu mund të thuhet se *islam* është një sagë hyjnore e nënshtrimit të të gjitha krijesave ndaj Një Zoti, saga e rrëfyer në faqet e Kuranit.

Kurani e afirmon *islam*in (ose nënshtrimi universal ndaj Zotit Një dhe të Vetëm) në një mënyrë shumë të qartë dhe të hapur, si marrëdhënie themelore midis Zotit dhe krijesave të Tij. *Islami* i Kuranit shpjegohet si një *modus operandi* specifik i ekzistencës së universit, botës, jetës. Sepse, në këndvështrimin kuranor të botës, pothuajse çdo gjë, çdo krijesë, çdo galaktikë dhe çdo milingonë, janë në rrugën që çon në fund të rrugës, te Zoti Një dhe të Vetëm.

### ISLAMI SI FE E MYSLIMANËVE, SI FE E NJERËZIMIT MYSLIMAN

Në faqet e Kuranit shohim shumë qartë motivet e forta të Kuranit për të paraqitur, ofruar dhe formuluar *Islam*in si fe konkrete, fe myslimane, fe e njerëzimit mysliman. Në Kuran, përveç Islamit universal ose kozmik, ekziston një *Islam* shumë specifik ose njerëzor, d.m.th. *Islami* i një njeriu që është mysliman. (Fjala arabe *muslim*, do të thotë një person ose krijesë e nënshtruar ndaj Zotit).

Kështu, në shumë faqe, Kurani shfaqet si një libër që themelon një fe specifike, *Islam*in, një fe që ka rrënjët si një entitet i veçantë fetar që nga shekulli VII, përveç judaizmit, krishterimit, adhurimit të yjeve, idhujtarisë, adhurimit të zjarrit...

Nëse *Islami* universal ose kozmik (ose nënshtrimi universal i të gjitha botëve ndaj një

Zoti) përshkruhet në Kuran si përgjigja e të gjitha krijesave dhe të gjitha botëve ndaj Zotit ose Krijuesit, kjo shtresë e dytë e Kuranit, ose *Islami* si fe specifike e një segmenti të njerëzimit, është veçanërisht feja *myslimane*, iu destinohet njerëzve të cilët e pranojnë *Islam*in si fenë e tyre, si religjion të tyre.

Atëherë, si të lexohet Kurani nën dritën e postulateve për pluralizmin e religjioneve? Është e qartë se Kurani nuk e fsheh simpatinë e tij për myslimanët, por në të njëjtën kohë në faqet e tij Kurani trajton sekretin se pse ka shumë besime në Zot.

Në shumë vende, Kurani aludon për faktin se besimi në Zot ka kuptim të plotë vetëm nëse është rezultat i zgjedhjes së lirë të njeriut.<sup>9</sup> Kurani thotë haptazi: “Nuk ka detyrim në fe” (2:256). Gjithashtu, në suren 11:118 thuhet: “Sikur të kishte dashur Zoti yt, do t’i bënte të gjithë njerëzit në një besim! E megjithatë ata gjithmonë ndryshojnë në besim.” Kështu që Zoti nuk donte t’i detyronte njerëzit që të gjithë të jenë në një fe. Sepse, detyrimi do të anulonte aktin e lirisë njerëzore dhe lirisë së zgjedhjes. Ajeti i Kuranit 10:19 ka një temë të ngjashme: “Njerëzit nuk ishin tjetër pos të një feje, e u përçanë. E sikur të mos ishte caktim i hershëm nga Zoti yt, do të përfundohej (me dënim) mes tyre, për atë që ishin të përçarë.” Fjala që “i parapriu nga Zoti yt” është në fakt trashëgimi hyjnore e fesë si një akt i vlefshëm i lirisë njerëzore.

Por edhe ato pjesë të Kuranit që flasin për Islamit si një fe specifike të njerëzimit

Nga njëra anë,  
diskursi  
universal i  
Kuranit për  
Zotin buron  
nga vetë  
natyra e  
krijimit të  
njerëzimit nga  
Zoti si një  
mozaik i madh  
diversiteti.

mysliman janë plot me thënie universale për Zotin. Zoti i Kuranit nuk është vetëm Zoti i myslimanëve, por një Zot universal, “*Krijuesi dhe Zoti i të gjitha botëve*” (1:1-3). Kjo shihet më së miri nga ajeti: “*Vërtet, ata që besuan, ata që ishin jehudi, krishterët, sabejët (kishin lëshuar fenë e adhuronin engjëjt), kush besoi prej tyre (sinqerisht) Allahun, dhe botën tjetër dhe bëri vepra të mira, ata e kanë shpërblimin te Zoti i tyre.*” (2:62).

Nga njëra anë, diskursi universal i Kuranit për Zotin buron nga vetë natyra e krijimit të njerëzimit nga Zoti si një mozaik i madh diversiteti. Në suren 30:22, vihet në dukje drejtpërdrejt fakti që njerëzimi është i ndryshëm. Nga ana tjetër, fakti është se Kurani e vendos *Islamin* si fe dhe religjion i myslimanëve si një segment të veçantë dhe specifik të njerëzimit. Këto dy faqe të Kuranit duhet të shikohen në një marrëdhënie dinamike.

## ISLAMI SI FE, KULTURË DHE QYTETËRIM

Islami kaloi nga faqet e Kuranit në jetën e njeriut, u bë fe dhe me kalimin e kohës u bë edhe kulturë e qytetërim.<sup>10</sup> Roli i Kuranit në besimin mysliman është jashtëzakonisht i madh. Pjesa më e madhe e përmbajtjes nga besimi mysliman dhe praktikimi i atij besimi vjen nga faqet e Kuranit. Për shembull, gjashtë themelet e Islamit, ose besimit në: 1. Zotin, 2. engjëjt/melaqet e Zotit, 3. librat e Zotit, 4. Të dërguarit e Zotit, 5. Ditën e Gjykimit dhe 6. Fatin/Caktimin e Zotit; ato janë marrë drejtpërdrejt nga faqet e Kuranit.

Për më tepër, përshëndetja e përgjithshme myslimane *es selamu alejkum (Paqja qoftë mbi ju!)* vjen nga vetë Kurani, si dhe frazat kryesore të riteve myslimane në namazet dhe lutjet e përditshme. P.sh. të porsalindurve mysliman u afrohet me Fjalën kuranore, myslimanët varrosen me këndim të Kuranit, gjithashtu Fjala e Kuranit është bërë pjesëmarrëse në ceremonitë fetare, dasma, festa islame. Kështu, Kurani u bë jo vetëm burimi i besimit mysliman, por pjesërisht edhe përmbajtja e atij besimi. Gjithashtu, në disa shoqëri tradicionale myslimane, teksti i Kuranit është pranuar dhe normativ, si burim i të drejtave dhe rregulloreve.<sup>11</sup>

Në një kuptim specifik të riteve myslimane, të jesh *mysliman* do të thotë para së gjithash t'i përkushtohesh dëgjimit të Vullnetit dhe Qëllimit të Zotit, i cili komunikohet në Fjalën e Zotit, Kuran.

Hyrja në *Islam* si devotshmëri, por edhe si doktrinë fetare, dëshmon për një mesazh tjetër të rëndësishëm të Kuranit, *tevhidin* ose monoteizmin striktë, të rreptë. Pothuajse ndër zërat më të fuqishëm të Kuranit është zëri që lartëson njëshmërinë e Zotit. *Nuk ka zot tjetër përveç një Zot (La ilahe ila Allah!)*, ky është pozicioni qendror dhe themelor i Kuranit, është filli kryesor që dëshmohet në veprat, aktet, veprimet, ritualet, kulturën islame apo myslimane, arkitekturë, art.

Për shkak të faktit të lavdishëm se Islami nuk e ka institucionalizuar klerin, pjesëmarrja në ritet e menjëhershme është çështje e të gjithë myslimanëve, burra dhe gra. Në kuptimin ritual, Islami është një thirrje për secilin që të jetë shpëtimtari i tyre personal. Kështu, Islami ritual u bë një thesar simbolik i të gjithë myslimanëve, të gjitha komuniteteve dhe popujve myslimanë.

Gjatë historisë së tij, Islami është bërë një lloj mjedisi fetar, shoqëror, kulturor dhe qytetëruar i Kuranit, streha në të cilën ruhet Kurani, por vetë Kurani i ka dhënë gjithmonë freski këtij ambienti të përgjithshëm. Vendet tradicionale islame, nga Maroku deri në Indonezi, nga Afrika Sub-sahariane deri në skajet jugore të Siberisë, janë të njohura nga kultura dhe qytetërimi i tyre specifik islam, i pasur me shumë tipare dhe tranzicione rajonale që respektojnë specifikat racore, gjuhësore dhe kulturore.

Përktheu e përshtati nga gjuha boshnjake:

Dr. Azmir Jusufi

- 1 Enes Karić, *Kako čitati Kur'an – crtica (pretraga za strukturama cjeline temeljne Knjige islama)*, Sarajevë, 2019.
- 2 Ka shumë libra që tregojnë se si besimet dhe besimet islame rrjedhin nga teksti Kuranor. Një vepër e tillë është: Sachico Murata i William C. Chittick, *The Vision of Islām*, Paragon House, St. Paul, Minnesota, 1994.
- 3 Për jetën e Muhamedit, të Dërguarit të Zotit, shih: Martin Lings, *Muhammad, his life based on the earliest sources*, Islamic Texts Society, Cambridge, 1991. Karen Armstrong, *Muhammad, A Biography of the Prophet*, HarperSanFrancisco, 1992. Barnaby Rogerson, *The Prophet Muhammad, A Biography*, Abacus, London, 2003. Po ashtu, shih: Tariq Ramadan, *In the Footsteps of The Prophet, Lessons from the Life of Muhammad*, Oxford University Press, Oxford – New York, 2007.
- 4 Mbi transcencën dhe imanencën e Zotit në Islam, shih: Ian Richard Netton, *Allah Transcendent, Studies in the Structure and Semiotics of Islamic Philosophy, Theology and Cosmology*, Curson Press, 1989.
- 5 Për një përmbledhje gjithëpërfshirëse të përshpirtshmërisë islame, shih: Seyyed Hossein Nasr (urednik), *Islamic Spirituality (Foundations) i Islamic Spirituality (Manifestations)*, The Crossroad Publishing Company, New York, 1987.
- 6 Teologjia klasike islame e ka njohur gjithmonë vazhdimësinë e Shpalljes së Zotit. Kra. Tim Winter (redaktor), *The Cambridge Companion to Classical Islamic Theology*, Cambridge University Press, Cambridge, 2008.
- 7 Mbi leximet dhe interpretimet mistike të Kuranit, shih: Annemarie Schimmel, *Mystical Dimensions of Islam*, The University of North Carolina Press, 1975. Po ashtu shih: Annemarie Schimmel, *As Through a Veil, Mystical Poetry in Islam*, Oneworld, Oxford, 2001.
- 8 Mbi konceptin e Fjalës së Zotit në Islam, shih: Hans Küng, *Der Islam, Wesen und Geschichte*, Piper München Zürich, München, 2007.
- 9 Për drejtimet në teologjinë islame që mbështetën pikëpamjet e lirisë njerëzore, shih: Tilman Nagel, *Geschichte der islamischen Theologie von Muhammed bis zur Gegenwart*, Verlag C. H. Beck, München, 1994.
- 10 Një përshkrim i jashtëzakonshëm i kulturës dhe qytetërimit islam mund të shihet në veprën: Marshall G. S. Hodgson, *The Venture of Islam I – III*, The University of Chicago, Chicago, 1974.
- 11 Për vendin e Kuranit brenda ligjit klasik islam, shih: Wael B. Hallaq, *The Origins and Evolutions of Islamic Law*, Cambridge University Press, Cambridge – New York, 2005.



# Kujdesi dhe shfrytëzimi i mirë i kohës

Isa Tërshani

Allahu i Madhëruar na ka dhënë shumë të mira dhe begati, e s'ka dyshim se një ndër begatitë është edhe koha. Koha është dhuratë dhe një nga begatitë e mëdha ndaj nesh. Është shumë e rëndësishme mënyra se si jetohet jeta dhe si kalohet koha. Secili njeri ka kohën e vet të caktuar, të cilën duhet ta kalojë në këtë botë kalimtare. Në këtë jetë të kufizuar, kemi detyra dhe obligime, të cilat duhet t'i kryejmë sipas mundësive dhe aftësive tona, si ndaj vetvetes, familjes, rrethit dhe shoqërisë, por mbi të gjitha kemi obligime edhe ndaj Zotit të Madhëruar. Asnjë njeri i suksesshëm, nuk është përjetësuar thjesht me kohën që e ka kaluar, por si e ka shfrytëzuar dhe në atë kohë çka ka vepruar.



“Pasha kohën!  
Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.”

(El Asr, 1-3).

Jemi të vetëdijshëm se njeriu nuk është pronar-zotërues i jetës së vet dhe ndaj saj nuk do të duhej të jetë i pakujdesshëm dhe i papërgjegjshëm. Vdekjes, askush nuk mund t'i shpëtoj, ngase koha kalon, e ditët e kaluara nuk kthehen më, ato mbesin larg pas nesh. Ditët e muajt vijnë e shkojnë, është detyrë jona të punojmë e t'i shfrytëzojmë në favorin dhe dobinë tonë, se për ndryshe do të mbetemi të varfër në të gjitha aspektet.

## VLERA E KOHËS

“Pasha kohën! Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t'i përmbahen të vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshëm.” (El Asr, 1-3).

Një nga mirësitë më të mëdha me të cilën na ka nderuar Zoti xh.sh., pas fesë, është edhe koha. Vetë fakti që betimet e shumta në Kuran janë për kohën, na jep të kuptojmë për vlerën e saj. Një gjë duhet ta kuptojmë se nëse Zoti xh.sh., betohet në diçka, atëherë, ajo është shumë e shtrenjtë dhe vlefshme. Po i përmendim disa ajete ku Zoti betohet në kohë:s

“Betohem në kuqërrimin e horizontit pas perëndimit, dhe në natën e në çka ajo tubon, dhe në hënën kur ajo është e plotë.” (El Inshikak, 16-18); “Betohem në natën që me errësirë



*mbulon gjithësinë? Beto hem në ditën kur ajo shkrep tin.*” (El Lejl, 1-2); *“Beto hem në paraditen, beto hem në natën kur shtrinë errësirën.”* (Ed Duha, 1-2); *“Pasha agimin, pasha dhjetë netët!”* (El Fexhr, 1-2).

Të nderuar lexues, Zoti xh.sh., gjithë jetën tonë, e ka ndarë në vite. Këto vite, në muaj, ditë, orë dhe në frymëmarrje. Çdo frymëmarrje do të arkivohet. Arkiva e frymëmarrjeve tona, do të hapet Ditën e Kiametit, për të parë si janë shfrytëzuar. Vallë çfarë do gjejmë në këto frymëmarrje tona!? Ndoshta, një pjesë e madhe e tyre janë boshe, kohë e kaluar kot, apo, ... Hasan el Basriu ka thënë: “O i biri i Ademit, ti nuk je asgjë tjetër pos një grumbull i frymëmarrjeve. Kur të dalë frymëmarrja, me të del një pjesë e jotja. Ashtu si ka shkuar kjo pjesë, së shpejti të gjithë ju do të shkoni.”<sup>1</sup>

Fatkeqësisht sot, lirshëm mund të themi se për disa njerëz, koha është e parëndësishme dhe e pavlerë, prandaj e kalojnë kot. Një fjalë e urtë thotë: “Koha është flori.” Në fakt, koha është më e shtrenjtë dhe më e vlefshme se floriri. Floriri shkon e vjen, por koha nuk kthehet më. Koha është vetë jeta dhe duhet shfrytëzuar sa më mirë. Nëse dikujt i ka humbur një shumë parash, mund të shpresoj që t’i rikthejë, t’i gjejë, apo t’i fitojë sërish. Por, nëse dikush e humbë kohën kot, nuk ka

“Ndaj dy mirësive shumica e njerëzve janë të shkujdesur: ndaj shëndetit dhe kohës së e lirë.”

(Hadith)

mundësi ta kthejë atë përsëri. Nga rreshtat e mësipërm kuptojmë që myslimani duhet që ta shfrytëzojë kohën maksimalisht.

## MENAXHIMI I KOHËS NË ADHURIM

Allahu xh.sh. na e fali kohën që ta shfrytëzojmë për të mirën tonë dhe për të mirën e familjes e shoqërisë në përgjithësi. Na e fali kohën që të punojmë për këtë dhe për botën tjetër, e nëse e humbim kot, rrezikojmë ta humbim edhe këtë edhe botën tjetër, ndërkaq duhet të jemi shumë të sigurt se për çdo minutë do të mbajmë përgjegjësi se si e kemi kaluar dhe do të pyetemi nga Allahu xh.sh., se a e kemi shfrytëzuar si duhet.

A e kemi shfrytëzuar kohën për adhurim, në veçanti për t’u falur? Dëgjojmë shumë pleq, duke qarë që thonë: “Ah sikur të ishim falur prej rinisë!” Por koha tashmë ka kaluar. Është një fjalë e urtë: “I mençuri mëson nga dështimet e tjetrit”. Kjo vlen për të gjitha punët në sferat e jetës.

Jemi njerëz, qenie shoqërore, andaj edhe kemi detyra dhe obligime si ndaj vetes, familjes dhe shoqërisë, por mbi të gjitha ndaj Zotit të Madhërishëm. Mirëpo, kjo nuk do të thotë se ne gjithmonë jemi të zënë dhe me angazhime, ashtu që të mos na mbetet kohë më për asgjë. Mos ta harrojmë asnjëherë



hadithin e Muhamedit a.s., i cili ka thënë: “*Ndaj dy mirësive shumica e njerëzve janë të shkuajdesur: ndaj shëndetit dhe kohës së e lirë.*”<sup>2</sup>

Nëse të bashkohen këto dy mirësi, ajo e kohës së lirë dhe shëndetit, atëherë ke fituar një fitim madhështor, prandaj ruaji ato dyja dhe vëri në shërbim të kësaj dhe botës së përtejme. Programoje kohën tënde duke filluar që tani, kryeje çdo punë në kohën e saj me qëllim që ta menaxhosh kohën e lirë, kujdes nga sëmundja “do të”, sepse ajo e vret kohën. Mësoje veten tënde që t’i kryesh punët në kohën e vet, mos e vono asnjë punë për aq sa të hyjë në kohën e punës tjetër, pasi kjo do të thotë se e ke shkatërruar realizimin e objektivave dhe i ke shpërdorur rezultatet duke e çuar kështu dëm edhe moshën.

Nëse lirohemi nga një akt adhurimi fetar, atëherë fillo të merresh me një punë të dynjasë. Nëse lirohesh nga një punë personale, fillo të merresh me një punë të familjes tënde, kështu shfrytëzoje kohën e lirë duke kontrolluar shtëpinë tënde për gjërat që ka nevojë të rregullohen dhe mirëmbahen. Në këtë rast merr shembull nga i Dërguari i Allahut a.s., i cili rregullonte nallanet e tij, qepte –arnonte rrobat e tij, milte bagëtitë e tij dhe i është përgjigjur Zotit të Lartësuar. Shmange qëndrimin e gjatë në shtëpi, merru me ndonjë aktivitet sportiv gjatë ditës.<sup>3</sup> Muhamedi a.s., ka thënë: “*Shfrytëzo pesë*

*gjëra, para se të vijë pesë tjera: shfrytëzo rininë para pleqërisë, shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë, kohën e lirë para se të zihesh me diçka dhe jetën para vdekjes.*”<sup>4</sup>

Jeta e njeriut në këtë botë është e shkurtë, nuk do të jemi gjithmonë këtu dhe me vete nuk do të marrim asgjë nga kjo botë vetëm veprat e mira, andaj është urtësi të përfitojmë sa më shumë që kemi mundësi duke e shfrytëzuar kohën nga kjo jetë sa na ka dhënë i Madhi Zot. Ebu Hurejra, r.a., transmeton se Pejgamberi a.s., ka thënë: “*Mosha e ymetit tim qëndron ndërmjet 60 dhe 70 vjetëve, të paktë do ta kalojnë atë.*”<sup>5</sup>

Të nderuar lexues, po e marrim moshën e Pejgamberit a.s., i cili jetoi 63 vjet, si një moshë mesatare e ymetit të tij, për të parë se sa kohë humbim në përgjithësi. Ligji botëror thotë se njeriu duhet të punojë tetë orë në ditë. Mjekët sugjerojnë se nëse njeriu do ta ruajë shëndetin e tij, ai duhet të flejë tetë orë për çdo ditë. Dita përbëhet nga 24 orë. Dy të tretat e ditës, 16 orë na shkojnë në punë dhe gjumë. Pjesa tjetër për angazhime të tjera me familje, me të afërm dhe me obligimet tona shoqërore. Myslimani, i cili e ka obligim me i falë pesë kohë namaz, i nevojiten 40 minuta deri 1 orë nga 24 orët e ditës. A s’është turp nga Zoti xh.sh., i cili t’i dhuron 23 orë e 20 minuta, që ti t’i shfrytëzosh si të duash vet dhe t’ua kushtosh të tjerëve,

me vend a pa vend, e për Zotin s’ke kohë, 4 min. në sabah, (namazi i sabahut 4 rekate), 10 min. në drekë, 8 min. në ikindi, 5 min. në aksham dhe 13 minuta. në namaz të jacisë, gjithsej 40 min. (5 kohët e namazit gjithsej 40 rekate farz e synet).

Nga kjo që u tha, e kemi bërë një analizë të një jete, tani bëje analizën e jetës tënde dhe do të shohësh veten ku je. Pyete veten se sa kohë kalojmë në të tjera aktivitete dhe sa kohë-orë kalojmë duke adhuruar e madhëruar Allahun xh.sh.!?

#### **POROSITË E ARTIKULLIT**

- Të jemi të kujdesshëm ndaj kohës,
- Mos e lësho me vetëdije këtë margaritarë, sepse ky gur i çmuar (koha) ka çmim të lartë,
- Koha është jeta e jonë.

O Zot na mundëso ta shfrytëzojmë kohën në punë të hairit dhe në adhurimin Tënd! Amin!

1 Amër Halid, “*Organizimi i jetës*”, Sira, Prishtinë, 2007, f. 232.

2 Sahihu i Buhariut. v.5, Harfi, Prishtinë, 2024, 6412.

3 Aid el Karni, “*Zgjidhje, çelësat e artë për çdo problem dhe kauzë*”, Shkup, 2019, f. 254.

4 Hakimi, 7846.

5 Sunen et Tirmidhij, *Mektebetu el Mearife lineshri ve et Tevzi*, Botimi i tretë, Riad, 2008, 3550.

“Shfrytëzo pesë gjëra, para se të vijë pesë tjera: shfrytëzo rininë para pleqërisë, shëndetin para sëmundjes, pasurinë para varfërisë, kohën e lirë para se të zihesh me diçka dhe jetën para vdekjes.”

(Hadith)

# Ikonalizimi dhe nevoja për një lëvizje ikonoklaste

## ÇFARË JANË IKONIALISTËT DHE IKONOKLASTËT...?

Fjala ikonë do të thotë imazh, por, që të besimi i krishterë, ato ishin piktura në të cilat ishin pikturuar portretet e njerëzve të shenjtë dhe ngjarjeve që kishin të bënin me këto portrete dhe piktura. Ato asnjëherë nuk kishin qenë synim në vetveten e tyre. Pra, nuk është se ishin përdorur thjesht për zbulim. Ato përdorshin për të përcuar mesazhin dhe bindjen përtej pikturës, të asaj apo të atij portreti që ishte i pikturuar në atë pikturë. Prandaj, ato ishin një gjuhë e përbashkët, pa dallim moshe, gjinie apo pozite, përmes së cilave shpreheshin bindjet fetare.

E ndërsa, ikonoklasma është e kundërta e të parës. Pra, është një besim apo bindje shoqërore, që si qëllim primar kishte thyerjen dhe shkatërrimin e ikonave, që sipas tyre, ishin të gabuara apo të dëmshme. Njerëzit që përfshiheshin ose mbështesnin ikonoklasmen, quheshin ikonoklastë. Pra, ky ishte një term që kishte filluar të përdoret në mënyrë figurative për çdo individ që sfidonte këto ikona dhe atë që fshihej prapa tyre. E tërë kjo mund të ndodhte për shkak apo arsye fetare por, edhe politike.

**Termi ikonoklastë, e ka origjinën nga ikonoklasia bizantine, betejet midis përkrahësve dhe kundërshtarëve të ikonave fetare në Perandorinë Bizantine nga viti 726 deri në 842.**

Termi e ka origjinën nga ikonoklasia bizantine, betejet midis përkrahësve dhe kundërshtarëve të ikonave fetare në Perandorinë Bizantine nga viti 726 deri në 842. Shkallët e ikonoklasizmit ndryshojnë shumë midis feve dhe degëve të tyre, por janë më të forta në fetë që kundërshtojnë idhujtarinë, duke përfshirë fetë monoteiste. Jashtë kontekstit fetar, ikonoklasma mund t'i referohet lëvizjeve për shkatërrim të gjerë në simbolet e një ideologjie ose kauze, siç është shkatërrimi i simboleve monarkiste gjatë Revolucionit Francez.

**A JANË RINGJALLUR IKONIALISTËT NË MESIN E MYSLIMANËVE DHE A KEMI NEVOJË PËR NJË LËVIZJE IKONOKLASTE...?**

Muslimanët janë njerëz siç janë edhe të gjithë të tjerët. Pra, edhe muslimanët mund të bien në grackën dhe në gabimet e besimeve të tjera. Kështu, edhe muslimanët mund të bëjnë edhe gabime fetare, siç kishin bërë popujt e besimeve të mëhershme. E padyshim se, këtë mund ta kuptojmë edhe nga vetë Kurani, ku, Allahu xh.sh., në disa



ajete kuranore, ua tërheq vërejtjen myslimanëve që të jenë vigjilentë, të jenë largpamës, dhe të kujdesshëm. Pra, të mos bien pre e grackave dhe kurtheve të devijimeve që kishin ndodhur te popujt e mëhershëm. E me theks të veçantë, tek idhujtarët e librave të shenjta. Por, nuk është vetëm Kurani që tërheq vërejtjen për një gjë të tillë. Këtë mund ta gjejmë edhe në shumë transmetime të Pejgamberit a.s..

Prandaj, edhe sot, në mesin e myslimanëve gjejmë të tillë që mundohen të lartësojnë dhe të ngritin përtej njerëzores njerëz të ndryshëm. Gjejmë besimtarë të cilët mundohen të lartësojnë një dijetar apo një hoxhë të caktuar. Ngritje dhe lartësim kjo që tejkalon suazat e legjitimites dhe të lejuarës. Ata e bëjnë këtë me apo pa vetëdije, me apo pa qëllim, në mënyrë direkte apo indirekte, drejtpërdrejt apo tërthorazi. Më e keqja është se, në raste të caktuara, gjejmë edhe prijës fetarë të cilët heshtin para këtyre dukurive që, në mënyrë direkte apo indirekte, shfaqen dhe demonstrohen para tyre nga ndjekësit dhe pasuesit e tyre. E që, sipas parimeve islame, heshtja në rast të nevojës për sqarim është miratim dhe aprovim i saj. Por, po ashtu, edhe heshtja para një të keqe është bashkëpjesëmarrje në të. Kështu, këta prijës fetarë duhet të kenë kujdes dhe të mos lejojnë që në prezencën e tyre të lartësohet figura e tyre, apo edhe të denigrohet figura e kujtdo tjetër.

**Islami, si fe e vetme e pranuar tek Allahu, është besimi i vetëm që ka ndaluar rreptësishtë besimin në ikona, idhuj dhe në shenjtërimin e kujtdo qoftë.**

Sot, nuk janë edhe të rralla etiketimet e shumta, me qëllim lavdërimi, që u bëhen figurave të ndryshme fetare. Disa, kanë shkuar aq larg saqë edhe i dëgjon duke thënë se: “Nëse dëshiron të shohësh një njeri prej banorëve të Xhenetit, shiko filan hoxhën ose filan dijetarin.” Apo edhe të atillë që po të thanë se: ka thënë filan hoxha apo filan dijetari, nuk të mbetet që tjetër përveçse të heshtësh. Kjo pasi që po provove të sqarosh, të shprehesh mospajtim apo mospranim të asaj që të kanë transmetuar atëherë ti do të jesh një i lajthitur dhe i devijuar.

Më e keqja është në rast se tentohet të kritikohet, të kundërshtohet, apo edhe vetëm të shfaqet një mospajtim ndaj tij, atëherë do të pasojë atakimi dhe ndëshkimi me gjykimin dhe etiketimin e devijimit, lajthitjes, renegancës dhe deri te përcaktimi i vendit në Xhehenem.

### **POR, A THUA KEMI NEVOJË PËR NJË LËVIZJE IKONOKLASTE...?**

Islami, si fe e vetme e pranuar tek Allahu, është besimi i vetëm që ka ndaluar rreptësishtë besimin në ikona, idhuj dhe në shenjtërimin e kujtdo qoftë. Pra, është fe që ka ndaluar rreptësishtë besimin dhe adhurimin e çdokujt dhe të çdo gjëje përveç Allahut xh.sh., si Një dhe të Vetëm. Po ashtu, ka ndaluar edhe marrjen e kujtdo dhe të

çfarëdo gjëje tjetër si ndërmjetës në raportin në mes robit dhe Allahut xh.sh..

Shenjat e para apo zanafilla e parë ikonoklaste, në Islam, llogaritet thyerja e putave dhe idhujve që ishin bërë gjatë çlirimit të Mekës. Kjo kishte ndodhur me urdhrin e vetë të Dërguarit të Allahut xh.sh.. Pra, Islami e ndalon rreptësishtë ikonializim. E që do të thotë se në Islam nuk ka shenjtërim të individëve, por ka shenjtërim të parimeve dhe rregullave islame. Besimtarët, sado që mund të jenë të devotshëm, ata assesi nuk arrijnë që të dalin jashtë të qenit njerëz. Prandaj, si të tillë, medoemos do të jenë të përfshirë brenda transmetimit të Pejgamberit a.s. që thotë se: “Çdo bir i Ademit është gabimtar. Dhe, më i miri prej gabimtarëve është ai që pendohet.”<sup>1</sup>. Po ashtu, kemi transmetimin tjetër ku i Dërguari i Allahut xh.sh. thotë: “Pasha Atë, në dorën e të Cilit është shpirti im, sikur ju të mos bënit gabime, Allahu do t’ju largonte dhe do të sjellte të tjerë që gabojnë dhe Allahu ua fal gabimet.”<sup>2</sup>

Prandaj, çdo njëri prej nesh, qoftë prijës fetarë apo besimtar i thjeshtë, duhet që ta kuptoj se nuk ka njeri pa gabime. Por, ka qenë fati i tyre, rrethanat në të cilat ata kanë jetuar apo edhe vetë koha e tyre ku ata kanë pas mundësinë që të jenë prej pishtarëve dhe prej themeleve të Islamit dhe të thirrjes në një vend apo kohë të caktuar, e që padyshim se për një gjë të tillë do të kenë shpërblimin e tyre dhe të atyre që ndjekin rrugën e trasuar prej tyre. Por, ky fakt assesi nuk i zhvesh ata nga gabimet dhe nga e drejta për t’u kritikuar. Kjo nuk i bënë ata të pa prekshëm dhe të pa cenueshëm. Kjo pasi që, të gjithë ne e dimë se, në Islam vlen vetëm parimi i meritokracisë dhe se shpërblimi nuk është me jetëgjatësi. Kështu, shohim se si Sad ibën Muadhi, me vetëm gjashtë vjet jetë në Islam, kishte arritur që me vdekjen e tij të dridhej edhe vetë Arshi i Allahut xh.sh..

Dhe për fund, duhet që të kemi të qartë se në Islam, veprat gjykoohen sipas qëllimit. Pra, sipas asaj që njeriu synon të arrijë përmes të vepruarit të tij, e që kjo është një çështje e fshehtë që i takon vetëm zemrës dhe mendjes tonë. Pra, askush prej nesh nuk ka mundësi që të kuptojë qëllimin dhe synimin e askujt. E përderisa nuk kemi mundësi që të kuptojmë një gjë të tillë, atëherë assesi nuk na takon gjykimi i askujt. E drejta e gjykimit është një e drejtë eksplicite dhe supreme që i takon vetëm Allahut xh.sh.. Kjo, ngase vetëm Allahu xh.sh. sheh dhe di të fshehtat e zemrave dhe të



**Le të mos harrojmë se mendimin ndryshe, Islami e ka trajtuar si mëshirë dhe assesi nuk e ka trajtuar si armiqësi.**

mendjes tonë. Prandaj, Allahu xh.sh. assesi nuk shikon në format dhe në dukjet tona, por në zemrat dhe në mendjet tona.

Përderisa nuk kemi të drejtë të kuptojmë qëllimin e askujt, atëherë duhet që të kuptojmë se misioni ynë është mision i thirrjes dhe assesi i gjykimit. Pra, ne jemi thirrës dhe nuk jemi gjykues. E tërë ajo që mund të bëjmë, në raste të caktuara, është të gjykojmë ndonjë vepër sipas asaj që kemi parë. Por, assesi nuk na takon e drejta e gjykimit të vepruesit dhe kryerësit të asaj vepre. Kjo, ngase ajo vepër mund të jetë kryer për shkak të rrethanave dhe të kushteve të caktuara që ne nuk mund t'i dimë. Edhe pse mund të jetë vepër e shëmtuar, në shikim të parë, ajo për shkak të rrethanave, mund të jetë e arsyetuar tek Allahu xh.sh..

Kështu pra, secili prijës fetarë, por edhe besimtar i thjeshtë e ka për obligim që të rikthehet në vetveten e tij. Të korrigoj vetveten e tij në raport me të tjerët. Të mësoj dhe të jetë më zemërgjerë dhe më mendjehapur karshi mendimit ndryshe. Le të mos harrojmë se mendimin ndryshe, Islami e ka trajtuar si mëshirë dhe assesi nuk e ka trajtuar si armiqësi.

1 Ky transmetim vjen nga Enes ibën Maliku, të cilin e transmeton Imam Tirmidhiu, transmetimi numër 2499.

2 Ky transmetim vjen nga Ebu Hurejre, të cilin e transmeton Imam Muslimi, transmetimi numër 2749.

# Trashëgimia e domosdoshme në të drejtën trashëgimore të Kosovës

## ASPEKTE KRAHASUESE ME TË DREJTËN ISLAME

Çdo trashëgimtari ligjor domosdo i takon pjesa trashëgimore e domosdoshme në kushtet e parapara me dispozita imperative ligjore, madje edhe kundër vullnetit të vetë trashëgimlënësit.<sup>1</sup> Trashëgimia e domosdoshme është e drejtë trashëgimore që ligji ua njuh trashëgimtarëve ligjorë. Ai vendos një kufi ndërmjet të drejtës së disponimit të të drejtave pasurore me anë të testamentit dhe akteve të tjera të kalimit të pasurisë pa shpërblim në trashëgimtarë dhe pjesës së domosdoshme të trashëgimisë që është e padisponueshme. Titullari i së drejtës së pasurisë gëzon të drejtën e disponimit të lirë të pasurisë së vet për të gjallë (inter vivos), por jo edhe në rast vdekjeje (mortis causa). Në pjesën më të madhe të doktrinës juridike bashkëkohore trashëgimore mbretëron parimi absolut që liria testamentare nuk është e pakufizuar.

Ndërsa, në terminologjinë e së drejtës së Sheriatit, e drejta trashëgimore njihet me emrin *Ilmul Mirath*, që në shqip do të thotë shkenca e trashëgimisë. Kjo shkencë definohet si shkenca, e cila merret me studimin e dispozitave juridike për bartjen e pasurisë pas vdekjes së trashëgimlënësit (*de*

Trashëgimlënësi jo që nuk mund të disponoj me pjesën e domosdoshme, por nuk mund t'i ndryshoj as radhët e trashëgimisë të caktuara me dispozita ligjore, as lartësinë e vlerës së pjesës së domosdoshme.

*cujus-it*) dhe gjendjen e trashëgimtarëve (*suksesorëve*).<sup>2</sup> Instituti i trashëgimisë ka edhe këto emërtime: *Ilmul Feraid*, *Fikhul Mevarith* dhe *Ilmu et Terikat*. Të gjitha këto shprehje përgjithësisht aludojnë institutin e trashëgimisë, i cili merret drejtpërsëdrejti me shpërndarjen e pasurisë, pra, me kalimin e pasurisë së të vdekurit te pasardhësit si dhe njohjen e sasisë të trashëgimtarëve nga pasuria e trashëgimlënësit.

Trashëgimlënësi jo që nuk mund të disponoj me pjesën e domosdoshme, por nuk mund t'i ndryshoj as radhët e trashëgimisë të caktuara me dispozita ligjore, as lartësinë e vlerës së pjesës së domosdoshme. Përkundrazi, ai nuk është as i lirë për të qenë bujar përtej disa kufijve, që janë të përcaktuar nga trashëgimia e domosdoshme për të afërmit. Individidi nuk mund të vendos sipas dëshirës së tij as në rastin kur ai niset nga qëllime humanitare ose shoqërore. Kjo e drejtë trashëgimie lind nga fakti i ekzistencës në vetvete të një marrëdhënie të ngushtë gjinie me të vdekurin *de cuius*.<sup>3</sup> Prandaj, mund të konkludohet se pjesa e pasurisë trashëgimore, në të cilën personat e caktuar kanë të drejtë në trashëgimi, pra atë të drejtë që trashëgimlënësi



në parim nuk mund ta ndryshoj me deklarinimin e vullnetit të fundit, quhet pjesë e domosdoshme.<sup>4</sup>

### TRASHËGIMTARËT E DOMOSDOSHËM

Sipas LTK-së, trashëgimtarë të domosdoshëm janë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij, gjyshërit e trashëgimlënësit, ndërsa motrat dhe vëllezërit e trashëgimlënësit janë trashëgimtarë të domosdoshëm vetëm në qoftë se janë plotësisht të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete për jetesë. Personat e cekur më lartë janë trashëgimtarë të domosdoshëm kur sipas radhës ligjore të trashëgimit janë thirrur për trashëgim.<sup>5</sup> Trashëgimtarë të domosdoshëm, siç del nga përmbajtja e dispozitave ligjore të përmendura, mund të jenë vetëm trashëgimtarët ligjorë. Është tendencë në legjislacionet bashkëkohore që rrethi i trashëgimtarëve të domosdoshëm të ngushtohet. Trashëgimtarët e domosdoshëm, bazuar në kushtet që me dispozitën e nenit 30 paragrafi 2 të LTK-së kërkohen të plotësohen për fitimin e cilësisë së trashëgimitarit të domosdoshëm, mund të ndahen në dy grupe: Në grupin e parë do të bëjnë pjesë trashëgimtarët ligjorë, që me forcën e ligjit fitojnë cilësinë e trashëgimitarit të domosdoshëm pa plotësuar kurrfarë kushti, nëse sipas ligjit

Trashëgimtarët e domosdoshëm sipas dispozitës së nenit 30 paragrafi 1 të LTK-së, janë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij.

mund të trashëgojnë dhe deklarojnë vullnetin për të trashëguar në rastin konkret. Ata sipas dispozitës së nenit 30 paragrafi 1 të LTK-së, janë: pasardhësit e trashëgimlënësit, të adoptuarit e tij dhe pasardhësit e tyre, prindërit dhe bashkëshorti i tij. Sipas kësaj, personat e lartpërmendur nuk kërkohet të plotësojnë kurrfarë kushti të veçantë për të qenë trashëgimtarë të domosdoshëm, përveç plotësimin të kushtit të përgjithshëm ligjor që ata të jenë trashëgimtarë ligjorë. Në grupin e dytë natyrshëm hyjnë trashëgimtarët e domosdoshëm nga të cilët, pos plotësimin të kushtit të përgjithshëm për të qenë trashëgimtarë ligjorë, ligji kërkon plotësimin edhe të kushtit plotësues të paraparë me dispozitën e nenit 30 paragrafi 2 të LTK-së: të jenë plotësisht të paaftë për punë dhe nuk kanë mjete për jetesë. Ky grup që përbëhet nga gjyshërit e trashëgimlënësit, motrat dhe vëllezërit e trashëgimlënësit, në realitet është dukshëm më i ngushtë se i pari. Është çështje faktike nëse një trashëgimtar është plotësisht i paaftë për punë dhe nuk ka mjete për jetesë.<sup>6</sup>

Sa i përket të drejtës së Sheriatit, Allahu i Madhëruar përcaktoi ndarjen e trashëgimisë ndërmjet trashëgimtarëve, që janë meritore, dhe këtë nuk ia ka dorëzuar asnjë melaqeje e as ndonjë të dërguari, por e ka sqaruar Vetë në formën më të qartë dhe i ka shpjeguar dispozitat e saj në mënyrën më të përsosur të mundshme. Ka zbritur ajete për këtë çështje



që do të lexohen deri në Ditën e Kiametit. Allahu xh.sh. thotë: *“Meshkujve u takon pjesë nga ajo që u kanë lënë prindërit dhe të afërmit, por, edhe femrave u takon pjesë nga ajo që u kanë lënë prindërit dhe të afërmit, qoftë ajo pak apo shumë, si pjesë e caktuar dhe e detyruar”*.<sup>7</sup> Këtë e ka sqaruar me fjalët e Tij: *“Allahu ju urdhëron kështu në lidhje me trashëgiminë tuaj: mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave...”*.<sup>8</sup>

## LLOGARITJA E PJESËS SË DOMOSDOSHME

LTK-ja, pjesën e domosdoshme e ka rregulluar me dispozita ligjore. Po ashtu, rregullimi juridik i pjesës së domosdoshme mund të bëhet në mënyrën e ashtuquajtur individuale apo grupe. LTK-ja ka përcaktuar se pjesa e domosdoshme e pasardhësve dhe bashkëshortit përbën një të dytën, ndërsa pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të tjerë një të tretën e pjesës që do t'i takonte secilit si trashëgimtar ligjor në pajtim me dispozitat mbi radhët e trashëgimit.<sup>9</sup> Nga kjo del se legjislacioni ynë përkrah sistemin e rregullimit individual të pjesës së domosdoshme trashëgimore. Këtë e ilustron fakti se pjesa e domosdoshme e pasardhësve dhe e bashkëshortit përbën një të dytën, ndërsa pjesa e domosdoshme e trashëgimtarëve të tjerë një të tretën e pjesës që do t'i takonte secilit si trashëgimtar ligjor në pajtim me dispozitat mbi radhët e trashëgimisë, ngase pjesa e domosdoshme që i takon bashkëshortit dhe pasardhësve është më e madhe dhe dallon nga pjesa e domosdoshme që u takon trashëgimtarëve të tjerë të domosdoshëm, e cila, në të vërtetë, është shumë më e vogël.<sup>10</sup>

Për shkaqe thjesht të sigurisë juridike dhe të efikasitetit të institucionit të pjesës së domosdoshme, përkatësisht për të mënjeluar çfarëdo manipulimi me këtë pjesë, me dispozitat e nenit 32 të LTK-së janë paraparë bazat për llogaritjen e vlerës së pasurisë trashëgimore në bazë të së cilës llogaritet edhe pjesa e domosdoshme. Kështu sipas LTK-së, së pari, inventarizohen dhe vlerësohen të gjitha të mirat që ka pasur trashëgimlënësi në çastin e vdekjes, duke llogaritur këtu të gjitha ato që ka disponuar me testament, si dhe të gjitha borxhet që ia kanë të tjerët, edhe ato që ia ka ndonjë trashëgimtar, me përjashtim të borxheve që qartazi që nuk mund të arkëtohen,<sup>11</sup> si dhe nga vlera e përcaktuar e të mirave që ka pasur trashëgimlënësi në çastin e vdekjes zbritet shuma e borxheve të tij,

shuma e shpenzimeve të inventarizimit e të vlerësimit të pasurisë trashëgimore dhe e shpenzimeve të varrosjes së trashëgimlënësit.<sup>12</sup> **Më pas**, sipas LTK-së, pjesës që mbetet i shtohet vlera e të gjitha dhurimeve që trashëgimlënësi ka bërë në çfarëdolloj mënyre ndaj ndonjë trashëgimtar ligjor, madje edhe e dhurimeve që u ka bërë trashëgimtarëve që heqin dorë nga trashëgimi, si dhe e atyre dhurimeve për të cilat trashëgimlënësi ka urdhëruar që të mos i llogariten trashëgimtarit në pjesën e tij trashëgimore.<sup>13</sup> Dhe, së fundi, LTK-ja, ka përcaktuar se kësaj shume i shtohet edhe vlera e dhurimeve që trashëgimtarit në vitin e fundit të jetës së tij u ka bërë personave të tjerë që nuk janë trashëgimtarë ligjorë, me përjashtim të dhurimeve të rëndomta.<sup>14</sup>

Ndërsa sa i përket të drejtës së Sheriatit, ajo ka përcaktuar se me këtë trashëgimi ndërlihen këto të drejta sipas kësaj renditje: Përgatitja e kufomës – kjo nënkupton tërë atë që nevojitet për të vdekurin, duke filluar me shpenzimet për qefinosje, pastrim, varrosje, e të ngjashme me këto.<sup>15</sup> Larja e borxheve, të cilat janë objekt i kërkesave nga njerëzit – Pasi që të jenë bërë të gjitha përgatitjet e duhura rreth përgatitjes së kufomës, atëherë menjëherë duhet të paguhet borxhet të cilat kërkohen nga njerëzit.<sup>16</sup> Ekzekutimi i testamentit – Realizimi i testamentit me dhënien e 1/3 së pasurisë e cila ka mbetur pas përgatitjes së të vdekurit dhe larjes së borxheve, në bazë të fjalëve të Allahut xh.sh.: *“Allahu ju urdhëron kështu në lidhje me trashëgiminë tuaj: mashkullit i takon aq sa pjesa e dy femrave; e nëse janë më shumë se dy femra, atyre ju takon dy e treta e pasurisë që e ka lënë; e nëse është vetëm një, asaj i takon gjysma. Për prindërit, për secilin posaçërisht i takon e gjashta nga ajo që ka lënë, nëse ka fëmijë; por nëse nuk ka fëmijë, dhe e trashëgojnë vetëm prindërit, atëherë nënës së tij i takon e treta. Nëse ai ka vëllezër, atëherë nënës i takon një e gjashta, pasi të kryhet testamenti që e ka lënë dhe të lahet borxhi...”*<sup>17</sup>

Ndarja e trashëgimisë së mbetur atyre që kanë të drejtë në trashëgimi, në bazë të çfarëdo baze – Sistemi i trashëgimisë në të drejtën e Sheriatit tregon fare qartë synimin e Sheriatit që trashëgimia t'i ndahet një numri sa më të madh të farefisit të të vdekurit, ashtu që të mos jetë monopol vetëm i një numri të vogël njerëzish.

Së pari,  
inventarizohen  
dhe vlerësohen  
të gjitha të  
mirat që ka  
pasur trash-  
ëgimlënësi në  
çastin e  
vdekjes, duke  
llogaritur këtu  
të gjitha ato që  
ka disponuar  
me testament,  
si dhe të gjitha  
borxhet që ia  
kanë të tjerët,  
edhe ato që ia  
ka ndonjë  
trashëgimtar,  
me përjashtim  
të borxheve që  
qartazi që nuk  
mund të  
arkëtohen.



## PËRJASHTIMI NGA TRASHËGIMIA E TRASHËGIMTARIT TË DOMOSDOSHËM

Me përjashtimin nga trashëgimia duhet të kuptojmë heqjen e cilësisë së trashëgimtarit ligjor nga ana e trashëgimlënësit me deklarimin e vullnetit të fundit ashtu që ai nuk fiton asgjë nga pasuria e tij trashëgimore.<sup>18</sup> LTK-ja, ka paraparë këto kushte për përjashtimin e trashëgimtarit nga trashëgimia e domosdoshme: a) Në qoftë se ai me shkeljen e ndonjë detyrimi ligjor ose moral ka bërë cenim të rëndë ndaj trashëgimlënësit; b) Në qoftë se ka bërë me dashje ndonjë vepër të rëndë penale ndaj trashëgimlënësit, bashkëshortit, fëmijës ose prindit të tij; c) Në qoftë se është plëngprishës, nuk do të punojë ose është dhënë pas jetës së pandershme.<sup>19</sup>

Për t'u përjashtuar trashëgimtari i domosdoshëm nga trashëgimia e domosdoshme duhet të ekzistojë patjetër aktgjykimi ndëshkues i gjykatës i marrë në procedurë penale apo procedurë civile. Përpara kësaj të fundit, ekzistimi i kësaj veprë penale parashtrohet si çështje prejuridiciale.<sup>20</sup> Kur nuk është e mundur të zbatohet procedura penale, për shkak se ka vdekur ndërkohë vrasësi, ose është privuar nga jeta, etj., atëherë këtë rrethanë, duke qenë se procedura trashëgimore është urgjente, e vërteton gjykata trashëgimore, përkatësisht ajo civile. Zaten, aktgjykimi i gjykatës penale që mund të merret më vonë në procedurë penale e me të cilin në mënyrë meritore vërtetohet rrethana se kush e ka kryer veprën penale dhe a e ka kryer me dashje, mund të shërbejë si bazë për ndryshimin e vendimit për trashëgimi në kontest të veçantë civil (*hereditatis petition*).<sup>21</sup> Sipas LTK-së, trashëgimlënësi që

dëshiron të përjashtojë ndonjë trashëgimtar duhet ta shprehë këtë në mënyrë të qartë si dhe të tregojë shkakun e këtij përjashtimi.<sup>22</sup> Për të qenë i vlefshëm përjashtimi i trashëgimtarit të domosdoshëm nga trashëgimia shkakun e përjashtimit duhet të ketë ekzistuar në kohën e përpilimit të testamentit. Në rast kontesti rreth bazueshmërisë së përjashtimit, detyrën për të provuar se përjashtimi është i arsyeshëm e ka ai që mbështetet në përjashtim.<sup>23</sup>

Do theksuar se përjashtimi mund të jetë i plotë dhe i pjesshëm. Përjashtimi i plotë është kur trashëgimtari përjashtohet nga e drejta për trashëgimi në mënyrë të plotë dhe, si pasojë, ai nuk mund të trashëgojë asgjë nga pasuria trashëgimore. Ndërkaq, përjashtimi është i pjesshëm nëse ai ka humbur pjesërisht të drejtën në trashëgimi, pra nuk i ka humbur të gjitha të drejtat. Ky përjashtim, qoftë i plotë apo i pjesshëm duhet të bëhet në favor të pasardhësve të trashëgimlënësit, me ç'rast duhet të vlejnjë rregullat e së drejtës së përfaqësimit të parapara me dispozitat e nenit 13 të LTK-së.<sup>24</sup> Me përjashtimin trashëgimtari humb të drejtat trashëgimore në vëllimin në të cilin është përjashtuar, kurse të drejtat e personave të tjerë që mund të trashëgojnë trashëgimlënësin caktohen sikur i përjashtuari të kishte vdekur para trashëgimlënësit.<sup>25</sup> E drejta e Sheriatit ka përcaktuar se shkaqet e përjashtimit janë: robëria, vrasja, largimi nga feja, ndryshimi fetar dhe ndryshimi vendor.

- 1 Lidhur me trashëgiminë e domosdoshme sidomos Podvorica, "E drejta trashëgimore", Prishtinë, 2010, fq. 63 e në vazhdim.
- 2 Zimeri, "E drejta trashëgimisë në shariat Islam", Shkup, 2013, fq. 1.
- 3 Shih Galgano, "E drejta private", Tiranë, 1999, fq. 872.
- 4 Podvorica, op. cit., fq. 64.
- 5 Ligji Nr. 2004/26, për Trashëgiminë i Kosovës, dispozita e nenit 30 të LTK-së.
- 6 Për më tepër rreth trashëgimtarëve të domosdoshëm shih sidomos Podvorica, op. cit., fq. 65 e në vazhdim.
- 7 Në lidhje me dispozitat e shariatit për të drejtën trashëgimore shih sidomos suren En Nisa, nga ajeti 7 e tutje.
- 8 En Nisa, 11.
- 9 Neni 31 paragraf. 2 i LTK-së.
- 10 Podvorica, op. cit., fq. 68.
- 11 Dispozita e nenit 32 paragraf. 2 të LTK-së.
- 12 Neni 32 paragraf. 3 i LTK-së.
- 13 Shih nenin 32 paragraf. 4 të LTK-së.
- 14 Neni 32 paragraf. 5 i LTK-së.
- 15 Ejupi, "E drejta trashëgimore Islame", Prishtinë, 2011, fq. 27.
- 16 Në mes të tjerëve Zimeri, "E drejta trashëgimisë në shariat Islam", Shkup, 2013, fq. 12.
- 17 Sure En Nisa, 11.
- 18 Më konkretisht shih Podvorica, op. cit., fq. 69.
- 19 Dispozita e nenit 114 të LTK-së.
- 20 Podvorica, op. cit., fq. 70.
- 21 Ibid.
- 22 Neni 116 paragraf. 1 i LTK-së.
- 23 Dispozita e nenit 116 paragraf. 3 të LTK-së.
- 24 Sidomos Podvorica, op. cit., fq. 71.
- 25 Shih nenin 117 të LTK-së.

# Trajtesa e hebrenjve në Kartën e Medinës

**K**arta e Medinës është një shembull historik i një marrëveshjeje pluraliste, që synonte të krijonte një bashkësi të harmonizuar dhe të bashkëpunueshme ndërmjet grupeve të ndryshme fetare dhe etnike. Kjo marrëveshje tregon përpjekjet për ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe të barabartë, ku të gjithë individët gëzojnë të drejta dhe detyrime të barabarta.

Tani do të mundohemi t'i shpjegojmë të gjitha këto pika.

## STATUSI I HEBRENJVE NË KARTËN E MEDINËS

Karta e Medinës kishte disa klauzola specifike, që trajtonin statusin dhe të drejtat e hebrenjve në Medinë. Këtu janë disa pika kryesore që përshkruajnë statusin e hebrenjve sipas Kartës së Medinës:

**Pjesë e komunitetit të përbashkët** – hebrenjtë u njohën si pjesë e “ummah” (komunitetit) të Medinës, së bashku me myslimanët dhe grupet e tjera. Ata kishin një status të barabartë në aspektin e qytetarisë dhe bashkëpunimit brenda qytetit.

**Autonomi fetare dhe kulturore** – hebrenjtë kishin të drejtën ta praktikonin fenë e tyre dhe të ruanin traditat e tyre fetare dhe kulturore pa ndërhyrje. Ata nuk ishin të detyruar të konvertoheshin në Islam dhe kishin lirinë të

Të gjitha palët u angazhuan të mos tradhtojnë njëri-tjetrin dhe të mos bashkëpunojnë me armiqtë e përbashkët. Ky ndalim i tradhtisë ishte një element kyç për ruajtjen e besimit dhe bashkëpunimit brenda komunitetit.



ndiqnin ligjet dhe zakonet e tyre brenda komunitetit të tyre.

**Mbrojtje e përbashkët** – Karta përcaktonte se të gjitha grupet, përfshirë hebrenjtë, do të mbronin njëri-tjetrin nga çdo kërcënim i jashtëm. Ishte një marrëveshje për mbrojtje të përbashkët dhe ndihmë ushtarake në rast nevoje.

**Drejtësi dhe zgjidhje e konflikteve** – konfliktet dhe mosmarrëveshjet ndërmjet hebrenjve dhe myslimanëve, ose ndërmjet grupeve të ndryshme brenda Medinës, do të zgjidheshin sipas ligjit dhe drejtësisë. Hebrenjtë kishin të drejtën të zgjidhnin konfliktet e tyre sipas ligjeve të tyre fetare.<sup>1</sup>

**Ndalimi i tradhtisë** – të gjitha palët u angazhuan të mos tradhtojnë njëri-tjetrin dhe të mos bashkëpunojnë me armiqtë e përbashkët. Ky ndalim i tradhtisë ishte një element kyç për ruajtjen e besimit dhe bashkëpunimit brenda komunitetit.

**Kontributi në mbrojtje dhe financa** – hebrejtë dhe myslimanët kishin detyrimin të kontribuonin në mbrojtjen dhe mirëqenien e përgjithshme të Medinës, përfshirë edhe financat për mbrojtje të përbashkët. Karta e Medinës përfaqëson një përpjekje solide për të krijuar një shoqëri pluraliste siç ishte në realitet, ku grupe të ndryshme fetare dhe etnike mund të bashkëjetojnë në paqe dhe harmoni me njëri-tjetrin. Ky dokument tregon se Profeti Muhamed a.s. kishte një qasje përafruese dhe tolerante ndaj hebrejve dhe grupeve të tjera jomuslimane në Medinë.<sup>2</sup>

### AUTONOMIA E BRENDSHME E HEBREJVE NË KARTËN E MEDINËS

Këtu janë detajet kryesore të autonomisë së brendshme të hebrejve sipas Kartës së Medinës:

**Autonomia fetare dhe gjyqësore** – hebrejtë kishin të drejtën të praktikonin fenë e tyre dhe të ndiqnin rregullat dhe zakonet e tyre fetare pa ndërhyrje nga myslimanët. Ata kishin lirinë të zbatonin ligjet dhe normat e tyre brenda komunitetit të tyre. Konfliktet brenda komunitetit hebrej, që nuk përfshinin myslimanët, do të zgjidheshin sipas ligjeve hebreje. Kjo përfshinte çështje civile dhe penale brenda komunitetit hebrej.

**Ruajtja e institucioneve fetare** – hebrejtë ishin të lirë të mbanin dhe të drejtonin sinagogat e tyre dhe institucionet e tjera fetare. Ata kishin të drejtën të zhvillonin praktikat e tyre fetare dhe ceremonitë pa ndërhyrje.

**Menaxhimi i brendshëm i çështjeve** – hebrejtë kishin autonomi të plotë në menaxhimin e çështjeve të tyre të brendshme, përfshirë çështjet e familjes, trashëgimisë dhe martesës, sipas ligjeve dhe traditave të tyre. Kjo autonomi zgjatej në administrimin e pasurive dhe pronave të komunitetit hebrej, duke përfshirë



Karta e Medinës përcaktonte se të gjitha palët duhet të punojnë së bashku për mirëqenien e përgjithshme të qytetit.

tregtinë dhe marrëdhëniet ekonomike brenda komunitetit.

**Mbrojtja dhe siguria** – hebrejtë dhe myslimanët kishin një marrëveshje për mbrojtje të përbashkët kundër çdo kërcënimi të jashtëm. Hebrejtë ishin pjesë e sistemit të mbrojtjes së qytetit dhe kontribuonin në sigurinë kolektive. Në këmbim, ata gëzonin mbrojtje nga myslimanët dhe pjesa tjetër e komunitetit të Medinës.<sup>3</sup>

**Roli në politikën e përbashkët** – hebrejtë ishin të përfshirë në marrëveshjet dhe vendimet e përbashkëta që ndikuan qytetin e Medinës. Karta e Medinës përcaktonte se të gjitha palët duhet të punojnë së bashku për mirëqenien e përgjithshme të qytetit. Kjo përfshirje nënkuptonte se hebrejtë kishin një zë në çështjet që prekin të gjithë komunitetin, duke përfshirë sigurinë dhe politikat ekonomike. Në përmbledhje, autonomia e brendshme e hebrejve në Kartën e Medinës ishte një element kyç për të siguruar një bashkëjetesë paqësore ndërmjet grupeve të ndryshme fetare dhe etnike në Medinë. Kjo autonomi i lejonte hebrejtë të ruanin identitetin dhe traditat e tyre, duke qenë njëkohësisht pjesë e një komuniteti të gjerë dhe të bashkuar.



## MBROJTJA E NDËRSJELLË E HEBRENJVE DHE MYSLIMANËVE NË KARTËN E MEDINËS

Një nga elementët kryesor të kësaj karte ishte marrëveshja për mbrojtjen e ndërsjellë ndërmjet grupeve të ndryshme brenda qytetit, përfshirë hebrejtë dhe myslimanët. Këtu janë disa aspekte kryesore të kësaj marrëveshjeje:

**Mbrojtja e përbashkët kundër kërcënimeve të jashtme** – të gjitha grupet në Medinë, përfshirë hebrejtë dhe myslimanët, do të duhej të angazhoheshin në mbrojtje të njëri-tjetrit nga çdo kërcënim i mundshëm nga jashtë. Kjo përfshinte sulmet nga fiset ose armiqtë e tjerë të jashtëm. Karta përcaktonte se në rast sulmi, të gjithë anëtarët e komunitetit do të ndihmonin në mbrojtjen e qytetit dhe të gjithë pjesëtarëve të tij, pavarësisht nga përkatësia fetare.<sup>4</sup>

**Ndihma e ndërsjellë në rast konflikti** – nëse një grup brenda Medinës ishte nën sulm ose rrezik, grupet e tjera, përfshirë hebrejtë dhe myslimanët, ishin të detyruar të ofronin ndihmë dhe mbështetje për të mbrojtur të drejtat dhe sigurinë e tyre. Kjo ndihmë përfshinte jo vetëm mbrojtjen ushtarake, por edhe ndihmën logjistike dhe materiale për të përballuar çdo kërcënim.<sup>5</sup>

**Mosbashkëpunimi me armiqtë e jashtëm** – Karta përcaktonte se asnjë grup brenda Medinës nuk do të bashkëpunonte me armiqtë e jashtëm kundër ndonjë grupi tjetër

brenda qytetit. Ky ndalim i tradhtisë ishte një element thelbësor për ruajtjen e besimit dhe unitetit brenda komunitetit. Tradhtia dhe bashkëpunimi me armiqtë e jashtëm ishin të ndaluara dhe konsideroheshin si shkelje e rëndë e marrëveshjes.

Tradhtia dhe bashkëpunimi me armiqtë e jashtëm ishin të ndaluara dhe konsideroheshin si shkelje e rëndë e marrëveshjes.

**Përgjegjësia e përbashkët për shpenzimet e luftës** – të gjitha palët u angazhuan të ndajnë përgjegjësitë financiare për shpenzimet e luftës dhe mbrojtjes. Kjo përfshinte kontribute financiare për të mbuluar shpenzimet e mbrojtjes së përbashkët. Kjo klauzolë siguroi që të gjitha grupet, përfshirë hebrejtë dhe myslimanët, të kishin një interes të përbashkët në mbrojtjen e qytetit dhe të kontribuonin në mënyrë të barabartë në mirëmbajtjen e sigurisë.<sup>6</sup>

**Ruajtja e paqes dhe rendit të brendshëm** – Karta e Medinës përcaktonte se të gjitha grupet do të punonin së bashku për të ruajtur paqen dhe rendin brenda qytetit. Kjo përfshinte zgjidhjen e konflikteve të brendshme në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Një atmosferë e tillë bashkëpunimi dhe mirëkuptimi ishte thelbësore për ruajtjen e një shoqërie të qëndrueshme dhe të harmonishme. Këto elemente të mbrojtjes së ndërsjellë janë dëshmi e përpjekjes së Profetit Muhamed a.s. për të krijuar një komunitet të bashkuar dhe të drejtë në Medinë, ku të gjitha grupet fetare dhe etnike mund të bashkëjetojnë në paqe dhe siguri. Karta e Medinës është një shembull historik i një marrëveshjeje të

suksesshme pluraliste, që siguroi barazinë dhe mbrojtjen për të gjithë anëtarët e komunitetit.<sup>7</sup>

### RESPEKTI RECIPROK NDËRMJET HEBRENJVE DHE MYSLIMANËVE NË KARTËN E MEDINËS

Një nga parimet kryesore të kësaj Karte ishte respekti reciprok ndërmjet hebrejve dhe myslimanëve. Këtu janë disa aspekte kryesore të respektit reciprok të përcaktuara në Kartën e Medinës:

**Njohja dhe respektimi i autonomisë fetare** – Karta e Medinës nënvizonte të drejtën e hebrejve për të praktikuar fenë e tyre pa ndërhyrje. Hebrejtë dhe myslimanët kishin lirinë të ndiqnin ligjet dhe traditat e tyre fetare, duke krijuar një atmosferë të tolerancës dhe respektit reciprok. Fraza: “*Hebrejtë kanë fenë e tyre dhe myslimanët kanë fenë e tyre*”, është një shembull i qartë i këtij respekti reciprok.

**Mbrojtja e përbashkët dhe solidariteti** – Karta përcaktonte se të gjitha palët brenda Medinës do të mbronin njëri-tjetrin nga çdo kërcënim i jashtëm. Kjo përfshinte mbrojtjen e jetës, pasurisë dhe sigurisë së njëri-tjetrit, duke krijuar një ndjenjë solidariteti dhe besimi të ndërsjellë. Ky bashkëpunim në mbrojtje dhe siguri tregoi respektin reciprok për të drejtat dhe mirëqenien e njëri-tjetrit.<sup>8</sup>

**Zgjidhja e konflikteve në mënyrë të drejtë** – Karta parashikonte zgjidhjen e konflikteve dhe mosmarrëveshjeve në mënyrë të drejtë dhe të paanshme. Konfliktet ndërmjet hebrejve dhe myslimanëve do të zgjidheshin në përputhje me ligjin dhe drejtësinë, duke respektuar ligjet e secilit komunitet. Një sistem i tillë drejtësie ndihmoi në ruajtjen e harmonisë dhe respektit reciprok mes grupeve të ndryshme.

**Ndalimi i tradhtisë dhe mbajtja e marrëveshjeve** – Karta e Medinës ndalonte tradhtinë dhe bashkëpunimin me armiqtë e jashtëm. Të gjitha palët ishin të angazhuara për të mbajtur marrëveshjet dhe për të qëndruar besnike ndaj njëri-tjetrit. Kjo ndalesë për tradhti dhe theksi në besnikëri dhe mbajtjen e fjalës së dhënë tregoi respektin e ndërsjellë dhe besimin mes komuniteteve.

Të gjitha palët brenda Medinës ishin të angazhuara për të ruajtur paqen dhe rendin e brendshëm. Kjo përfshinte bashkëpunimin për të parandaluar dhe zgjidhur çdo formë konflikti që mund të kërcënonte stabilitetin e qytetit.

**Bashkëpunimi ekonomik dhe social** – Karta inkurajonte bashkëpunimin ekonomik dhe social mes hebrejve dhe myslimanëve. Të dyja palët kontribuonin në mirëqenien ekonomike dhe zhvillimin e Medinës. Ky bashkëpunim ekonomik ishte një shenjë tjetër e respektit reciprok, duke njohur rëndësinë e kontributit të secilit grup në shoqëri.<sup>9</sup>

**Ruajtja e paqes dhe rendit të brendshëm** – të gjitha palët brenda Medinës ishin të angazhuara për të ruajtur paqen dhe rendin e brendshëm. Kjo përfshinte bashkëpunimin për të parandaluar dhe zgjidhur çdo formë konflikti që mund të kërcënonte stabilitetin e qytetit.<sup>10</sup> Një angazhim i tillë për paqe dhe rend tregoi respektin e ndërsjellë për nevojat dhe të drejtat e njëri-tjetrit.

### PËRFUNDIMI

Karta e Medinës dhe trajtimi i hebrejve në kohën e të Dërguarit a.s., ofrojnë mësim të vlefshme për krijimin e një shoqërie të drejtë dhe të bashkuar. Dokumenti tregon se me një udhëheqje të drejtë dhe me respekt për diversitetin, është e mundur të ndërtohet një komunitet që respekton të drejtat dhe liritë e të gjithëve. Ky model mbetet një referencë e rëndësishme për përpjekjet moderne për të promovuar bashkëjetesën paqësore dhe tolerancën ndërfaqetare.

Në përfundim, studimi i Kartës së Medinës dhe trajtimi i hebrejve në atë periudhë historike tregon rëndësinë e parimeve të drejtësisë, barazisë dhe bashkëpunimit në ndërtimin e një shoqërie harmonike dhe të qëndrueshme. Këto mësim janë të rëndësishme jo vetëm për të kuptuar historinë, por edhe për të ndihmuar në zgjidhjen e sfidave bashkëkohore lidhur me diversitetin dhe tolerancën.

1 Muhamed Hamza el Zejni, *Vethikatu el Medine Dirase Tahlitije*, Dar el Fikr el Arabij, 2005, f. 187.

2 Po aty, f. 188.

3 Fatime Ebu Alij, *Jehud el Medine fi dhil el Hadara el Islamiye*, Dar el Xhejl, 2010, f. 257.

4 Po aty, f. 257.

5 Po aty, f. 258.

6 Po aty, f. 258.

7 Muhamed Hamza el Zejni, f. 198.

8 Husejn Mu'nis, *Dirasat fi Vethikat el Medina*, Merkez ed Dirasat el Arabije, (1995), f. 218.

9 Po aty, f. 200.

10 Muhamed bin Xherir et Taberi, *Tarih et Taberi*, Dar el Kutub el Ilmije, (1995), f. 151.

# Habib ibën Zejd ibën Asim el Ensariju

FËMIJA QË I DHA BESËN PEJGAMBERIT A.S.

Habib Mahmud es Samadij

Një ndër gratë e para që e pranuan Islamin në Medine, ishte edhe Nusejbeh bint Kaab el Mazinij, ose siç njihet si Umu Umarah. Ajo po ashtu ishte njëra prej dy grave që morën pjesë në besatimin e dytë në Akabe, në të cilin mori pjesë me burrin dhe me djalin e saj të vogël Habibin.

Habibi, së bashku me prindërit e tij dhe me një grup të ensarëve (myslimanëve të Medinës) që ishin diku shtatëdhjetë vetë, ishin dakorduar që të takoheshin me Pejgamberin a.s. në Akabe – vend në afërsi të Mekës. Habibi atëkohë ishte fëmijë, akoma nuk i kishte kaluar dhjetë vjet, por imani i



“Po të jap besën o i Dërguari i Allahut se do të dëgjoj, do të të bindem dhe do t’i dal në ndihmë Islamit dhe myslimanëve!”

kishte depërtuar deri në zemrën e tij të vogël, kur kishte parë burrat duke i dhënë besën Pejgamberit a.s., e ai i bekuar u thoshte atyre: “Më pasoni mua duke më dëgjuar e duke mu bindur, në vështirësi dhe lehtësi, në urdhërim për të mirë dhe ndalim nga e keqja dhe duke mos iu frikësuar askujt tjetër përveç Allahut! Po ashtu duke më ndihmuar mua dhe duke më mbështetur kur të vazhdojmë para, qoftë kjo edhe nëse iu kushton me jetët tuaja, familjet dhe fëmijët tuaj, e në kompensim të saj e keni Xhenetin!”

Këto fjalë i dëgjonte djaloshi i ri me vëmendje, e gjithashtu i dëgjonte edhe besatimet e shtatëdhjetë burrave kur i premtuan se do t’iu përmbaheshin këtyre fjalëve. Në fund i erdhi radha edhe djaloshit të vogël. Ai u afrua afër Pejgamberit a.s. dhe e shtriu atë dorën e tij të vogël në dorën e Pejgamberit a.s. dhe i tha:

“Po të jap besën o i Dërguari i Allahut se do të dëgjoj, do të të bindem dhe do t’i dal në ndihmë Islamit dhe myslimanëve!”

Pejgamberi a.s. u gëzua shumë nga fjalët e këtij djaloshit të vogël, si dhe nga kjo familje, e cila kishte marrë rrugë prej qindra kilometrave që ta pasonin Pejgamberin a.s.. Që nga ky moment, njeriu më i dashur në zemrën e Habibit ishte Pejgamberi a.s., madje edhe më i dashur sesa prindërit dhe familja e

tij. Islami u bë më i shtrenjtë për të sesa shpirti dhe jeta e tij.

Pas kësaj, Habibi kthehet me familjen e tij dhe popullin e tij në Medine të gëzuar dhe të lumtur. Eh, sa herë ka shpresuar e është lutur që Pejgamberi a.s. të shkonte në Medine e të jetonte me ta!

Një ditë gati sa nuk i doli zemra nga gëzimi, kur dëgjonte se Pejgamberi a.s. ishte rrugës për në Medine. Që nga ajo ditë, ai dilte në periferi të Medinës dhe me padurim priste se kur po arrinte i dashuri i zemrës së tij.

Më në fund, agoi hëna mbi të gjithë... Erdhi i Dërguari i Allahut së bashku me Ebu Bekrin në Medine... Habibi u gëzua jashtë mase!

Kështu zemra e tij ishte lidhur shumë me Pejgamberin a.s. dhe qysh herët kishte shfaqur çiltërsi dhe sinqeritet në ndihmën ndaj Islamit dhe Pejgamberit a.s..

Nuk kaluan shumë kur ndodhi lufta e Bedrit. Duke u nisur për në luftë, djaloshi i vogël i doli para në rrugë Pejgamberit a.s.. Ai ishte i gatshëm ta dorëzonte shpirtin dhe trupin e tij të vogël, duke i thënë se ishte gati për të luftuar dhe për ta ndihmuar fenë e Allahut. Por, Pejgamberi a.s., e ktheu atë në shtëpi, ashtu siç i ktheu të gjithë moshatarët e tij, si shkak i moshës së tyre të re për të marrë pjesë në luftë.

Në luftën e Uhudit, Pejgamberi a.s. përsëri kishte vendosur ta kthente Habibin në shtëpi, por ai ngulte aq shumë këmbë, saqë e kishte detyruar babanë e tij të ndërmyjetësonte për të

Kjo familje dha kontribut të madh në mbrojtjen e Pejgamberit a.s., duke i larguar shpatat dhe shigjetat nga Pejgamberi a.s., saqë Umu Umara kishte marrë trembëdhjetë plagë duke e mbrojtur me trupin e saj trupin e Pejgamberit a.s.. Por edhe burri i saj e fëmijët e saj nuk kishin shpëtuar pa plagë.

te Pejgamberi a.s.. Kështu Pejgamberi a.s. pranoi Habibin, por me kusht që ai të qëndronte në fund të ushtrisë së bashku me nënën dhe vëllain e tij e t'u jepnin ushtarëve ujë dhe t'u ndihmonin të plagosurve, ndërkohë babai i tij ishte në radhët e para të ushtrisë.

Uhudi ishte luftë e vështirë. Shigjetat fluturonin në drejtim të Pejgamberit a.s. dhe ai i bekuar i kishte thyer dhëmbët e përparmë të tij. Myslimanët kur e panë se çka po ndodhë te Pejgamberi a.s. vraponin ta mbronin atë, ashtu sikurse bënte edhe Umu Umara – nëna e Habibit së bashku me burrin dhe fëmijët e saj. Kjo familje dha kontribut të madh në mbrojtjen e Pejgamberit a.s., duke i larguar shpatat dhe shigjetat nga Pejgamberi a.s., saqë Umu Umara kishte marrë trembëdhjetë plagë duke e mbrojtur me trupin e saj trupin e Pejgamberit a.s.. Por edhe burri i saj e fëmijët e saj nuk kishin shpëtuar pa plagë.

Pas përfundimit të luftës, kur Pejgamberi a.s. nisi ushtrinë për në drejtim të mushrikëve mekasë për t'i zënë e për t'i luftuar prapë, ngase ata kishin ikur menjëherë nga fushëbeteja, Umu Umara i kërkoi leje Pejgamberit a.s. që të shkonte edhe ajo me ushtrinë, akoma pa iu shëruar plagët e ditës së djeshme.

Kur ishin kthyer në Medine pas luftës së Uhudit, Pejgamberi a.s. kishte dërguar vëllain e Umu Umaras, Abdullah ibën Kabin që të shikonte se si ishte gjendja e Umu Umares dhe e familjes së saj, ngase asnjë familje nuk







kishte kontribuar në luftë sikurse familja e saj. Kur Pejgamberit a.s. i arriti lajmi se ata janë mirë, atëherë u gëzua shumë dhe u lutu për ta që të jenë shoqëruesit e tij në Xhenet ashtu sikur ishin në këtë dynja.

Vitet e rinisë së tij, Habibi i kaloi së bashku me Pejgamberin a.s., saqë ishte shumë i kujdesshëm që të mos mungonte asnjëherë në ndejat e Pejgamberit a.s. në Medine dhe jashtë saj. Kështu qëndronte Habibi së bashku me Pejgamberin a.s., derisa ai arriti pjekurinë e tij dhe luftonte me Pejgamberin a.s., duke mos munguar në asnjë betejë të tij dhe çdoherë duke qenë në radhët e para të ushtrisë.

Diku mes vitit të nëntë dhe të dhjetë të Hixhretit, doli nga feja Musejleme el Kedhabi, duke pretenduar se ai ishte pejgamber i dërguar te fisi Beni Hanife në Nexhd. Rreth tij u tubuan edhe disa mynafikë dhe njerëz që synonin marrjen e pushtetit. Kur Pejgamberi a.s. e pa se ai nuk po ndalet, atëherë vendosi që të dërgonte tek ai një shkresë ku e këshillonte atë të largohej nga devijimi dhe të kthehet në fenë e vërtetë. Për t'ia dërguar këtë letër, Pejgamberi a.s. kërkonte një njeri që nuk i frikësohej askujt tjetër përveç Allahut, dhe kështu ai i bekuar vendosi se më i denji për këtë mision ishte Habib ibën Zejdi.

Habibi u gëzua shumë kur Pejgamberi a.s. ia dha këtë detyrë dhe menjëherë kishte nisur rrugën drejt Musejlemes. Kur arriti në Jemameh, nuk mund ta përballonte shikimin në fytyrën e Musejlemes, andaj letrën ia dha dikujt tjetër e ai priste përgjigjen e gënjeshtarit Musejleme dhe të kthehej te Pejgamberi a.s. në Medine.

Kur i arriti letra Musejlemes ai u zemërua shumë, filloi të bërtasë e të flasë, saqë urdhëroi t'i sillej menjëherë para tij Habibi. Musejleme

dëshironte ta bënte atë që kishte bërë edhe Faraoni, andaj mbledhi para tij pasuesit dhe rrethin e tij në një vend të gjerë, dhe para të gjithëve e vendosi Habibin duke e pyetur: “A dëshmon se Muhamedi a.s. është i Dërguar i Allahut?”

Habibi i tha: “Po! Dëshmoj se nuk ka Zot tjetër përveç Allahut dhe se Muhamedi a.s. është i Dërguari i Tij!”

Musejleme i tha: “A dëshmon se unë jam i Dërguar i Allahut?”

Habibi i tha: “Unë jam i shurdhër, nuk të dëgjoj çka po thua!”

Musejleme i zemëruar pse Habibi po tallet me të, e urdhëroi njërin nga xhelatët e tij t'ia priste Habibit një pjesë të trupit, dhe kështu prapë e pyeti: “A dëshmon se Muhamedi a.s. është i Dërguar i Allahut?”

Habibi i tha: “Po, dëshmoj se Muhamedi a.s. është i Dërguari i Tij!”

Musejleme i tha: “A dëshmon se unë jam i Dërguar i Allahut?”

Habibi i tha: “Unë jam i shurdhër, nuk të dëgjoj çka po thua!”

Kështu prapë Musejleme urdhëroi t'i pritet një pjesë e trupit dhe prapë Habibi e përsërit të njëjtën fjalë, derisa shpirti i doli nga trupi i tij, duke dëshmuar se Muhamedi a.s. është i Dërguar i Allahut!

Allahu qoftë i kënaqur me Habibin dhe e pastë pranuar në grupin e shehidëve, të cilët janë të gjallë duke u ushqyer te Zoti i tyre!

Përkthim nga vepra: “Fëmijët përreth të Dërguarit të Allahut”

Përktheu: Mr. Besim Krasniqi

Vitet e rinisë së tij, Habibi i kaloi së bashku me Pejgamberin a.s., saqë ishte shumë i kujdesshëm që të mos mungonte asnjëherë në ndejat e Pejgamberit a.s. në Medine dhe jashtë saj.

# Maskilizmi toksik dhe maskuliniteti (burrëria) i shëndetshëm në Islam

Kohët e fundit, një vëmendje e madhe, qoftë në fushën akademike, ashtu edhe në debatin publik, i është dedikuar feminizmit. Por te ne, ndryshe nga vendet e tjera, shumë pak vëmendje i dedikohet maskilizmit dhe burrërisë, jo detyrimisht nënkuptuar si e kundërta e feminizmit, por që janë të ndërlidhura si nocione. Dekadat e fundit maskilizmi, veçanërisht ai toksik, ka marr hov për shkak të lëvizjes #MeToo, dhe prej industrisë së vetëzhvillimit, por edhe për qëllime konsumerizmi. Termi maskilizëm toksik, ndërlidhet me një sërë sjelljesh dhe tiparësh shoqërore, të cilat zakonisht nxisin vrazhdësinë të meshkujt dhe dominancën e tyre ndaj gjinisë tjetër.

Shoqata Amerikane e Psikologjisë (APA), kur botoi një udhëzues për të punuar me burra dhe djem, në të shpjegoi në mënyrë të veçantë si të sillemi me ata që i përmbahen nocioneve të “burrërisë tradicionale”. APA e përcakttoi maskulinitetin tradicional si “të karakterizuar nga stoicizmi, konkurrenca, dominimi dhe agresioni i cili është në tërësi i dëmshëm dhe toksik” (Pappas, 2019), duke e shpjeguar atë si përkrahje dhe mishërim i një sërë qëndrimesh gjinore, të cilat manifestohen më shpesh në sjelljet e meshkujve.

Për çdo ditë, meshkujve u kërkohet dhe imponohet nga shoqëria të shfaqin disa tipare dhe të veprojnë në një farë mënyrë që të jenë

**Termi maskilizëm toksik, ndërlidhet me një sërë sjelljesh dhe tiparësh shoqërore, të cilat zakonisht nxisin vrazhdësinë të meshkujt dhe dominancën e tyre ndaj gjinisë tjetër.**

në gjendje ta vërtetojë burrërinë e tyre, pra identitetin e tyre gjinor prej mashkulli, së paku sipas përkufizimit të normave tradicionale të asaj shoqërie ku jetojnë. Në shumicën e rasteve këto lloj sjelljesh nuk janë të shëndetshme dhe dëmtojnë jo vetëm djem e burra vetë, por edhe gjininë tjetër. Ky lloj imponimi për të afirmuar veten si mashkull, nis që në fëmijëri me një lloj mekanizmi trushpëlarës që e nxitë atë të ndrydhë ndjenjat e veta “sepse burrat nuk qajnë” duke e dëmtuar kështu shëndetin e tyre mendor, efektet e të cilit mund të jenë afatgjata. Dhe vazhdon me sjellje më të rënda, pasojat e të cilave i paguajnë gratë që kanë lidhje apo janë në ndonjë lloj marrëdhënie me individët në fjalë. Shprehja



më ekstreme e kësaj “burrërie” është dominimi apo dhunimi i vajzave dhe grave.

Duke qenë se liberalizmi ka si moto të vetë shprehinë “në rrethana ekstreme duhen nxitur masa radikale”, kohët e fundit po vërejmë një tjetër fenomen, që është e kundërta ekstreme e këtij maskulinitetit toksik, pra feminiteti i tepruar të meshkujt. Në këtë rast, individët në fjalë janë të butë dhe të ndjeshëm përtej natyrës së tyre, me sjellje dhe tipare femërore, saqë sjellin kthimin në një identitet të ri gjinor.


Thënë kjo, termi i maskulinitetit në përgjithësi përkufizohet si grup karakteristikash fizike, psikologjike dhe të sjelljes që lidhen me të qenit djem dhe burra. Ndërsa maskuliniteti “i shëndetshëm” është një përgjigje ndaj “maskilizmit toksik”, duke u përpjekur të inkurajojë burrat të përfshihen në shprehje të maskulinitetit që nuk janë të dëmshme për të tjerët ose veten e tyre, si një mënyrë për të adresuar pabarazitë gjinore (Rotundi, 2020).

Si gjithmonë, Islami si feja e mesatares, ka propozuar të mesmen e artë që është burrëria e shëndetshme. Cili është pra përkufizimi i një mashkulli të vërtetë në aspektin islam? Përgjigjen e kësaj pyetje e gjejmë në konceptin kuranor të “kav-vamun” përkthyer në shqip si “përgjegjës”, por që nocioni në fjalë shpreh shumë më shumë se kaq.

Para se të sqarojmë dallimin midis “maskilizmit toksik” dhe “maskulinitetit (burrërisë) të shëndetshëm”, duhet të theksojmë se në Kuran është përcaktuar një dallim midis mashkullit (biologjik) dhe burrit. Allahu i Lartmadhëruar thotë: “Dhe Ne krijuam prej çdo sendi dy lloje (mashkull e femër)...” (Edh Dharijat, 49). “O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet vete...” (Huxhurat, 13).

Në Kuranin famëlartë nuk lavdërohet fakti i të qenit mashkull, por në disa raste lavdërohet të qenit burrë. Sipas kësaj, jo çdo mashkull mund të jetë burrë. Pra një njeri lavdërohet për atë çka zgjedh të veprojë (burrërinë), jo për atë të cilën nuk e ka në dorë dhe nuk e ka zgjedhur vetë (të qenit i lindur mashkull). Burrëria e vërtetë nuk nënkuptohet si e kundërta e feminitetit apo feminizmit, por nënkuptohet si

Si gjithmonë,  
Islami si feja e  
mesatares, ka  
propozuar të  
mesmen e artë  
që është  
burrëria e  
shëndetshme.



e kundërta e atyre meshkujve të cilët nuk veprojnë me parimet e burrërisë.

Por cilat janë ato karakteristika të burrërisë që lavdërohen në Kuran dhe që formësojnë vetitë e një maskulinitetit të shëndetshëm, të kundërtat e të cilave tregojnë për një maskilizëm toksik?

**Guximi dhe besa** – “Prej besimtarëve kish-te burra që vërtetuan besën e dhënë Allahut, e disa prej tyre e realizuan premtimin duke dhënë jetën, dhe ka prej tyre që janë duke pritur (ta zbatojnë) dhe ashtu nuk bënë kurrfarë ndryshimi.” (Ahzab, 23);

**Pastrimi** – qoftë ky pastrim fizik pra përkujdesja në detajet e anës fizike si abdesi, guqli, higjiena personale, ose pastrim shpirtëror nga mynafikllëku (dyfytyrësia). Një burrë i vërtetë nuk bën lojëra dhe filma duke skenuar standarde të dyfishta, por vepron me sinqeritet dhe pastërti. “...Një xhami e cila që prej ditës së parë është themeluar në respekt ndaj Allahut (pa hile), është më e drejtë të falesh në të, **aty ka burra që dëshirojnë të pastrohen mirë, e Allahu i do të pastrit.**” (Et Teube, 108);

**Të qenit të disiplinuar dhe parimor** – “Ata janë **burra** që nuk i pengon as tregtia e largët e as shitblerja në vend të përmendjes se Allahut, për ta falur namazin dhe për ta dhënë zekatin, ata i frikësohen një dite kur do të tronditen zemrat dhe shikimet.” (En Nur, 37);

**Të ngriturit e zërit dhe thënia e së vërtetës** – “Dhe prej skajit më të largët të qytetit erdhi një burrë që ngutej e tha: “O populli im, dëgjoni të dërguarit!”. (Ja Sin, 20). Ajeti në fjalë na tregon se jo vetëm largësia nuk e pengoi atë njeri të ndërmerre një udhëtim të gjatë vetëm e vetëm për të protestuar një padrejtësi, por i vetëm e ngriti zërin dhe nuk heshti ndaj asaj çka po ndodhte në atë kohë.

Tani, le të përqendrohemi tek e kundërta e burrërisë: maskilizmi toksik. Disa nga tiparet që e karakterizojnë këtë lloj mendësie janë pak a shumë e kundërta e burrërisë. Për shembull, meshkujt toksik përqendrohen më shumë te pamja e jashtme dhe forca fizike, sepse kërkon më pak energji dhe angazhim të ndërtohet muskuj sesa të



ndërtosh një karakter të fortë. Të tillë, ushtrojnë forcën fizike mbi më të dobët që kanë nën mbikëqyrje duke ushtruar autoritet. Pra, është e vërtetë se “myslimani i fuqishëm është më i mirë se myslimani i dobët” por kjo lloj fuqie jo gjithmonë nënkupton atë fizike. Mjafton fakti që në shpalljen hyjnore dhe në traditën profetike nuk është vënë theksi dhe nuk i është mëshuar idesë së forcës fizike apo ndërtimit të një trupi plot muskuj duke kaluar me orë të tëra në palestër, duke konsumuar proteina pluhur derisa kjo lloj praktike të kthehet në përparësi për myslimanin.

**Mungesa e burrërisë, përdorimi i forcës fizike ndaj më të dobëtëve** – Një grup grash kanë shkuar tek i Dërguari i Allahut duke iu ankuar për burrat e tyre, të cilët kishin abuzuar me to dhe përdorur dhunë. Profeti a.s., iu përgjigj: “Këta s’janë burrat tanë më të mirë”, duke kritikuar fenomenin në fjalë si mungesë burrërie.

**Mungesa e mëshirës dhe butësisë** – Maskilizmi toksik mëson se meshkujt nuk duhet të shfaqin emocionet e tyre (veçanërisht ndjeshmërinë dhe butësinë), sepse kjo është shenjë dobësie. Mirëpo edhe Profeti a.s. ka qarë dhe nuk i ka dhënë mësim sahabëve se “burrat nuk qajnë”. Kur një njeri ka parë të Dërguarin duke luajtur me nipat e tij, Hasanin dhe Husejnin, është habitur dhe ka thënë: “Unë kam fëmijë plot, por nuk e kam puthur asnjërin prej tyre.” Dhe Profeti iu përgjigj: “Çka mund të të them unë ty, nëse Allahu e ka shkëputur mëshirën nga zemra jote.”

**Dominimi (mbizotërimi) kundrejt lidershit dhe të qenit kav-vamun** – Maskilizmi toksik nxit indiferencë ndaj roleve gjinore duke promovuar slogane se “burrat e vërtetë nuk bëjnë punë shtëpie”, ndërkohë që shembullin e burrërisë së vërtetë e kemi krijuar më të nderuar që ka ardhur në këtë botë, dhe ai është i Dërguari i Allahut, i cili kontribuonte në

punët e shtëpisë dhe kujdesej për gratë e tij. Në Islam, “burrat janë përgjegjës për gratë” (Nisa, 34), çka e vendos burrin para përgjegjësisë për t’i dalë për zot gruas së tij, në rolin e liderit të familjes dhe jo në rolin e diktatorit, i cili dëshiron thjesht të ushtrojë autoritetin e vet dhe të shfrytëzojë sa të mundet fuqinë, energjinë dhe të gjitha potencialet e gruas dhe anëtarëve të tjerë të familjes. “Të gjithë ju jeni barinj dhe secili do të përgjigjet për kopenë e vet. Imami është bari dhe do të pyetet për kopenë e tij. Burri është bari në shtëpinë e vet dhe ai do të pyetet për kopenë e tij. Gruaja është bareshë në shtëpinë e burrit dhe ajo do të pyetet për kopenë e saj, edhe shërbëtori është bari në pasurinë e zotërisë së tij dhe ai do të pyetet për atë që e ka ruajtur. Të gjithë ju jeni barinj dhe do të përgjigjeni për atë që keni ruajtur.” (Muhamedi a.s.). Roli i bariut në këtë hadith është roli i një lideri të drejtë që përkujdeset dhe udhëheq jo që jep urdhra dhe shfrytëzon, por i del për zot “kopesë” dhe mban përgjegjësi për të.

Cilado qofshin ideologjitë e kohës dhe idetë mbizotëruese që bëhen trend nëpër internet dhe në sferën publike, etaloni matës për myslimanët duhet të jetë gjithmonë Islami dhe parimet islame. Nëse besojmë se Islami është feja të cilën Vetë Zoti e plotësojë dhe e përsosi për ne, atëherë duhet të besojmë së shembulli më i lartë i takon Atij.

#### LITERATURA:

1. Buhariu, (hadithi 893).
2. Pappas, S. (n.d.). *APA issues first-ever guidelines for practice with men and boys*. <https://www.apa.org>. <https://www.apa.org/monitor/2019/01/ce-corner> Problematizing ‘toxic’ and ‘healthy’ masculinity for addressing gender inequalities. (46 C.E.). *Australian Feminist Studies*, 34(101), 362–375.
3. Rotundi, L. (2020). *The issue of toxic masculinity*. Libera Università Internazionale degli Studi Sociali Guido Carli.



Mr. Njomza Sadriu

# Feja islame nxit mësimin, vëzhgimin dhe shkencën


Shkenca e sotme nuk është asgjë tjetër përveç vëzhgimit. Shkencëtarët së pari vëzhgojnë një problem dhe më pas në bazë të eksperimentit të ndjekur nga vëzhgimi i mëtejshëm arrijnë në një zgjidhje të caktuar. Kështu, vëzhgimi është shkencë dhe shkenca është një komponent kryesor i të gjithë procesit të të mësuarit.


Islami është një përkrahës i madh i të mësuarit. Islami dëshiron që pasuesit e tij të marrin njohuri për gjërat që Allahu i ka krijuar dhe dhuruar, në mënyrë që ata të jenë

më të aftë për të pranuar bekimet e Tij. Rreshtat e mëposhtëm diskutojnë mënyrat në të cilat Islami inkurajon mësimin, vëzhgimin dhe shkencën.

Shpallja e parë për Profetin Muhamed a.s. ishte: *“Lexo! Me emrin e Zotit tënd i Cili krijoi (gjithçka që ekziston). Ai e ka krijuar njeriun nga një mpiksje (një copë gjaku i trashë i mpiksuar). Lexo! Dhe Zoti juaj është më Bujari. Kush e ka mësuar (shkrimin) me laps. Ai i ka mësuar njeriut atë që ai nuk e dinte.”* (El Alek, 5).

Islami dëshiron që pasuesit e tij të marrin njohuri për gjërat që Allahu i ka krijuar dhe dhuruar, në mënyrë që ata të jenë më të aftë për të pranuar bekimet e Tij.





Këto ajete të Kuranit tregojnë qartë se Allahu i Plotfuqishëm fillimisht iu drejtua Profetit Muhamed a.s. me urdhërimin e leximit, i cili është një pjesë kryesore e procesit të të mësuarit. Prandaj, fillimi i shpalljes së Kuranit me fjalën “*Lexo*” tregon llojin e rëndësisë që Islami i jep leximit në përgjithësi dhe kërkimit të diturisë dhe mësimin në veçanti. Për më tepër, ky ajet tregon gjithashtu se mësimi vjen nga Allahu i Plotfuqishëm pasi që Ai është që ia mësoi njeriun shkrimin. Format e të mësuarit që ne i shohim në botë aktualisht janë të gjitha një bekim nga Allahu i Madhëruar dhe mos shfrytëzimi i tyre do të thoshte mosmirënjohja ndaj bekimeve që i jepen një personi.

Kjo dispozitë e aftësisë për të mësuar dhe kërkuar dituri është nga Allahu i Madhëruar, për të cilën Ai në Kuran thotë: “*Dhe Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja, ndërsa ju nuk dini asgjë. Dhe Ai ju dha të dëgjuarit, të parit dhe zemrat, që të mund ta falënderoni (Allahun).*” (En Nahl, 78).

Ky ajet jep arsyen e sigurimit të shqisave nga Allahu i Madhëruar. Qëllimi prapa asaj pse Allahu xh.sh. na dha shikimin, zemrën dhe dëgjimin është që ne duhet t'i përdorim ato në rrugën e të mësuarit dhe të marrim njohuri për çdo gjë që na rrethon. Kur një besimtar i përdor të gjitha këto shqisa me qëllim të mësimin dhe kërkimit të dijes, atëherë ai ose ajo përfundimisht arrin në përfundimin se bekimet e Allahut të Madhëruar janë të pafundme dhe se ne duhet të jemi mirënjohës për secilën prej tyre me çdo frymë që marrim.

Për sa i përket rëndësisë së kërkimit të diturisë apo përpjekjes për rritjen e saj, Allahu i Madhëruar e urdhëroi Profetin Muhamed a.s. që të lutej për shtimin e saj. Në Kuran, për këtë thuhet: “*Dhe thuaj: “Zoti im! Më shto njohuritë!”*” (Ta Ha, 114).

Nga ky ajet bëhet e qartë se Allahu i Plotfuqishëm e inkurajoi Profetin a.s. që të lutej për shtimin e diturisë. Një mysliman duhet të përpiqet të kuptojë se Muhamedi a.s. ka qenë një profet dhe njeriu më i ditur që mund të ketë ndonjëherë. Nëse Allahu po i kërkon atij lutje për shtimin e diturisë, atëherë myslimanët aktualisht që kanë kaq pak njohuri nuk duhet të ndalojnë kurrë së kërkimi për më shumë njohuri. Prandaj, në Islam, nuk ka të ndalur mësimi dhe kërkimi i diturisë, qoftë ajo fetare apo shkencore.

Lidhur me shpërblimin që lidhet me procesin e të mësuarit dhe kërkimit të diturisë, Profeti Muhamed a.s., në një hadith ka thënë: “*Kush ndjek një rrugë në kërkim të diturisë, Allahu do t'ia lehtësojë rrugën për në Xhenet.*” (Buhariu).

Ky hadith tregon se përveç ngopjes së shpirtit të diturisë, kërkimi i diturisë vjen edhe me trotuarin për në Xhenet. Tani ky hadith mund të interpretohet në dy mënyra.

E para prej të cilave është e qartë është se, ata që kërkojnë dituri janë të bekuar nga Allahu i Madhëruar.

Mënyra e dytë në të cilën mund të shihet ky hadith është fakti se kur një person përpiqet në rrugën e kërkimit të diturisë dhe është i vërtetë për shkakun, atëherë ai ose ajo mëson realitetin e gjërave. E kur dikush është në gjendje të kuptojë realitetin e gjërave, atëherë ai ose ajo është në gjendje të bëjë dallimin ndërmjet të drejtës dhe të gabuarës dhe veprimi sipas të parës është ajo që të çon në parajsë.

Si përfundim mund të themi se feja islame është një stimuluese e madhe e të mësuarit. Ajo inkurajon të gjithë ata që shkojnë në rrugën e të mësuarit. Islami e kupton se çdo lloj dijeje, qoftë fetare apo shkencore, që është e dobishme për njerëzimin duhet të përvetësohet dhe të mësohet. Vetëm në bazë të njohurive njerëzit mund të bëhen më të avancuar dhe më të civilizuar.

Një mysliman duhet të përpiqet të kuptojë se Muhamedi a.s. ka qenë një profet dhe njeriu më i ditur që mund të ketë ndonjëherë. Nëse Allahu po i kërkon atij lutje për shtimin e diturisë, atëherë myslimanët aktualisht që kanë kaq pak njohuri nuk duhet të ndalojnë kurrë së kërkimi për më shumë njohuri.

# Libër me përmbajtje të pasur edukative dhe morale

SEVDAIL JAKUPI “PËRSOSJA E PERSONALITETIT NË ISLAM”  
SH.B. “LENA” PRISHTINË, 2024, FQ.300.

“Përsosja e personalitetit në Islam”, është libri më i ri i hoxhës, Sevdail Jakupi nga Presheva, libër me material të thukët të lëmit moralizues fetar.

Autori në këtë libër trajton tema me rëndësi për lexuesit dhe për popullatën në përgjithësi. Që nga titulli i librit, tregohet edhe semantika e gjithë librit. Çdo njeri ka personalitetin e tij të ndërtuar në forma të ndryshme, ku disa personalitete bien ndesh me jurisprudencën islame, sidomos ata që nuk e njohin Islamin, nuk i respektojnë urdhrat e Zotit të Madhërisëm, nuk e duan fenë, me një fjalë e quajnë veten ateistë (jobsimtarë). Të tillët duhet lexuar dhe rilexuar këtë libër, por jo vetëm këta, librin duhet ta lexojmë të gjithë, duhet të bëhemi pjesë e shpjegimeve dhe të materialit që fshihet brenda kopertinave, me përmbajtje të pasur.

## NGA KAPITULLI NË KAPITULL

Libri, “Përsosja e personalitetit Islam”, i hoxhës, Sevdail Jakupi, në vete ngërthen një laramani temash me rëndësi për njeriun, për një mysliman të çfarëdo etnie qoftë, për një

Libri,  
“Përsosja e  
personalitetit  
Islam”, i  
hoxhës,  
Sevdail Jakupi,  
në vete  
ngërthen një  
laramani  
temash me  
rëndësi për  
njeriun, për  
një mysliman  
të çfarëdo  
etnie qoftë, për  
një qytetar.





qytetar. Në të shumë mirë trajtohen gjetje interesante për lexuesit, të shtrira nëpër kapitujt e librit.

Besimi në Zot, çelësi i edukimit islam, në të cilën trajton tema që lidhen me kapitullin, sepse, vërtet besimi në Zot është çelësi i besimit, edukimit, moralit dhe me këtë nis faza e parë e ngritjes dhe përsosjes së personalitetit në Islam, për të vazhduar me kapitullin tjetër, realizimi i cilësive morale dhe me nënkapitujt interesant që shkokëlohen brenda këtyre njësive.

Vazhdimi i kapitujve paraqet edhe njohuri të tjera, të sistematizuara nëpër kapitujt e tjerë nga kapitulli një deri te kapitulli i fundit përmblyllës, i nënti me radhë, me titull “Civilizimi Islam”, i cili nevojitet të shfaqet në realitet. Lexuesi njihet për së afërmi me materialet e thukëta dhe mjaft domethënëse, të cilat autori ua ka servuar lexuesve në përgjithësi, e të cilat janë si një praktikum me të cilin popullata në përgjithësi ju ikë të këqijave, veseve negative që përthekohemi si shoqëri.

Në të nëntë kapitujt përfaqësues në libër, jepet një tablo shumë reale e mënyrave shpjeguese të autorit. Këtë tematikë të qëlluar, autori e ka shtjelluar bukur mirë, duke rrugëtuar kështu me nënkapitujt e me njësi

Ky libër ka vlerën e vet dhe duhet ta kenë bibliotekat e qytetit, rajonale dhe ato personale, dhe të lexohet sa më tepër nga lexuesit, në mënyrë që këto porosi të librit, të materializohen në shoqërinë tonë.

interesante, me të cilat ballafaqohemi çdo ditë ne si shoqëri.

“Mësimi që ne gjejmë në librat, është si zjarri. Ne shkojmë ta marrim atë nga fqinjët tanë, ta ndezim në shtëpi, t’ua shpërndajmë të tjerëve, dhe ai bëhet pronë e të gjithëve.”  
- Volteri

Pra edhe ky libër i hoxhës, Sevdail Jakupi, me gjithë rëndësinë, vlerën që ka, sigurisht se do të japë shkëndijat e para së lexuari për dituri, drejtësi, nder, respekt, deri te ngritja dhe përsosja e personalitetit të njeriut, ashtu siç e jep Islami.

### **POROSIA NGA LIBRI**

Pas leximit të librit, gjejmë shumë porosi, të nxjerra nga teksti që po e shqyrtojmë, porosi këto që janë të lidhura nyje me jetën tonë të përditshme, kanë një ngjashmëri edhe me karakterin kombëtar, sepse të gjitha këto porosi që dalin nga kuptimshmëria e librit dhe të tillat i kemi edhe në jetën e përditshme, në punë, në ambient, në shkollë, në shoqëri dhe në të gjitha aspektet e jetës.

Ky libër ka vlerën e vet dhe duhet ta kenë bibliotekat e qytetit, rajonale dhe ato personale, dhe të lexohet sa më tepër nga lexuesit, në mënyrë që këto porosi të librit, të materializohen në shoqërinë tonë.





# Sadri ef. Prestreshi (1917-2002)

Sadri ef. Prestreshi lindi më 17 tetor 1917, në fshatin Mazgit, në rrethinën e Prishtinës. Mësimet fillestare i kreu në Obiliq, që tani quhet Kastriot, ku ishte ndër nxënësit më të shquar. Në vitin 1930 u regjistrua në Medresenë “Pirinaz” të Prishtinës, pranë dijetarëve të njohur të asaj kohe, mulla Hamdi ef. Gërçina dhe mulla Ahmed ef. Mardoçit, të cilët dalloheshin edhe për ndjenjat e zjarra atdhetare.<sup>1</sup>

Në Medresenë “Pirinaz” pasi e kryenin nivelin e parë, nxënësit merrnin tituj të ultë fetarë. Por në qoftë se dëshironin që t’i vazhdonin studimet edhe në specializim në shkencat islame, mund ta bënin para ndonjë myderrizi të njohur, që jepte mësim në nivele të larta, i cili në fund pasi bënte një testim shumë rigoroz i jepte edhe ixhazetnamenë. Për mbarëvajtjen e provimeve, Drejtoria e Medresesë ishte e obliguar të mbante procesverbale, sipas formularëve të dërguar posaçërisht për këtë nga Ulema Mexhlisi i Shkupit.

Komisionin provues të Medresesë “Pirinaz” e përbënin:

1. Hajrullah ef. Mehmedi, kryetar,
2. Daut Osmani, anëtar, i deleguar i Vakëf Mearifit të rrethit të Prishtinës,
3. Hamdi ef. Ibrahim, myderriz,
4. Ahmed ef. Ajeti, myderriz.

Sipas dokumenteve, në klasën e dytë, mësimet i kishin ndjekur gjithsej 33 nxënës. Kurse në klasën e katërt kishin arritur gjithsej 39 nxënës. Me numrin rendor 25 ishte regjistruar nxënësi Sadri ef. Prestreshi, i cili në provimin me gojë dhe me shkrim kishte arritur rezultate të larta dhe ishte vlerësuar me notën pesë në lëndët: Kuran, Ibadat-ahlak dhe gjuhë arabe, kurse në gjuhën turke, histori islame dhe ilahi me notën katër. Në fletën e provimit me shkrim, në gjuhën

arabe dhe turke, shihet se Sadri efendiu kishte një bukurshkrim të mirë, se provimit i qe nënshtuar më 15 mars 1935, se është nënshkruar si Sadri Rexhep Ibrahim nga fshati Mazgit dhe se vlerësimin e provimit e kishte bërë myderrizi Hamdi ef. Ibrahim.<sup>2</sup>



Mulla Sadri Prestreshi (1917-2002)

Pas kryerjes së nivelit të parë të Medresesë së reformuar të “Pirinazit”, Sadri efendiu do t'i vazhdonte mësimet në nivelin e lartë në Medresenë “Sulltan Selim” të myderrizi tjetër haxhi Iljas ef. Shasivari, si kandidat për të marrë ixhazetnamenë. Në kohën e “Shqipërisë etnike”, jo vetëm që ishte rihapur Medreseja “Sulltan Selim” e Prishtinës, por në përgjithësi jeta institucionale dhe arsimore frymonte më lirshëm. Shih për këtë një nga lëndët që mësohej në medresetë e kësaj kohe ishte detyrimisht edhe lënda e gjuhës shqipe. Sipas një liste të hartuar nga myderrizi dhe drejtori i kësaj medreseje, haxhi Iljas ef. Shasivari, shihet se Medreseja “Sulltan Selimi III” më 1943 kishte 29 nxënës, i treti në listë që Sadri efendiu, që vërtetohet edhe me një dëshmi që po haxhi Iljas Shasivari i kishte lëshuar më 15 prill 1943 Sadri efendiut. Aty shkruan: “Dishmi me anën e së cilës i nënshkruemi Drejtor i shkollës së Medresesë Sulltan Selim të këtij qyteti (Prishtinës) vërtetoj me nënshkrimin tem se i quajturi Sadri Ibrahim i komunës së Fushë Kosovës dhe i datëlindjes 1917 asht nxanës i klasës së nalt të këtij instituti dhe frekuenton mësimet me rregull pranë kësaj shkolle.”<sup>3</sup>

Në vitin 1931 kishte filluar Medresenë “Pirinaz” të myderrizi Hamid ef. Ibrahim i – Gërnica dhe Ahmet ef. Ajeti – Mardoçi. Në vitin 1935 kishte mbaruar ciklin e ulët dhe pastaj është regjistruar në Medresenë e “Sulltan Selimit III” të myderrizi haxhi Iljas ef. Shasivari – Hashani, tek i cili, në vitin 1945 kishte marrë ixhazetnamenë. Dijet e marra në medresetë gjithmonë i kanë shërbyer fesë dhe vatanit, prandaj edhe figura e Sadri ef. Prestreshit ishte një brumë i brumosur në vatrën e medreseve, ku ka shërbyer me vendosmëri për fe e atdhe.


Më 1939 myderriz Sadri Prestreshit iu ndërpre shkollimi dhe u dërgua në shërbim ushtarak. Për shkak të tipareve fizike si person i pashëm dhe i arsimuar, asokohe u sistemua në Regjimentin e Këmbësorisë së Gardës Mbretërore në Beograd. Gjatë shërbimit ushtarak filloi Lufta e Dytë Botërore dhe pas bombardimit të Beogradit (6 prill 1941), Sadri Prestreshi me disa shokë shqiptarë ikën nga ushtria jugosllave, në shpërbërje e sipër, dhe afërsisht pas dy javësh ecje në këmbë arrijnë

Sipas një liste të hartuar nga myderrizi dhe drejtori i kësaj medreseje, haxhi Iljas ef. Shasivari, shihet se Medreseja “Sulltan Selimi III” më 1943 kishte 29 nxënës, i treti në listë që Sadri efendiu, që vërtetohet edhe me një dëshmi që po haxhi Iljas Shasivari i kishte lëshuar më 15 prill 1943 Sadri efendiut.

në Mitrovicë. Në Mitrovicë kapen nga forcat ushtarake gjermane dhe dërgohen në kazermë ushtarake. Nga kazerma ushtarake kishte shfrytëzuar rrethanat e përshtatshme dhe gjatë dhënies ujë kuajve në lumin Sitnica ikën e kthehet në vendlindje, në Mazgit. Pas kthimit në vendlindje, Sadri Prestreshi mbaron kursin për nëpunës administrate në gjuhën shqipe.<sup>4</sup>

Në gusht të vitit 1944, me dekretin e Qeverisë Shqiptare, u emërua imam-ofiqar në Xhaminë e Dobrajës së Madhe të Lipjanit. Pas vendosjes së pushtetit komunist jugosllav, me një dekret të datës 28 dhjetor 1944 iu dhanë dy detyra: imam në Xhami të Dobrajës së Madhe dhe mësues i shkollës shqipe aty. Në mars të vitit 1945 i ndoqi mësimet në kursin pedagogjik për mësues në Prishtinë dhe, ndonëse e mbaroi me sukses, në fillim të vitit shkollor 46/1945 mbajti vetëm detyrën e imamit në Xhaminë e Dobrajës. Mirëpo, pasi do të shfaqet nevoja për mësues të shkollës shqipe, në vitin shkollor 1946/47 prapë iu besua ditari i mësuesit në shkollën e Dobrajës, krahas detyrës së imamit në xhami. Detyra binjake, imam dhe mësues, ia bëri të mundshme të lidhej fuqimisht me masat e gjera popullore dhe të merrej me hallet e tyre jetësore. Rrethanat politike, në të cilat jetonte Kosova, e detyruan Mulla Sadriun të merrej edhe me veprimtari politike kombëtare ilegale.<sup>5</sup>

Aktivitetin patriotik mulla Sadri Prestreshi e kishte zhvilluar deri në vitin 1947, ku edhe u arrestua me një tradhti dhelparake nga organet e UDB-së, ku më 22 shkurt 1947 nga udbashatë ishte bërë plani që hoxha të arrestohej. Pasi kishte autoritet në popull dhe për t'iu shmangur fshatarëve, ata e thirrën hoxhën në zyrat e tyre të komunës së Obiliqit, gjoja për t'i ndihmuar lidhur me përpilimin e disa listave të zgjedhësit. Mu në këtë vit, të datës 23 mars, derisa ishte duke punuar hoxha, kishte hyrë hetuesi dhe e kishte arrestuar. Pas arrestimit e kishin keqtrajtuar në mënyrën më të keqe të mundshme, mirëpo edhe pse e keqtrajtuat, ai nuk pranoi se ka lidhje me komunitetin. Nga dëshmitarët e kishin zbuluar se ky komunitet i Dobrajës kishte më shumë lidhje me detyra ushtarake dhe nga kjo del se dosja e mulla Sadri



Prestreshit kishte kaluar në Gjyqin Ushtarak të Divizionit në Prishtinë.

Gjatë procesit gjyqësor, që u organizua nga Gjykata Ushtarake e Divizionit të Prishtinës, mulla Sadri Prestreshi akuzohej se kishte zhvilluar aktivitet të dëndur për anëtarësimin e anëtarëve të rinj në NDSH, kishte marrë pjesë aktive në formimin e komiteteve të reja, siç ishte ai në fshatin Dobrajë e Madhe. Ai kishte kryer edhe punën e sekretarit pranë Komitetit të NDSH-së të Rrethit të Sitnicës. Gjatë veprimtarisë ilegale, mulla Sadri Prestreshi akuzohej se kishte mbajtur kontakte e konsulta të vazhdueshme edhe me udhëheqësit kryesorë të ilegales, si me Ajet Gërgurin, Gjon Serreçin, Azem Bellaqefcin, Smajl Dragushën e shumë të tjerë.<sup>6</sup>

Më 15 prill 1947, Gjykata Ushtarake e Divizionit të Prishtinës, e cila kishte organizuar këtë proces gjyqësor ndaj tij, dënoi mulla Sadri Prestreshin me 4 vjet burg të rëndë dhe njëkohësisht me punë të detyrueshme. Pasi doli nga burgu, mulla Sadri Prestreshi një kohë nuk kishte të drejtë që të kryente punën e imamit.

Në fund të vitit 1948 u emërua mësues në shkollën fillore të Obiliqit, ndërsa në vitin vijues shkollor 1949/50 do të transferohej në shkollën fillore të Korroticës së Poshtme të Komunës së Drenasit (ish-Gillogocit). Atje do të shoqërohet me burra të çmuar. Atje ndodhej Haxhi Agushi i Prishtinës, axha i Iljaz Agushit, njëri ndër burrat më të pathyeshëm, kombëtar dhe fetar i mirë, i dënuar me 15 vjet burg me punë të detyrueshme. Pranë Mulla Sadriut, aty shohim të jetë edhe kapiteni i Ushtrisë Mbretërore Shqiptare, Shefqet Bylykbashi,

një patriot urtak e dinjitoz. Në janar të vitit 1962, Mulla Sadriu emërohet imam në Xhaminë e Madhe (Sulltan Mehmet Fatih) dhe në të njëjtën kohë kryen edhe punën administrative në Kryesinë e Bashkësisë Islame në Prishtinë. Gjatë kësaj periudhe, Mulla Sadriu si imam i Xhamisë së Madhe të Prishtinës zhvilloi aktivitet të dëndur fetar e kulturor. Mirëpo, ky aktivitet i tij nuk u shkonte përshtati organeve të pushtetit, të cilat e shihnin si të papërshtatshëm, andaj e larguan nga detyra e imamit nga Xhamia e Madhe për ta transferuar në Xhaminë e “Jashar Pashës”, gjithashtu në Prishtinë. Detyrën e imamit në “Jashar Pashë” e kreu deri në vitin 1969. Nga viti 1953 deri më 1969 punoi imam i xhamisë në Miradi të Poshtme e në Prishtinë, dhe afro 15 vjet si pedagog në Medresenë “Alauddin” në Prishtinë.<sup>7</sup>

Mulla Sadri Prestreshi jetoi 82 vjet. Ai përjetoi edhe dëbimin nga shtëpia e tij, në luftën e fundit që ndodhi në Kosovë, ku edhe ishte vetë dëshmitar i djegies së shtëpisë së tij nga forcat pushtuese serbe në vitin 1999. Pas kësaj lufte shumë barbare ndaj popullit shqiptar, mulla Sadri Prestreshi jetoi i lumtur sepse iu realizua një ëndërr e kamotshme që kishte, që Kosova të jetë e lirë. Mulla Sadri Prestreshi ndërroi jetë më 16 janar 2002, në moshën 82 vjeçare.

Në Xhaminë e Madhe në Prishtinë, ku kishte shërbyer si imam dhe hatib për disa vite, aty ishin tubuar me qindra qytetarë për faljen e namazit të xhenazes, ku këtij namazi i priu Myftiu i Kosovës, dr. Rexhep Boja. Ai u varros në fshatin e tij Mazgit të Kastriotit, ku edhe kishte lindur më 17 tetor 1917, ndërsa u varros me nderime shumë të larta më 16 janar 2002.

- 1 Mexhid Yveysi, *Mulla Sadri Prestreshi (1917-2002)*, <https://www.islamgjakova.net/artikulli.php?id=1796>, ora: 11:56, data:16.11.2023.
- 2 Sadik Mehmeti, *Sadri ef. Prestreshi nxënës në medresenë “Pirinaz” të Prishtinës*, Myderriz Sadri ef. Prestreshi jeta dhe vepra (1917-2002) Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 22 shkurt 2012), shtëpia botuese: “Dituria Islame”, Prishtinë, 2013, f. 27.
- 3 Sadik Mehmeti, *Sadri ef. Prestreshi nxënës në medresenë “Pirinaz” të Prishtinës*, po aty, f. 27-28.
- 4 Ruzhdi Pllana, *Të dhëna për jetëshkrimin e myderriz Sadri Prestreshi dhe për familjen e tij (1917- 2002)*, Myderriz Sadri ef. Prestreshi jeta dhe vepra (1917-2002) Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 22 shkurt 2012), shtëpia botuese: “Dituria Islame”, Prishtinë, 2013, f. 13.
- 5 Muhamet Pirraku, *“Shpresimi” i organizatës së NDSH-së*, Myderriz Sadri ef. Prestreshi jeta dhe vepra (1917-2002) Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 22 shkurt 2012), shtëpia botuese: “Dituria Islame”, Prishtinë, 2013, f. 54-55.
- 6 Sabile Keçmezi, *Veprimtaria atdhetare e Mulla Sadri Prestreshit*, Myderriz Sadri ef. Prestreshi jeta dhe vepra (1917-2002) Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 22 shkurt 2012), shtëpia botuese: “Dituria Islame”, Prishtinë, 2013, f. 82.
- 7 Fahrush Rexhepi, *Mulla Sadri Prestreshi – gjithnjë në shërbim të fesë dhe atdheut*, Myderriz Sadri ef. Prestreshi jeta dhe vepra (1917-2002) Përmbledhje kumtesash nga sesioni shkencor (Prishtinë, 22 shkurt 2012), shtëpia botuese: “Dituria Islame”, Prishtinë, 2013, f. 91-92.

# Ezani i parë i namazit në Beograd

Më 28 gusht të vitit 1521, ushtria e Sulltan Sulejmanit të Madhërishëm përfundimisht e mori Beogradin nga hungarezët. Beogradi gjatë kohës së sundimit osman, ishte fillimisht qendër e Sanxhakut të Smederevës, përkatësisht Pashallëkut të Beogradit. Ishte një prej qendrave më të mëdha tregtare në Gadishullin Ballkanik.

Shënimi i parë për xhamitë është i lidhur me vitin 1521. Ai gjendet në Ditarin e ekspeditës të Sulejmanit ndaj Beogradit. Në atë ditar është e shënuar *“Me ndihmën e Zotit kalaja e Beogradit sot është marrë. [...] Muejzimi mbretëror nga qyteti e thërret ezanin. Më 26 ramazan, e premtë [...] Sulltani i madhnueshëm nëpërmjet të urës së ndërtuar i gëzuar kalon dhe vjen në Beograd. Ai ka pezulluar shërbimin nga e premtja.”*<sup>1</sup>

Përkitazi me këtë Evilja Çelebiju, udhëpërshkruesi dhe historiani i njohur, duke e përshkruar Beogradi thotë se ezani i parë është kënduar në muret e Kalasë së Beogradit, që më vonë quhet Kalemegdan, të enjten më 26 ramazan të vitit 927, që do të thotë më 30 gusht të vitit 1521. Në Beograd të parët kanë hyrë: Gazi Huservbeu, sanxhakbeu i Smederevës dhe Kuçuk Belibegu, beg i Bosnjës. Datën e njëjtë e thekson edhe Peçevija, ndërsa në analet e Dubrovnikut përmendët një ditë më vonë, pra, më 31 gusht 1521.<sup>2</sup>

Nga Beogradi, gjatë kohës së Ramazanit, kanë shkuar një numër i madh i imamëve për faljen e namazit të taravive në këto vende:

Evilja Çelebiju, udhëpërshkruesi dhe historiani i njohur, duke e përshkruar Beogradi thotë se ezani i parë është kënduar në muret e Kalasë së Beogradit, që më vonë quhet Kalemegdan, të enjten më 26 ramazan të vitit 927, që do të thotë më 30 gusht të vitit 1521.

Nish, Zrenjanin, Pançevë, Novi Sad, Veternik, Sremičicë, Rruga ushtarake, Zemun, Beogradin e ri, ndërsa në Bajrakli Xhaminë, falja e namazit të taravive është bërë me ndërrime, është kënduar mukabele dhe çdo ditë janë mbajtur ligjëratat e rregullta. Myftiu i Beogradit shpesh është angazhuar në dhënien e fetvave (shpjegimeve), mbajtjen e vaizëve, pjesëmarrjen në akademi të përfaqësuesve diplomatik dhe ambasadave të shteteve të huaja, të akredituara në Beograd.<sup>3</sup>

Sa i përket numrit të xhamive në Beograd, vështirë mund të dihet numri i saktë i tyre. Shënimet e udhëpërshkruesve janë mjaftë kontroverse njëri me tjetrin, po ashtu ka edhe pak burime arkivore. Mirëpo, Beogradi kishte një numër të madh të xhamive, mesxhideve, teqeve dhe të objekteve të tjera të kulturës islame.

Pas pushtimit të Budimit më 1541 nga osmanët, kur Beogradi nuk ishte më qytezë kufitare filloi ndërtimi më të madhe i xhamive. Në vitin 1560, Beogradi kishte 16 xhami, nga të cilat 10 në qytezë dhe 6 në kala.<sup>4</sup> Në shek. XVI dhe XVII vazhdon ndërtimi i xhamive të reja. Në vitin 1673, Hans Kunc në udhëpërshkrimet e tija shkruan se në Beograd kishte 30 ose 40 xhami turke, të mbuluara me plumb.<sup>5</sup> Në vitin 1688, në Beograd kishte 51 xhami. Në fund të shek. XII dhe në fillim të shek. XVIII janë ndërtuar edhe 4 xhami dhe 22 mesxhide. Pra, në Beograd gjatë sundimit osman, sipas

këtij burimi, kishte më se 50 xhami, ndërsa sot është vetëm një.<sup>6</sup> Mirëpo, sipas Evlija Çelebiut, (shek. XVII) shkruan se në Beograd kishte 270 xhami. Hazim Shabanoviq, thekson se ky numër është i ekzagjeruar, dhe se në Beograd kishte rreth 80 xhami. Çelebiu përmend me emër 30 xhami në të cilat falej namazi i xhomasë në atë kohë.<sup>7</sup>

Në vitin 1573, një prej udhëpërshkruesve të njohur të asaj kohe, Shtefan Gerlih, flet për Beogradin i cili që atëherë e merr pamjen e qytetës orientale. Në të, autori, udhëpërshkruesi në gjuhën gjermane sheh shumë “kisha turke”, siç zakonisht quheshin xhamitë.<sup>8</sup>

Udhëpërshkruesi anglez Peter Mond, në punimin e tij “*Udhëtimi në Evropë 1608-1667*”, në mes të tjerash, shkruan se në vitin 1620, Anglia e dërgoi në Portë ambasadorin e ri Xhon Ersin, ndërsa Pol Pinder, ambasador i deritanishëm, largohet nga Stambolli dhe nisjet në drejtim të Beogradit me shoqërues të shumtë dhe me bashkëpunëtorë, që ishin 56 persona. Në mesin e atyre personave ishte edhe Peter Mandi. Ky përshkruan rrugën nëpër të cilën ka kaluar Pinderi. Më 1 qershor 1620, kishte arritur në Beograd. E përshkruan gjerësisht pozitën e qytetit, popullatën etj.. Për kalanë e qytetit thotë se ishte një qytet i tërë, me xhami, me banja, me sahat etj.. Në këtë kala banonin vetëm “turqit”. Beogradi kishte 2.000 familje, nga të cilat 60-70 ishin hebrenj, e të tjerat myslimane dhe krishtere.<sup>9</sup>

Udhëpërshkruesi i madh osman, Evlija Çelebiu, kishte qëndruar në Beograd në vitin 1660 dhe e përshkruan atë dhe shënon se në Beograd ka 270 xhami, 12 mesxhide, 7 hamame, 3 tyrbe, 160 saraje, 6 karavan-saraje, 21 hane dhe një han i imaretit, çezmat (26), sebilhane për ujë (600), dhomat e beqarëve (7), banjat publike (7), shëtitoret, kishat, varrezat, çarshinë dhe tregun, jep të dhëna edhe për popullsinë, gjuhën

Në Beograd ka ekzistuar musala ose namazgjahu. Këtu myslimanët gjatë periudhës së verës, të premtën dhe ditën e Bajramit, janë falur në musalë – namazgjah. Ky ishte një vend i hapur, rrethuar me minare dhe mihrib.

etj..<sup>10</sup> Në këtë kohë, sipas Çelebiut, Beogradi kishte 98.000 banorë, nga të cilët vetëm 21.000 nuk ishin myslimanë.

Shoqëria mjekësore e Londrës në vitin 1669 e dërgon mjekun Eduard Braun për në Lindje. Ai në Beograd shënon një kala të madhe dhe një qytezë të madhe tregtare, si dhe jep të dhëna të tjera për Beogradin. Përkitazi me xhamitë ai shkruan: “*Majat e minareve janë në qindra xhami, të cilat Beogradi i ka pasur, sipas Haxhi Kallfës në shek. XVII, banjën e mrekullueshme dhe objekte të tjera monumentale...*”<sup>11</sup>

Në Beograd ka ekzistuar musala ose namazgjahu. Këtu myslimanët gjatë periudhës së verës, të premtën dhe ditën e Bajramit, janë falur në musalë – namazgjah. Ky ishte një vend i hapur, rrethuar me minare dhe mihrib. Sipas musalës është quajtur mëhalla dhe xhamia më e afërt.<sup>12</sup>


Sipas një nënkoloneli austriak, në viti 1777 në Beograd kishte rreth 1.200 serbë, 200 shtëpi jevreje, gati 20.000 turq, nga të cilët 4.000 jeniqerë.<sup>13</sup>

Pas vitit 1783, në lagjet e Beogradit kishte 6.000 shtëpi “turke”<sup>14</sup> dhe 800 shtëpi serbe, ose 5200 familje “turke” me rreth 31.260 banorë dhe 600 familje me 5.600 banorë serbë. Pra, kishte rreth 35.160 banorë.<sup>15</sup> Në Beograd, më

1794 ka rënë murtaja dhe kanë pësuar 4.494 banorë.<sup>16</sup>

Në vitin 1862, Beogradi kishte 2.328 ndërtesa dhe shtëpi, nga të cilat 842 serbe dhe gati dyfish shtëpi myslimane, 1.486. Në vitin 1862, pas një rrëmuje, në Beograd, popullata myslimane ka ikur në kalanë e Beogradit, ku u vendosën rreth 600 myslimanë. Më pastaj, më 13 shtator 1862, banorët myslimanë fillojnë me të madhe të shpërngulen, e kjo vazhdon dhe pak vite, sepse pushteti serb kishte dhënë këtë

urdhër që: “Myslimanët e Serbisë mund të mbesin në vatrat e tyre, që t’i mbajnë të gjitha të mirat, por me këto kushte: që të kthehen në fenë e stërgjyshërve, e nëse këtë nuk e dëshirojnë, atëherë mund të jenë serbë me fe myslimane dhe nëse as këtë nuk e duan, atëherë mund të regjistrohen si romë, po nëse as këtë nuk e dëshirojnë, atëherë duhet të shpërngulen nga Serbia”<sup>17</sup>



Beogradi në vitin 1788 (në bakër)



“Bajrakli Xhamia” në Beograd

Në planin urbanistik të Beogradit në fund të shekullit XVIII janë shënuar 40 rrugë, siç janë: “Rruga e shqiptarëve” (“Arnautska ulica”), “Jahja – rruga e Pashës”, “Rruga e Çaushit”, “Rruga e Muftisë”, “Rruga e Deli Hasanit”, “Rruga e Xhamisë së Re” (Nova džamijska ulica), “Kulla e Stambollit” (“Cari-gradska kula”), “Rruga e Bajrakut” (“Bajrak ulica”) etj.<sup>18</sup> Edhe mëhallët janë quajtur sipas veçorive të popullatës, si ajo shqiptare, greke, hebraike, cincare etj..

Sipas një rekonstrukcioni letrar për gjendjen nga kalimi shek. XVIII në atë XIX: “*Beogradi i atëhershëm ishte i ndarë në mëhallë të ndryshme - turke, krishtere, jevreje dhe mëhallën rome. Ato njëra prej tjetrës ishte e ndarë me rrugë të ngushta dhe të shtrembra, të cilat zakonisht ishin të rrethuara me mure të larta. Tërë ana turke është ndarë në 15-16 xhemate-lokalitet-mëhallë, dhe secili xhematë e kishte xhaminë e vetë, myezinin-hoxhën, varret e veta të xhamia dhe çashmen e vet. Tërë popullsia e tij përbëhej nga dy e treta turke dhe një e treta jo e plotë përbëhej nga të krishterët, jevrejët dhe romët. Në atë kohë kishte vetëm disa rrugë dhe dyqane... Pjesët më të rëndësishme ishin Dorqolli, Bit-pazari dhe rruga e Stambollit...*”<sup>19</sup>


Menjëherë pas kryengritjes së parë serbe, më 1804, filloi rrënimi i xhamive dhe objekteve të tjera të kulturës islame në Beograd dhe treva të tjera të Pashallëkut të

Beogradit. Njëherësh filluan edhe vrasjet dhe dhuna ndaj popullatës myslimane dhe rrënimi i objekteve të trashëgimisë të kulturës islame.

Në një letër, udhëpërshkruesi serb, Petar Zh. Petroviq, letra XX, datë 5 qershor 1808, për Beogradin shkruan se është qytezë e madhe, ndërmjet Savës dhe Danubit, që ia japin një bukuri të veçantë... Ka shumë xhami turke nga guri. Minaret ngrihen mbi to. Shihen nga larg dhe jo pak e zbukurojnë vetë qytetin. Vetëm në njërën prej tyre “turqit” kryejnë lutjet fetare, ndërsa të tjerat janë të shkreta. Disa prej tyre janë shndërruar në dyqane tregtare, ndërsa në të tjera, siç i kishin treguar atij, kullotnin derrat. Sipas këtij udhëpërshkruesi, në Beograd ka mjaft turq, që jetojnë në varfëri të madhe dhe mjerim. Mjerim është që të shihen ata, atyre kurrë nuk sheh fytyra të qeshura.<sup>20</sup> Në kështjellën e epërme të Beogradit është xhamia me arkitekturë të bukur, e cila nga gjatësia është mjaft e madhe, por brenda nuk ka asgjë.<sup>21</sup>

Felix Kanitz, udhëpërshkruesi, arkeologu, gazetari dhe ilustratori austriak, duke vizituar Beogradin, shënon se në vitin 1861 kishte 15 minare. Në vitin 1887, kur e viziton herën tjetër Beogradin pohon se nga 15 xhami e ka gjetur Bajrakli Xhaminë. Më pastaj thekson se në Beograd ka ekzistuar Batal Xhamia, një ndër ndërtesat më madhështore dhe më të bukura në “Vilajetin serb”. Ai e përshkruan

“Batall Xhamia” në Beograd, e rrënuar rreth vitit 1869, në vend të saj është ndërtuar ndërtesa e Kuvendit të Serbisë.



Batall Xhamia në Beograd, e rrënuar rreth vitit 1869, në vend të saj është ndërtuar ndërtesa e Kuvendit të Serbisë.

Shumë raportues të huaj kanë raportuar: “Shumë pak ka popuj në botë që kanë pasur fatin tragjik sikurse myslimanët e Serbisë. Ata, sikurse Hazari, janë humbur me tërë bastionin e tyre, me tërë atë që e kanë pasur, sikurse kurrë mos të ekzistonin.

xhaminë dhe rrënimin e saj në vitin 1869 dhe në vend të saj ndërtohet ndërtesa e Kuvendit të Serbisë.<sup>22</sup>

Nikolla Llazro, raportuesi special për *Illustrazione Italiana*, gjatë luftës në vitin 1876 thotë: “Në Beograd gjendën edhe dy xhami myslimane: njëra e mbyllur me dyer të murosura, e tjetra e hapur, madje edhe gjatë kohës së luftës pasardhësit e profetizuar, të lindur në Beograd kanë vazhduar kryerjen e ceremonive të pastrimit dhe të lutjeve.”<sup>23</sup> Më vonë, në Beograd, kishte mbetur vetëm një xhami, Bajrakli Xhamia, të tjerat të gjitha ishin rrënuar.

Me dëbimin e myslimanëve nga Pashallëku i Beogradit, nga ata janë marrë 5 milionë hektarë tokë punuese, e cila u është ndarë serbëve, pastaj rreth 100.000 objekte ndërtime (shtëpi, dyqane etj.). Janë shkatërruar ose janë rrënuar rreth 600 objekte dhe janë plaçkitur rreth 300.000 frymë të bagëtive etj.. Shumë raportues të huaj kanë

raportuar: “Shumë pak ka popuj në botë që kanë pasur fatin tragjik sikurse myslimanët e Serbisë. Ata, sikurse Hazari, janë humbur me tërë bastionin e tyre, me tërë atë që e kanë pasur, sikurse kurrë mos të ekzistonin. Është krijuar shkatërrimi frontal e gjithë asaj që ka ngjarë me islamin dhe me turqit.” Me ndryshimin e popullatës në Serbi, ka filluar edhe procesi i ndryshimit të jetës, zakoneve jetësore dhe shprehive të mëparshme...<sup>24</sup>

- 1 Gliša Elezović, Turski spomenici I-II, Beograd, 1940; G. Elezovic, Iz putovanja Evlije Čelebije, ICSAN I, 1-2, 1948; Prilog proučavanju starog Beograda - Bajrakli Džamija (pdfslide.net)
- 2 Hamdija Jusufspahić, Istočna diaspora, Glasnik, VIS u SFRJ, god. XLII, Sarajevo, januar-februar 1979, f. 290.
- 3 Po aty, f. 291.
- 4 Olga Zirojević, Rajnhold Lubeau o Beogradu i Srbiji 1587 godine, Godisnjak grada Beograda XIII, Beograd 1966, f. 49–63.
- 5 Hans Kunitz, Türckhische Reiß-Beschreibung 1673–1674 Ms. Halle. U: Михаил П. Йонов, Немски и австријски пътеписи за балканите XVII – средата на XVIII в., София 1986, f. 158.
- 6 Djurić – Zamalo, D. (1964-1965). Prilozi poznavanju beogradski Džamija. Prilozi za orientalnu filologiju, 14-15, f. 123-140.
- 7 Hamdija Jusufspahić, Istočna diaspora, Glasnik, VIS u SFRJ, god. XLII, Sarajevo, januar-februar 1979, f. 290.
- 8 Svetlana Strugarević (Master rad) Džamije iz prošlosti Beograda, Filoloski fakultet Univerziteta u Beogradu, Beograd 2014, f. 15.
- 9 Peter Mundy: The Travels of Peter Mundy in Europe and Asia, 1608-1667. Vol. I. Travels in Europe, 1608-1628, Cambridge, 1907; Zdenka Levantat, Britanski putnici u našim krajevima od sredine XV veka do početka XIX veka, Gornji Milanovac, 1989, f. 80.
- 10 Evlija Čelebi, Putopis, Sarajevo, 1957, f. 75-94.
- 11 Feliks Kanic, Srbija – Zemlja i stanovništvo, lib. 1, v. e c. f. 25.
- 12 Aleksander Fotić, Devet priloga istorije turskog Beograda, Godišnjak grada Beograda XXXVIII – 1991, f. 104.
- 13 S. Vinaver, Tursko stanovništvo u Srbiji za vreme Prvog srpskog ustanka, Istorijski glasnik 2 (1955), 43; Jovana Šaljić Raković, Iz turskog vaktu u novo doba, Mislmansko stanovništvo Srbije 1968-1912, Beograd, 2020, f. 18.
- 14 Meqë autori popullatën myslimane e quan turke, ndonëse aty kishte edhe të nacionaliteteve të tjera, si: shqiptare, rome, boshnjake etj., fjalën turke e kam futur në thonjëza.
- 15 T. P. Vukanović, Naselja u Srbiji u doba prvog srpskog ustanka..., p.i c., f. f. 87.
- 16 Tih. R. Djordjević, Iz Srbije, knjaza Miloša, Stanovništvo i naselja, Beograd, 1924, f. 277.
- 17 Po aty.
- 18 Tatimir P. Vukanović, Naselja u Srbiji u doba prvog srpskog ustanka 1804-1813, Vranjski Glasnik, knj. XI, Vranje, 1975, f. 86.
- 19 Vladimir Stojančević, Gradovi, varoši, palanke i trzista pred srpski ustanak 1804. godine, Kulturna istorijska problematika, Gradska kultura na Balkani (XV-XIX vek), Zbornik radova, SANU, Balkanološki institut, Beograd, 1984, f. 152.
- 20 Petar Ž. Petrović, Putovanja po južnoslovenskim zemljama u XIX veku, Beograd, 1934, f. 18.
- 21 Po aty, f. 13.
- 22 Feliks Kanic, Srbija – zemlja i stanovništvo od rimskog doba do kraja XIX veka, Prva Knjiga, Beograd, 1985, f. 73-74.
- 23 Србија током рата 1876. године. Београд: Откровење, јан. 2006, N. Lazaro, f. 12; Svetlana Strugarević, Svetlana Strugarević, (Master rad) Džamije iz prošlosti Beograda, Filoloski fakultet Univerziteta u Beogradu, Beograd 2014, f. 16.
- 24 <https://forum.klix.ba/progon-muslimana-srbije-1830-1867-godine-t103457.html>. Qasja 2 tetor 2020.

# Hamami islam i shekullit XII, i cili u zbulua në lokalin e Tapas-it në Sevilje të Spanjës

*Hamami u zbulua në një bar të njohur për tapas, në zemër të Seviljes.*

*Fotografia nga: Paco Puentes – El Pais*

**MOTIVE GJEOMETRIKE  
VEZULLUESE QË DATOJNË NGA  
KALIFATI ALMOHAD U  
ZBULUAN GJATË RINOVIMIT TË  
LOKALIT TË QYTETIT**

Një hamam islam, i dekoruar në mënyrë madhështore, që i përket shekullit XII, i mbushur plot me motive gjeometrike të shndritshme dhe me tavan (kube) në formën e yjeve me tetë cepa, është shfaqur, paksa si në mënyrë të pamundur, në muret dhe tavanet e harkuar të një bari të njohur për tapas në zemër të qytetit të Seviljes, në jug të Spanjës.

Në verën e vitit 2020, pronarët e barit Cervercería Giralda, në të cilin janë përgatitur *cañas* dhe *copas* pranë katedrales së Seviljes që nga viti 1923, vendosën që të përfitojnë nga punimet në rrugët e asaj zone dhe nga pandemia e koronavirusit për të nisur një rinovim të vonuar prej kohësh.

Ndonëse legjenda lokale dhe një dokument historik i çuditshëm thonë se ai vend mund të ketë qenë dikur një hamam i lashtë, shumë prej njerëzve pretendojnë se pamja retro e

Një hamam islam, i dekoruar në mënyrë madhështore, që i përket shekullit XII, i mbushur plot me motive gjeometrike të shndritshme.



“Giralda” shkon deri në periudhën e stilit *neomudéjar*, ose stilin e ringjalljes islame, mbi të cilin arkitekti Vicente Traver ndërtoi barin dhe hotelin në fillim të viteve 1920.

“Flitet se këtu ka pasur hamame, por jo të gjithë historianët janë të bindur për këtë dhe bile disa menduan se është shumë më e vonshme”, tha Antonio Castro, njëri nga katër bashkëpronarët e “Giralda-s”. Ai shton dhe thotë se: “Ne po bënim disa punime dhe morëm një arkeolog, dhe kështu u zbuluan hamamet (banjat).”





*Hamami i zbuluar në Sevilje. Fotografia: Álvaro Jiménez*

Arkeologu, Álvaro Jiménez, i dinte këto thashetheme. Por, si shumë të tjerë, edhe ai i kishte imagjinuar gjithmonë si diçka të çuditshme. Megjithatë, ishte pikërisht në një ditë gjatë korrikut të vitit 2020, gjatë kohës që ekipi po çante butësisht suvanë që mbulonte tavanin, kur zbuluan një dritare xhami në formën e një ylli me tetë cepa.

“Sapo pamë njërën nga ato vrima në çati, e kuptuam se çfarë ishte, thjesht nuk mund të ishte gjë tjetër veçse një hamam” – tha Jiménez, duke shtuar se: “Ne duhej vetëm të ndiqnim motivet e atyre penxhereve.”

Zbulimet e tyre shpejt zbuluan një pjesë të shkëlqyer dhe elegante të dizajnit, i cili daton që në shekullin XII, kur kalifati Almohad sundonte pjesën më të madhe të asaj që sot janë Spanja dhe Portugalia, si dhe një pjesë të madhe të Afrikës së Veriut.

“Në aspektin dekorativ, këto hamame kanë sasinë më të madhe të dekorimit të ruajtur nga çdo hamam i njohur në Gadishullin Iberik” – tha arkeologu.

“Në mënyrë absolute çdo gjë këtu është e dekoruar dhe, fatmirësisht, ka mbijetuar. Sfondi është llaç me gëlqere të bardhë i gdhendur me vija, rrathë dhe katrorë gjeometrikë. Në majën e saj gjenden piktura me okër të kuqe të yjeve me tetë cepa dhe rozeta me tetë petale me shumë fletë. Këto dy dizajnë përputhen, ndërthuren dhe përshtaten me format e ndryshme gjeometrike të vrimave të kupolës.”

Ndërkohë që shumë prej gëlqeres duhet ende të pastrohet për të zbuluar bojën e kuqe poshtë saj, bar-hamami tani është ruajtur dhe meremetuar dhe “Giralda” do të hapet sërish pas dy ose tre javësh.

Jiménez, i cili përshkroi “llojin e një radhitjeje fatale të gjërave të ndryshme”, tha se hamami dhe lokali “kanë rilindur dhe janë bërë diçka e mrekullueshme, ishin njerëzit e duhur, koha e duhur dhe pak fat”.



*Detaje dhe dekorim i pambuluar. Fotografia: Álvaro Jiménez*



Castro dhe ortakët e tij mezi presin që të shohin një kapitull të ri në historinë e gjatë të “Giraldes”. Ata theksojnë gjithashtu largpamësinë e Vicente Traver.

“Ky ishte një bar mjaft i njohur më parë, por tani njerëzit do të mund të hyjnë dhe të pinë diçka në një bar që është gjithashtu një hamam i shekullit XII,” tha Castro. “Është një gjë e mirë që arkitekti në vitet 1920 i ka respektuar hamamet, të tjerë mund të kishin hequr çdo gjë, kështu që ne i jemi mirënjohës atij.”

*Përktheu nga gjuha angleze: Ermal BEGA*

*Marrë nga faqja: <https://www.theguardian.com/world/2021/feb/18/islamic-12th-century-bathhouse-uncovered-in-seville-tapas-bar>*

# Koncepti i përgjithshëm fetar në shtetin osman dhe raporti fetar në trevat shqiptare 1800-1912

## HYRJE

Koncepti i përgjithshëm i fesë në shtetin osman ka bazën mbi parimet islame dhe bashkëjetesën e përbashkët brenda sistemit shtetëror osman. Parimet e saj mbështeteshin në sheriatin islam, megjithatë rol të rëndësishëm kishte edhe urfi turk (e drejta zakonore turke). Megjithatë këto parime të sheriatis dhe urfit nuk dëmtojnë kulturën e popujve të tjerë, përkundrazi në aspektin kulturor, u bënë shkëmbime të rëndësishme sa i përket kulturave të ndërsjella. Kjo i mundësoi popujve, e në veçanti edhe popullit shqiptar, që të kishte liri në aspektin e kultivimit dhe ruajtjes së kulturës shqiptare brenda limit të arealit sheriatis, ku lejimi i veprimtarisë kulturore për të gjithë popujt vlente deri në momentin që nuk dilnin nga përkufizimi i përgjithshëm i ligjeve sheriatiske. Kjo bëri që kulturat e ndryshme të adaptonin dhe të zhvillonin edhe më tutje vlerat e tyre

kulturore, por edhe të përfaqonin konceptin fetar osman, kryesisht në veprimtarinë e shkollës juridike, asaj hanefite.

## KONCEPTI I PËRGJITHSHËM FETAR NË SHTETIN OSMAN

Shteti osman ishte një shtet që bazohej në parimin e sheriatis islam dhe urfit turk. Ndërlidhja mes sheriatis islam dhe urfit turk, bëri që të kemi një pikëpamje të “*sheriatis urfik*”, duke u ndërlidhur aspekti i përbashkët i fesë dhe traditës. Në aspektin e sheriatis, burimi kryesor ishte Kurani dhe Suneti i Profetit Muhamed. Në anën tjetër, urfi bazohej në traditën turke, që shpeshherë nga sulltanët osmanë shpallëshin Kanunnamet, duke u shënuar edhe ligjet e tyre që bazoheshin në sheriatis dhe urf (traditë). Megjithatë, ndikimi i sekteve fetare bëri që osmanët të gjenin një gjuhë të përbashkët të unifikimit islam, pasi që lufta mes sekteve fetare ishte e madhe. Ky unifikim erdhi përmes zbatimit të politikave osmane “për shtetin”.

Osmanët sollën mësimin e shkollës juridike hanefite, në bazë të mësimave të Imam Ebu Hanifes,<sup>1</sup> i njohur ndryshe si Imam Azami. Kështu osmanët sollën në Ballkan mësimin e shkollës hanefite. Megjithatë të ishte pjesë e shkollës hanefite, ishte më shumë lojalitetet dhe pasim në aspektin juridik të zbatimit të normave juridike sipas metodologjisë hanefite, ndërsa në aspekt të doktrinës spiritualiste osmanët zbatuan politikën e bashkimit të sekteve fetare, ku një pjesë e sulltanëve ishin pjesë e ndonjë sekti sufi, kryesisht nakshebendi.

Osmanët instaluan një islam për bashkimin dhe jetën e përbashkët pa probleme. Shembull për të pasur një jetë të



përbashkët të tri feve në Jerusalem, u hodh parimi: La ilahe – il Allah, Ibrahim halilullah (Allahu është një, Ibrahim është i dashuri i Zotit). Kështu qëllimi te osmanët nuk ishte të instalohej sistemi i cili shtypte masën, por për të gjetur një zgjidhje të problemit, ku morën si model Ibrahimin (profet), pasi që tri fetë pajtohen në profecinë e tij.

### ÇËSHTJA FETARE NË TREVAT SHQIPTARE 1800-1912

Në shoqërinë osmane ekzistonin dy grupe: shoqëria myslimane dhe jomuslimane.<sup>2</sup> Ajo çka e konceptonte milletin tek osmanët ishte feja.<sup>3</sup> Gjatë viteve 1800-1912, popullsia shqiptare ishte e ndarë në tri besime: mysliman, katolik dhe ortodoks. Pasi kishte kaluar procesin e islamizimit, pjesa dërmuese e popullsisë në trojet shqiptare ishte myslimane. Ndarja në tri fe, shënoi edhe ndarjen në tri kultura dhe tri besime. Pavarësisht se sundimi në trojet shqiptare i takonte osmanëve, ndarja në tri fe, i ndante edhe politikisht qytetarët. Myslimanët ishin të lidhur me osmanët, ortodoksët me patrikanën dhe katolikët me papatin. Kështu që me një anë ata vareshin nga tre institucione, pasi që besimi i tyre ishte i lidhur edhe me aspektin politik.<sup>4</sup> Sipas Gazmend Shpuzes, kjo “ndikoi që të lind problemi i konsolidimit të kombit të shqiptarët”.<sup>5</sup>

Në bazë të statistikave, në vilajetin e Kosovës gjatë vitit 1880, ishin 279 mijë shqiptarë myslimanë dhe 15 mijë katolikë.<sup>6</sup> Jeta e përbashkët e myslimanëve dhe jomuslimanëve në vilajetet shqiptare, kalonte edhe në trazira, kryesisht mes fiseve (shembull Gjakovë 1889<sup>7</sup>), megjithatë shpeshherë shohim që kishte raporte bashkëjetese. Janë të gabuara pohimet se toleranca fetare dallohet vetëm te shqiptarët në shtetin osman. Ishte shteti

Gjatë viteve 1800-1912, popullsia shqiptare ishte e ndarë në tri besime: mysliman, katolik dhe ortodoks. Pasi kishte kaluar procesin e islamizimit, pjesa dërmuese e popullsisë në trojet shqiptare ishte myslimane.

osman ai që e nxiste tolerancën fetare. Shembulli i saj ishte në Jerusalem, ku kemi një lulëzim të tolerancës fetare (mysliman, katolik dhe jahudi). Në raportin e konsullit anglez R.Stuart, më 16 prill 1867 në Janinë, theksohet se: “Përvoja ime, që kam mbi këtë vend, nuk vërteton fjalët që myslimanët (fjala për myslimanët shqiptarë, A.K), mbajnë qëndrime barbare ndaj popullsisë së besimit katolik (fjala për katolikët shqiptarë, A.K). Nuk e besoj se ata bëjnë vazhdimisht veprime jo të mira ndaj tyre (...). Këto janë ankesa shpifëse dhe shtirjeje. Është vetë populli i besimit të krishterë, i cili thërret për të tërhequr vëmendjen ndaj pretendimeve që ata ngrenë here pas here dhe mbase për të zgjuar urrejtje ndaj armiqve.”<sup>8</sup>

Problemet fetare i shohim edhe në qytetin e Ferizajt në vitin 1909, ku nacionalizmi serb, i ngritur mbi ortodoksinë sllave, mundohet të krijoj trazira në qytet. Dokumenti arkivor thekson se: “Nuk është e përshtatshme dhe patjetër që do të bëhet shkak i zhvillimeve të pa dëshiruara, ndërhyrja në punët shpirtërore dhe në ceremonitë fetare të popullsisë serbe, të priftit ortodoks që gjendet në nahinë e Ferizajt, që varet nga Prishtina. Të bëhet eliminimi i shqetësimit të popullsisë duke e dërguar andej nga ka ardhur këtë prift që nuk është nga popullsia e zonës.”<sup>9</sup> Kështu që nxitja e urrejtjes fetare, e ortodoksizmit serb, për t’i përçarë shqiptarët, ishte nga politikat serbe të kohës.

Në bazë të dokumenteve arkivore, gjatë vitit 1878-1879, ekzistonin këto institucione fetare në vilajetin e Kosovës:

**Tabela nr.1:** Institucionet fetare të vilajetit të Kosovës 1878-1879.<sup>10</sup>

**Tabela nr.2:** Institucionet fetare të vilajetit të Kosovës 1896-1897.<sup>11</sup>

|                                 |            |           |           |            |
|---------------------------------|------------|-----------|-----------|------------|
| <b>Sanxhaku i Prishtinës</b>    | 32 xhami   | 2 teqe    | 3 kisha   | 1 sinagogë |
| <b>Sanxhaku i Shkupit</b>       | 55 xhami   | 11 teqe   | 3 kisha   | 1 sinagogë |
| <b>Sanxhaku i Prizrenit</b>     | 75 xhami   | 11 teqe   | 3 kisha   |            |
| <b>Sanxhaku i Dibrës</b>        | 36 xhami   |           |           |            |
| <b>Sanxhaku i Pazarit të ri</b> | 51 xhami   | 1 teqe    | 27 kisha  |            |
| <b>TOTALI:</b>                  | <b>249</b> | <b>25</b> | <b>36</b> | <b>2</b>   |

|                                 |            |             |           |           |            |
|---------------------------------|------------|-------------|-----------|-----------|------------|
| <b>Sanxhaku i Prishtinës</b>    | 48 xhami   | 13 mesxhide | 1 teqe    | 3 kisha   |            |
| <b>Sanxhaku i Shkupit</b>       | 108 xhami  | 17 mesxhide | 31 teqe   | 29 kisha  | 2 sinagoga |
| <b>Sanxhaku i Prizrenit</b>     | 56 xhami   | 2 mesxhide  | 9 teqe    | 4 kisha   |            |
| <b>Sanxhaku i Tashllëxhës</b>   | 16 xhami   |             |           | 10 kisha  |            |
| <b>Sanxhaku i Pazarit të ri</b> | 51 xhami   |             |           | 16 kisha  |            |
| <b>Sanxhaku i Pejës</b>         | 60 xhami   |             |           | 12 kisha  |            |
| <b>TOTALI:</b>                  | <b>339</b> | <b>32</b>   | <b>41</b> | <b>74</b> | <b>2</b>   |



Përpos xhamive që ndërtoheshin nga osmanët, shohim edhe ndërtimin e xhamive nga masa popullore, ku duhej marrë leje nga sulltani. Kjo shihet te popullsia e Navaricës në Delvinë, ku “sulltani jep lejen përkatëse që banorët e lagjes Navaricë të kasabasë së Delvinës, që e kanë shumë të vështirë çështjen e faljes së namazit të xhumasë pasi që nuk kanë xhami në lagje, të ndërtojnë një xhami me mundësitë e tyre ekonomike dhe të falin namazin e xhumasë në të.”<sup>12</sup>

Kështu jeta fetare në trojet shqiptare ishte e kontrolluar nga qendra (Stambolli), dhe shqiptarët ishin pjesë e bashkëjetesës fetare të krijuar nga osmanët. Feja kishte rol të madh në shoqërinë shqiptare. Në aspektin e fesë islame ata i qëndronin besnikë parimeve të shehulislamit dhe fetvave të tij, njëkohësisht ishin të lidhur pas sulltanit, i cili qëndronte në fron dhe udhëhiqte kalifatit islam. E njëjta besnikëri ishte edhe nga ana e shoqërisë shqiptare katolike dhe ortodokse, ku ruanin besnikërinë politike dhe fetare ndaj prijësve të tyre fetar.

## PËRFUNDIM

Nga rrethanat e përgjithshme të fesë në shtetit osman dhe fesë në trevat shqiptare gjatë viteve 1800-1912, specifikojmë se popullsia shqiptare ishte e ndarë në tri besime: mysliman, katolik dhe ortodoks. Në esencë, shteti osman e ndante shoqërinë në dy grupe: mysliman dhe jomysliman. Kjo ndarje kishte të bëjë me miletin si koncept. Nuk kishte milet etnik, por milet fetar. Shqiptarët gjatë kësaj periudhe i takuan në numër më të madh fesë islame. Në katër vilajetet shqiptare dominonte feja islame.

1. Ebu Hanife Numan ibën Thabit ibën Zeuta ibën Mazuban, rreth (699 – 767) i njohur si Ebu Hanife ose Imam Ebu Hanife. Ai ishte një teolog dhe jurist mysliman sunit i shekullit VIII me prejardhje persiane, i cili u bë themeluesi me të njëjtin emër i shkollës së jurisprudencës sunite hanefite, e cila është shkolla juridike më e praktikuar në traditën sunite, gjithashtu e përhapur pos viseve të tjera myslimane, ajo ka gjetur shtrirje edhe në rajonin e Ballkanit.

2. Mucize Ünlü, *Vilajeti i Kosovës 1877-1912*, (Tiranë: Dituria, 2023), 86.

3. Justin M. Carthy, *Popujt osmanë dhe fundi i perandorisë*, Tiranë: Alsar, 2017, 61.

4. Aleks Buda., et. al. *Historia e Popullit Shqiptar II, Rilindja Kombëtare vitet 30 të shek. XIX – 1912*. Tiranë: Toena, 2002, 27.

5. Ünlü, *Vilajeti i Kosovës*, 100.

6. Oliver Jens Schmitt, *Kosova histori e shkurtër e një treve qendrore ballkanike*, (Prishtinë: Koha, 2012), 121.

7. Ünlü, *Vilajeti i Kosovës*, 91.

8. Ünlü, *Vilajeti i Kosovës*, 88-89.

9. BOA. TFR. I. KV, 217/21620, 1 mars 1909. Cituar nga: Ibrahim Gashi dhe Ayten Ardel, *Ferizaj në dokumentet osmane*, (Ferizaj: Intergraf, 2024), 37.

10. Ünlü, *Vilajeti i Kosovës*, 118-119.

11. Ünlü, *Vilajeti i Kosovës*, 120-121.

12. BOA. Ali Emiri, IV. Mehmed, 8536, Evâil-i Ra. Sene [10]86 / [26 Mayis - 5 Haziran 1675]. Cituar nga: Osmanli Arşiv belgelerinde Arnavutluk, 353.

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM KRYEMINISTRIN E KOSOVËS, Z. ALBIN KURTI



Më 31 dhjetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim kryeministrin e Republikës së Kosovës, z. Albin Kurti, i cili shoqërohej nga ministrja e Drejtësisë, znj. Albulena Haxhiu dhe nga ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Hajrulla Çeku.

Gjatë këtij takimi, Myftiu Tërnavë dhe kryeministri Kurti biseduan për tema të ndryshme, përfshirë këtu rolin e komuniteteve fetare në forcimin e vlerave shoqërore dhe promovimin e

tolerancës ndërfaqetare. Myftiu Tërnavë me këtë rast theksoi rëndësinë e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve për zhvillimin e projekteve të përbashkëta në të mirë të qytetarëve të Kosovës, duke potencuar kështu rolin konstruktiv të Bashkësisë Islame të Kosovës në krijimin e një shoqërie edhe më tolerante.

Myftiu Tërnavë në veçanti u ndal në ruajtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe fetare në Kosovë, ku falënderoi Ministrinë e Kulturës për

renovimin e disa xhamive, si dhe për gatishmërinë për renovimin e pesëmbëdhjetë xhamive të tjera të vjetra.

Nga ana e tij, kryeministri Kurti shprehu mirënjohje për kontributin e Bashkësisë Islame të Kosovës në ruajtjen e harmonisë fetare dhe kombëtare. Ai ritheksoi angazhimin e Qeverisë për të mbështetur të gjitha komunitetet fetare në vend, duke theksuar se bashkëpunimi ndërinstitutional është kyç për ndërtimin e një shoqërie të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM MINISTREN E ARSIMIT, SHKENCËS, TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT, ZNJ. ARBËRIE NAGAVCI

Më 23 dhjetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka pritur në takim ministren e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit, znj. Arbërie Nagavci. Gjatë takimit u diskutua për format dhe mundësitë e bashkëpunimit të mëtejshëm ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës, veçanërisht me institucionet arsimore të saj, dhe Ministrisë së Arsimit, për çka Myftiu Tërnavë falënderoi bashkëpunimin e deritanishëm.

Znj. Nagavci u shpreh e gatshme të vazhdojë përkrahjen dhe mbështetjen e Ministrisë për institucionet arsimore të Bashkësisë Islame të Kosovës, duke treguar respekt dhe nderim të veçantë për këto institucione. Ajo shtoi se



bashkëpunimi dhe koordinimi deri më tani kanë qenë në nivelin e duhur.

shtu, gjatë takimit u diskutua rëndësia dhe kujdesi ndaj institucionit të familjes

në shoqëri, për çka të dyja palët ranë dakord që duhet të bëjnë më shumë për ruajtjen e familjes si institucione.

## MYFTIU TËRNAVA PRITI NË TAKIM AMBASADORIN E SHBA-SË, Z. JEFFREY HOVENIER



Më 10 dhjetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, priti në një takim lamtumirës ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Kosovë, z. Jeffrey Hovenier.

Myftiu Tërnavë fillimisht falënderoi ambasadorin dhe Shtetet e Bashkuara për përkrahjen dhe mbështetjen e vazhdueshme ndaj Kosovës. Ai theksoi se shqiptarët në përgjithësi, dhe populli i Kosovës në veçanti, gjithnjë do të jenë

mirënjohës ndaj SHBA për kontributin e tyre. Më pas, ai falënderoi ambasadorin për bashkëpunimin me Bashkësinë Islame të Kosovës në projekte të ndryshme, duke shprehur gatishmërinë e tij dhe të institucionit të BIK-ut që bashkëpunimi të vazhdojë në të ardhmen.

Ambasadori Hovenier, nga ana e tij, falënderoi Myftiun Tërnavë për pritjen dhe bashkëpunimin me Ambasadën e SHBA. Ai vlerësoi rolin dhe kontributin

e Bashkësisë Islame të Kosovës në kultivimin e vlerave të harmonisë, bashkëjetesës dhe tolerancës ndërfaqetare në vend, si dhe për përçimin e mesazheve për paqe dhe siguri për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Në fund të takimit, Myftiu Tërnavë i uroi ambasadorit Hovenier shëndet dhe mbarësi në jetën e tij, si dhe i dhuroi një dhuratë me motive nga trashëgimia jonë fetare.

## MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA AMBASADORI I ARABISË SAUDITE NË TIRANË, Z. FEISAL HEFZI

Më 11 dhjetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, është pritur në takim nga ambasadori i Arabisë Saudite në Tiranë, njëherësh ambasador jorezident për Kosovën, z. Feisal Hefzi.

Gjatë këtij takimi u diskutua për bashkëpunimin e deritanishëm ndërmjet dy institucioneve, si dhe për format dhe mundësitë e intensifikimit të këtij bashkëpunimi në të ardhmen.

Myftiu Tërnavë shprehu falënderimet e tij për shtetin e Arabisë Saudite për ndihmat dhe përkrahjen e vazhdueshme që ka dhënë për popullin e Kosovës si dhe për Bashkësinë Islame të Kosovës. Ai shprehu gatishmërinë e tij që një bashkëpunim i tillë të vazhdojë edhe në të ardhmen.




## MYFTIU TËRNAVA VIZITOI AMBASADËN E KUVAJTIT NË TIRANË

Më 11 dhjetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, vizitoi Ambasadën e Kuvajtit në Tiranë, në të cilën u mirëprit nga këshilltari, njëherësh zëvendës shefi i misionit, z. Adnan Alguhnaïm.

Myftiu Tërnavë shfrytëzoi rastin që të shpreh falënderimet e tij për shtetin e Kuvajtit për përkrahjen që ka dhënë për Kosovën dhe popullin e saj, duke shprehur kështu një gatishmëri që të vazhdohet bashkëpunimi i mirë ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Ambasadës së Kuvajtit.

Myftiu e falënderoi z. Alguhnaïmin, e përmes tij edhe Ambasadën e Kuvajtit veçanërisht për angazhimin e tyre të pambarim në përkrahje të projekteve të përbashkëta BIK-u, gjithnjë në të mirë të qytetarëve tanë.



## MYFTIU TËRNAVA U PRIT NË TAKIM NGA AMBASADORI I KATARIT, Z. JABOR ALI HUSSEIN AL HAWASHELA AL DOSARI

Më 11 dhjetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, qëndroi për vizitë në Ambasadën e Katarit në Tiranë, në të cilën u mirëprit nga ambasadori z. Jabor Ali Hussein al Hawashela al Dosari.

Gjatë këtij takimi u diskutua për mundësitë e intensifikimit të bashkëpunimit ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Ambasadës së Katarit, për çka Myftiu Tërnavë u shpreh tejet falënderues për ndihmat dhe bashkëpunimin e deritanishëm që kanë pasur ndërmjet vete dy institucionet. Ai edhe njëherë veçanërisht falënderoi ambasadorin Al Dosari dhe përmes tij shtetin e Katarit për ndërtimin e selisë së re të Shoqatës "Bereqeti". Myftiu Tërnavë e vlerësoi si tejet të rëndësishëm edhe bashkë-



punimin e mirë që kanë me Ministrinë e Vakëfeve dhe Çështjeve Fetare të Katarit, si dhe me institucionet dhe organizatat relevante të Katarit, siç është edhe "Qatar Charity".

Ambasadori Al Dosari u shpreh i lumtur me vizitën e Myftiut Tërnavë, si dhe shprehu gatishmërinë e tij të plotë për një vazhdimësi të bashkëpunimit.

## KRYESIA E BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MBAJTI MBLEDHJEN E RREGULLT



Më 14 dhjetor 2024, Kryesia e Bashkësisë Islame të Kosovës, ka mbajtur mbledhjen e saj të rregullt, nën kryesimin e kryetarit të saj, Myftiut Naim ef. Tërnavë.

Gjatë kësaj mbledhje, Myftiu Naim ef. Tërnavë, shfrytëzoi rastin që t'i njoh anëtarët e Kryesisë përkitazi me takimet e tij të fundit, të cilat i ka zhvilluar me ambasadorët e Arabisë Saudite, Katarit dhe të Kuvajtit, duke

theksuar kështu marrëdhëniet e shkëlqyera që kanë mes vete Bashkësia Islame e Kosovës dhe këto vende.

Ai shfrytëzoi rastin që të shpreh edhe njëherë falënderimet e tij për përkrahjen e vazhdueshme që kanë dhënë këto vende për Kosovën dhe Bashkësinë Islame të Kosovës, duke shprehur kështu përkushtimin dhe interesimin e institucionit të BIK-ut për thellim dhe

intensifikimin të bashkëpunimit me këto vende.

Si pikë kryesore të rendit të ditës Kryesia pati parapërgatitjet për mbajtjen e mbledhjes së Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Gjithashtu gjatë kësaj mbledhje u shqyrtuan lëndë të tjera, si dhe u morën vendime në bazë të kompetencave të kësaj Kryesie.

## MYFTIU TËRNAVA MBAJTI TAKIM ME KRYETARËT E KËSHILLAVE TË BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS



Më 16 dhjetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, ka mbajtur një takim me kryetarët e të gjitha Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Takim u hap me leximin e disa ajeteve kuranore, teksa gjatë këtij takimi, u diskutua mbi një sërë çështjesh të rëndësishme, përfshirë gjendjen aktuale të jetës fetare në Kosovë dhe mbarë-

vajtjen e saj. Pjesë e diskutimeve ishin edhe përgatitjet për muajin e shenjtë Ramazan, organizimi i haxhit për vitin e ardhshëm, si dhe vlerësimi i situatës aktuale në vend.

Myftiu Naim ef. Tërnavë vlerësoi kontributin e Këshillave në ruajtjen e unitetit dhe zhvillimin e aktiviteteve fetare në nivel kombëtar. Ai theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të ngushtë

mes Këshillave dhe Kryesisë, për t'u përballur me sfidat aktuale dhe për të përmbushur nevojat shpirtërore të besimtarëve.

Kjo mbledhje shërbeu për angazhimin e Bashkësisë Islame të Kosovës për të adresuar çështje të ndryshme që ballafaqohen me organizmin e jetës fetare dhe iniciativat për të ndihmuar shoqërinë.



## MEDRESEJA “ALAUDDIN” – PARALELJA NË GJILAN SHËNOI 30-VJETORIN E THEMELIT



Më 23 dhjetor 2024, me një ceremoni solemne, është shënuar 30-vjetori i themelimit të paraleles së Medresesë “Alauddin” në Gjilan, një institucion ky në arsimimin dhe edukimin fetar të gjeneratave të këtij rajoni. Medreseja u vlerësua për edukimin e brezave të rinj ndër vite.

Në ceremoni morën pjesë kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, bashkëpunëtorë, drejtuesit e Medresesë në Prishtinë dhe

Prizren, ministria Arbërie Nagavci, kryetari i Gjilanit, z. Alban Hyseni, udhëheqësit e Këshillave të BI-së së Gjilanit dhe të rajonit, si dhe nxënësit e Medresesë.

Myftiu Tërnavë tha se emri i Medresesë bashkëjeton në zemrën e çdo besimtari për shkak të rolit që ka luajtur ajo ndër vite. Drejtori i Medresesë, z. Fadil Hasani, theksoi rëndësinë e themelimit për Gjilanin dhe rajonin. Ministria Nagavci dhe kryetari Hyseni

çmuan edukimin që ofron Medreseja, si në aspektin arsimor ashtu edhe fetar dhe kombëtar.

Në fund, koordinatoresha e Medresesë në Gjilan, znj. Merita Boroci, falënderoi të pranishmit dhe urojti që gjenerata e re të vazhdojë rrugën e hoxhallarëve të vjetër. Programi vazhdoi me pika artistike nga nxënësit, shpërndarjen e mirënjohjeve dhe një dokumentar për historikun e Medresesë në Gjilan.

## DEPARTAMENTI I GRUAS MBAJTI TAKIMIN PËRMBYLLËS TË MUALIMEVE



Më 24 dhjetor 2024, Departamenti i Gruas i Bashkësisë Islame të Kosovës ka mbajtur një takim përmbyllës me mualimet e saj për të vlerësuar punën njëvjeçare të mualimeve të këtij Departamenti.

Në fillim të këtij takimi kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, paraqiti një raport më të zgjeruar të punës dhe aktiviteteve të mualimeve gjatë vitit 2024, duke i përgëzuar ato për

punën, kontributin dhe sukseset e arritura.

Në këtë takim përmbyllës mori pjesë edhe kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i cili në fjalën e tij përgëzoi mualimet për punën dhe angazhimin e tyre në gjithë Kosovën në mësimin e nxënësve dhe grave. Ai tha se këtë mision e kemi amanet nga Zoti i Gjithësisë, dhe duhet ta çojmë në vend, ngase një ditë do të

dalim para Tij dhe do të na paraqiten punët dhe veprat tona. Myftiu Tërnavë gjithashtu shprehu gatishtërinë e tij dhe të institucionit të Bashkësisë Islame të Kosovës që të vazhdojë përkrahjen dhe mbështetjen e mualimeve, duke potencuar faktin se tashmë ju si mualime jeni një ndër paraqitjet më të mira të Bashkësisë Islame të Kosovës.

## MESAZH URIMI PËR IPESHKVIN DODË GJERGJI

*I nderuari ipeshkv, Dodë Gjergji*

*Me nderim e respekt të posaçëm, në këtë ditë të shënuar për besimtarët e krishterë, më lejoni që t'ju drejtohem me mesazh urimi e përgëzimi Ju, meshtarëve tuaj, si dhe të gjithë vëllezërve shqiptarë të besimit të krishterë, duke ju dëshiruar gjithë të mirat, me shëndet, mbarësi e lumturi!*

*Festa e Kërshëndellës është moment i veçantë për besimtarët e krishterë, për t'u kujtuar e festuar, sepse në zanafillën e saj ka jetën, shpresën e mbarësinë.*



*Tashmë dihet, festat fetare te ne janë të shtresuara thellë në identitetin tonë, sikurse besimet tona, dhe si të tilla janë çaste që krijojnë kushte e premisa për*

*reflektim, solidaritet e humanizëm. Po ashtu festat fetare përgjatë historisë sonë kanë përçuar unitet, dashuri, mirëkuptim e harmoni, vlera këto që tashmë e identifikojnë popullin tonë.*

*Zotni Ipeshkv, përmes jush uroj e përgëzoj edhe gjithë prarinë ndërkombëtare katolike në Kosovë!*

*Duke ju përshëndetur, ju dëshiroj shëndet, mbarësi e lumturi!*

*Prishtinë, 24 dhjetor 2024*

*Me respekt,*

*Myftiu i Kosovës,*

*Naim ef. Tërnavë*

## KUVENDI I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS MIRATOI PROJEKTBUXHETIN PËR VITIN 2025



Më 26 dhjetor 2024, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Kosovës mbajti mbledhjen e rregullt të tij, ku pika e vetme e rendit të ditës ishte miratimi i projektbuxhetit për vitin 2025. Mbledhja u hap dhe u kryesua nga nënkryetari i Kuvendit, Rrahim Aliu, teksa fillimisht u recituan disa ajete kuranore që theksuan rëndësinë shpirtërore të mbledhjes.

Gjatë fjalës së tij, Myftiu i Kosovës, Naim ef. Tërnavë, prezantoi disa nga të arriturat e institucionit gjatë vitit që po lëmë pas, duke përfshirë suksese në fushat edukative dhe sociale. Ai vlerësoi kontributin e Fakultetit të Studimeve

Islame dhe Medresesë së Mesme "Alauddin" në edukimin e brezave të rinj, duke theksuar impaktin pozitiv që kanë pasur këto institucione në komunitet.

Gjithashtu, Myftiu nënvizoi progresin në mësim-besim, ndërtimin e xhamive dhe infrastrukturës përcjellëse, duke theksuar rëndësinë e qëndrueshmërisë së zhvillimit urban dhe bashkëkohor të komunitetit. Po ashtu, ai theksoi përgatitjet për muajin Ramazan dhe organizimin e haxhit, duke shprehur përkushtimin e fortë për realizimin me sukses të këtyre aktiviteteve të rëndësishme, të cilat janë thelbësore për

zhvillimin shpirtëror dhe social të anëtarëve të Bashkësisë.

Mbledhja u mbyll me miratimin unanimit të projektbuxhetit nga anëtarët e Kuvendit, pas raportimit të detajuar nga drejtori i Financave, z. Tanseli Rogova, duke përcaktuar kështu prioritetet dhe angazhimet për vitin e ardhshëm. Kjo miratim siguroi burimet financiare të nevojshme për implementimin e projekteve të planifikuara, duke garantuar që Bashkësia të vazhdojë të ofrojë shërbime të cilësisë së lartë për komunitetin.

## U INAUGURUA PROJEKTI “PËRKUJDESJA NDAJ JETIMËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS”

Më 26 dhjetor 2024, para anëtarëve të Kuvendit të Bashkësisë Islame të Kosovës, Bashkësia Islame e Kosovës edhe zyrtarisht ka inauguruar projektin “Përkujdesja ndaj jetimëve të Republikës së Kosovës”, një projekt ky tejet domethënës dhe i organizuar në bashkëpunim me Qendrën e “Mbretit Selman” të Mbretërisë së Arabisë Saudite.

500 fëmijëve jetimë në Kosovë, pa asnjë dallim do t’u dhurohet nga 50 euro për çdo muaj për një vit radhazi.

Kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, falënderoi Qendrën e “Mbretit Selman” të Mbretërisë së Arabisë Saudite për këtë projekt, por edhe për ndihmat e vazhdueshme që kanë dhënë përgjatë viteve për popullin e Kosovës. Ai tha se synimi i tij është që nga viti i ardhshëm

të rritet numri i jetimëve që do të ndihmohen.

Bashkësia Islame e Kosovës përgjatë gjithë vitit, së bashku me Shoqatën

“Bereqeti” pandërprerë ka qenë pranë secilës familje në nevojë, mirëpo ndihma ndaj fëmijëve jetimë zë një vend edhe më të veçantë.



## MYFTIU TËRNAVA QËNDROI PËR VIZITË NË GJAKOVË



Më 30 dhjetor 2024, kryetari i Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiu Naim ef. Tërnavë, i shoqëruar nga bashkëpunëtorët e tij, qëndroi për vizitë në Gjakovë, ku pa për së afërmi Qendrën e Trajnimeve, e cila tashmë së fundi është mobiluar, si rezultat i një bashkëpunimi ndërmjet Bashkësisë Islame të Kosovës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë.

Myftiu Tërnavë edhe me këtë rast falënderoi Drejtorinë e Përgjithshme të Vakëfeve të Turqisë për këtë donacion, duke thënë se tashmë ky objekt do të shërbejë për mbajtjen e trajnimeve të ndryshme dhe për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme.

Myftiu Tërnavë gjatë kësaj qëndrimi në Gjakovë vizitoi edhe disa objekte të

tjera vakëf, si: objektin në ndërtim e sipër të ish-stacioni i veterinarisë, dyqanet vakëf përmbri Xhamisë së Sofës, objektin vakëf gjashtë katesh në Çarshi të Vogël, si dhe institucionin parashkollor – çerdhen në kuadër të Këshillit të Bashkësisë Islame të Gjakovës.

## “NË KËTË KOHË SFIDUESE, PREJ NESH KËRKOHEM TË JEMI VIGJILENTË DHE TË KUJDESSHËM”

Me rekomandim të kryetarit të Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Myftiut Naim ef. Tërnavë, më 6 dhjetor 2024, në të gjitha xhamitë e Kosovës, një pjesë e hytbesë (mesazhit) të xhumasë iu kushtua situatës së sigurisë në vendin tonë, pas sulmit terrorist të fundit, që ndodhi në veriun e vendin më 29 nëntor, një ditë pas festës së flamurit tonë kombëtar.

Në këtë mesazh u bë thirrje që ne si besimtarë, në këtë kohë sfiduese për vendin, të jemi të kujdesshëm dhe vigjilentë për mënyrën se si ne komunikojmë me të tjerët, në çfarëdo mënyrë që e bëjmë një gjë të tillë.

Gjithashtu pjesë e mesazhit ishte edhe bashkimi i të gjithëve, në mënyrë që të angazhohemi me të gjitha kapacitetet tona për të parandaluar çdo kërcënim, që mund ta cenojë paqen dhe sigurinë e kombit dhe shtetit tonë. Aty u bë thirrje për bashkëpunim me institucionet tona, të cilat siç u tha në mesazh, janë themeluar me gjakun e bijve dhe bijave tanë ndër breza.

Në vazhdim po e japim mesazhin e plotë:

*Të nderuar besimtarë,*

*Jemi dëshmitarë se Kosova po përballet me sfida të mëdha në aspektin e sigurisë.*

*Më 29 nëntor, një ditë pas festës së flamurit tonë kombëtar, në veri të vendit ndodhi një sulm terrorist ndaj kanalit që furnizon me ujë gati gjysmën e qytetarëve të Kosovës dhe është jetik për energji e ngrohje.*

*Kjo ngjarje kriminale na tregon qartë se jemi në një situatë të ndjeshme dhe të trazuar, ku bashkëpunimi me institucionet e vendit e të sigurisë është i domosdoshëm për mbrojtjen e shoqërisë dhe shtetit tonë nga rreziqet e mundshme të armiqve tanë.*

*Në këtë kohë sfiduese, është shumë e rëndësishme që si besimtarë të jemi vigjilentë dhe të kujdesshëm në mënyrën se si komunikojmë me të tjerët, qoftë drejtpërdrejt, qoftë edhe përmes rrjeteve sociale.*

*Fjalët dhe veprimet tona kanë ndikim të madh, prandaj duhet të tregojmë maturi, përgjegjësi e vetëdije të lartë, duke mos rënë pre e provokimeve e*

*lajmeve të rrejshme, që dëmtojnë shtetin dhe fenë tonë.*

*Feja jonë e pastër islame na mëson paqen, respektin dhe mbrojtjen e njëri-tjetrit. Është detyra jonë si besimtarë që të kontribuojmë për një shoqëri të sigurt e të qëndrueshme dhe shtet të fortë.*

*Prandaj, ju ftojme që së bashku me bashkësinë tonë fetare, të jemi të bashkuar dhe të bashkëpunojmë ngushtë me institucionet tona, institucione të cilat i kemi themeluar e ndërtuar me gjakun e bijve dhe bijave tanë nëpër breza, prandaj duhet të angazhohemi bashkë me autoritetet për të parandaluar çdo kërcënim, që mund të cenojë paqen dhe sigurinë e kombit e të shtetit tonë.*

*Ne kemi obligim të mbështesim institucionet e sigurisë me të gjitha mundësitë tona, t'u besojmë atyre dhe të japim kontributin tonë për një Kosovë të sigurt për të gjithë qytetarët. Bashkëpunimi dhe besimi ndaj institucioneve është një hap i rëndësishëm në ruajtjen e paqes dhe sigurisë kombëtare.*

*Besimtarët myslimanë në Kosovë kanë treguar e dëshmuar historikisht se dinë të luftojnë për liri dhe të sakrifikojnë për shtetin e tyre.*

*Vëllezër besimtarë!*

*Ne si besimtarë jemi të përkushtuar që të jetojmë në paqe dhe bashkëjetesë, të rrisim fëmijët tanë në një mjedis të sigurt, të qetë e të qëndrueshëm, duke besuar fuqishëm në Zotin Një dhe vlerat tona të shenjtja.*

*Të qëndrojmë të gjithë të bashkuar për një Kosovë më të fortë dhe më të sigurt!*



## SEKRETARI I PËRGJITHSHËM I KRYESISË SË BIK-UT, AHMET EF. SADRIU MBAJTI TAKIM ME SEKRETARËT E KËSHILLAVE TË BI-SË SË KOSOVËS



Më 24 dhjetor 2024, sekretari i përgjithshëm i Kryesisë së Bashkësisë Islame të Kosovës, Ahmet ef. Sadriu, ka mbajtur një takim me sekretarët e Këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës.

Sekretari Sadriu fillimisht falënderoi sekretarët për punën dhe angazhimin e tyre të dhënë nëpër Këshillat ku ata veprojnë, duke kërkuar kështu nga ta

që ta shtojnë edhe më tej angazhimin dhe kontributin e tyre.

Qëllimi i këtij takimi ishte diskutimi rreth avancimit të formës së komunikimit ndërmjet Këshillave dhe Kryesisë, qoftë në aspektin e përpilimit të shkresave, propozimeve, vendimeve dhe kërkesave të ndryshme, për çka sekretari Sadriu kërkoj nga sekretarët që të vazhdojnë bashkëpunimin ndër-

mjet tyre në shkëmbimin e përvojave të tyre.

Gjithashtu gjatë këtij takimi u paraqit edhe modaliteti i digjitalizimit të arkivave të Bashkësisë Islame të Kosovës, e cila do të fillojë së zbatuari që nga janari i vitit 2025.

## KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË TRYEZËN E DISKUTIMIT ME TEMËN “TË DREJTAT TONA, E ARDHMJA JONË, DITËT E SOTME”



Më 3 dhjetor 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë në tryezën e diskutimit me temën “Të drejtat tona, e ardhmja jonë, ditët e sotme”, e cila u organizua nga Misioni i OSBE-së në bashkëpunim me Kolegjin AAB.

Kjo tryezë u fokusua në promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut nga një këndvështrim i bazuar në besim. Organizatorët theksuan se në Kosovë çdoherë ka mbretëruar tole-

rancë ndërfaqetare dhe jetesa është zhvilluar në harmoni të plotë.

Ndërkaq, kryeimami Sahiti në kumtesën e tij u fokusua në rolin e fesë islame, në veçanti të drejtën e jurisprudencës islame në mbrojtje të integritetit njerëzor si një nga objektivat kryesore të fesë si dhe për rolin e liderëve fetarë në promovimin e lirisë e të drejtave të njeriut, e po ashtu edhe për përkushtimin e Bashkësisë Islame të Kosovës në

mbrojtje të të drejtave dhe lirive të njeriut.

Në këtë tryezë morën pjesë prorektorja e kolegjit universitar AAB, znj. Venera Lllunji, dekani i Fakultetit Juridik, z. Mentor Lecaj, si dhe studentë, të cilët ishin mjaft aktivë në diskutimet pas kumtesave të paraqitura nga panelistët. Studentët adresuan pyetje mbi sfidat aktuale dhe mundësitë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut në një botë gjithnjë e më komplekse.

## KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM KËSHILLTARIN REGJIONAL PËR SIGURI TË BASHKIMIT EVROPIAN, Z. EDDY GREIF

Më 10 dhjetor 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim këshilltarin regional për siguri të Bashkimit Evropian, z. Eddy Greif, i cili shoqërohej nga ekspertja nacionale e Zyrës së BE-së, znj. Heidi Lempio dhe nga zyrtari për politika në Zyrën e BE-së, z. Visar Bivolaku.

Kryeimami Sahiti e falënderoi z. Greif për vizitën dhe për bashkëpunimin e Zyrës së BE-së në Kosovë me Bashkësinë Islame të Kosovës, sidomos për mbështetjen e kësaj Zyre për dialogun ndërfaqetor dhe ndëretnik. Ai në veçanti tha se me Zyrën e BE-së kemi një bashkëpunim të mirë në ruajtjen e trashëgimisë kulturore përmes instrumentit ICSP, e cila është realizuar nga UNDP-ja, dhe që për qëllim ka pasur



forcimin e kohezionit social dhe mirëkuptimit ndërmjet komuniteteve.

Z. Greif, falënderoi kryeimamin Sahiti për mikpritjen, e më pas, përmes tij, falënderoi Bashkësinë Islame të Kosovës për përkushtimin dhe

kontributin për ndërtimin e paqes dhe për kultivimin e vlerave të bashkëjetesës dhe harmonisë në Kosovë. Ai theksoi se bashkëpunimi ndërmjet Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Bashkësisë Islame do të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## KRYEIMAMI SAHITI PRITI NË TAKIM NJË DELEGACIONI NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E VAKËFEVE TË TURQISË



Më 10 dhjetor 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka pritur në takim një delegacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve të Turqisë. Kryeimami Sahiti fillimisht i shprehu ngrohtë mirëseardhje delegacionit nga Ankaraja, e më pas i falënderoi ata për bashkëpunimin e suksesshëm me Bashkësinë Islame në

disa fusha të rëndësishme, si në atë sociale, humanitare, arsimore, dhe veçanërisht në fushën e trashëgimisë kulturore islame në vendin tonë.

Delegacioni nga Ankaraja gjatë vizitës në Kosovë vizitoi disa objekte monumentale nga fusha e trashëgimisë nëpër qytete të ndryshme të Kosovës, të

cilat presin të restaurohen dhe të realizohen nga Drejtoria e Vakëfeve në bashkëpunim të ngushtë me Bashkësinë Islame të Kosovës. Ky bashkëpunim synon të forcojë mbrojtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore islame, duke kontribuar kështu në zhvillimin e qëndrueshëm dhe mirëqenien e komunitetit tonë.

## KRYEIMAMI SAHITI TAKOI KRYEIMAMËT E KËSHILLAVE TË BI-SË SË KOSOVËS



Më 12 dhjetor 2024, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, ka mbajtur mbledhje me kryeimamët e këshillave të Bashkësisë Islame të Kosovës, për të vlerësuar raportet e punës dhe aktivitetëve gjatë këtij viti.

Kryeimami Sahiti fillimisht falënderoi kryeimamët për punën dhe angazhimin e tyre që kanë dhënë gjithandej këshi-

llave të BI-së gjatë vitit 2024. Ai vlerësoi angazhimin dhe përkushtimin e gjithë imamëve, në misionin e tyre, që këtë amanet që e kemi mbi supet tona gjegjësisht kumtimin dhe shpjegimin e fesë së pastër islame ta kryejmë me devotshmëri e dinjitet.

Më pas kryeimami Sahiti theksoi nevojën e bashkëpunimit të kryeimamëve me imamët dhe xhematët e

tyre, si dhe koordinimin me Kryesinë për një punë të integruar mirë mes nivelit lokal me atë qendror.

Gjatë takimit, kryeimamët paraqiten raportet vjetore të punës së tyre pranë Këshillave përkatës dhe u diskutuan edhe çështje të rëndësishme të tjera me interes, me qëllim të avancimit të jetës fetare dhe shërbimeve fetare në vend.

## KRYEIMAMI SAHITI MORI PJESË NË PUNËTORINË PËR VLERËSIMIN E IMPLEMENTIMIT TË PLANIT TË VEPRIMIT TË STRATEGJISË PËR PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E TERRORIZMIT 2023-2028



Më 16 dhjetor, me ftesë zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Kosovës, kryeimami i Bashkësisë Islame të Kosovës, Vedat ef. Sahiti, mori pjesë aktivisht në Punëtorinë për vlerësimin e implementimit të planit të veprimit të strategjisë për parandalimin dhe luftimin e terrorizmit për periudhën 2023-2028. Në këtë punëtorinë, si pjesë e grupit punues përgjegjës për hartimin e strategjisë dhe planit të veprimit, po marrin pjesë

përfaqësuesit e institucioneve të vendit, si dhe ata të institucioneve ndërkombëtare që kontribuojnë në këtë fushë.

Kjo Punëtori u mbajt në Pejë, duke filluar më 16 dhjetor dhe duke përfunduar më 18 dhjetor, ku u zhvilluan diskutime të detajuara mbi metodat dhe masat që duhet të merren për të forcuar kapacitetet e parandalimit dhe luftimit të terrorizmit në territorin e Kosovës. Gjatë këtyre tre ditëve, u shqyrtuan strategjitë ekzistuese, u

analizuan rezultatet e arritura deri më tani, dhe u caktuan objektivat për vitet e ardhshme për të siguruar një qasje të integruar dhe efektive ndaj këtij fenomeni. Përveç kësaj, u organizuan seanca trajnimi dhe punëtorish praktike për të rritur aftësitë e përfshirë në implementimin e strategjisë, duke përfshirë edhe përdorimin e teknologjive të reja në monitorimin dhe parandalimin e aktivitetëve terroriste.



# Shoqata Humanitare Bamirëse "BEREQETI"

## PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE TË REALIZUARA GJATË VITI 2024



**30,556**

Pako ushqimore  
dhe higjienike

**127**

Kupona për markete

**22808** euro  
Ndhimë për shërim

**5872** euro  
Medikamente

**5** Karroca elektrike

**56** Mjete PNV

Dyqani humanitar në  
Prishtinë

**840**

familje/pako mujore

**27** ton hurma

**80,180**

Bukë të gatshme

**23** Hapje

e puseve (bunarëve)

**4** Banesa

**12** Shtëpi ndërtim

**11** Shtëpi renovim

**2** Troje

**26** Mobllim shtëple

**8961** euro Qera  
mujore

**930** Batanije

**52** Stufa

**436,5** m<sup>3</sup> dru

**150** Familje të prekura  
nga vërshimet

Kuzhina humanitare  
me shujta të ngruhta

**72,000** Mitrovicë

**61,230** Pejë

**860**

Mjete shollore / rrxënës

**22** Bursa mujore

**5** Bileta mujore /  
studentë

**328,150** kg  
Miell

**13,285**  
Dhurata për fëmijë

**11,728** euro  
Ndhimë për jetimë

**135,325**  
Iftare / persona

**242,011** kg  
Mish kurhani

**78,075** euro  
Para të gatshme

**22,187**  
Veshmbathje/persona

**530**  
Ëmbëlsia (torte)

**126**  
Kurbana (akika)

Kontribuo edhe ti në zbirrologarinë: **CJQ SHOQATA BEREQETI,**

Banka Ekonomike Sh.a. - IBAN: XK051401000000813233 - SWIFT Code (BIC): EKOMXKPRXXX,

Donacionet tuaja mund t'i dorëzoni edhe në krahinat e Bashkimit Ballorë nëpër agjentët e Kosovës.

Shoqata Humanitare Bamirëse Bëreqeti +383 44 261 121 +383 49 733 678



**DITURIA ISLAME • Nr. 410 JANAR 2025**